

Korrik 2015
Numri: 88
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro



LUKMANI (A.S.)
OSMAN NURI TOPBASH

BEGATIA E RAMAZANIT

ALI RIZA JEMEL

ZONJË XHENETI

ADEM SARAC

INSTITUCIONI I AGJËRIMIT

ENKLIÐ PELARI

SI DUHET TË JETË
RIVALITETI?

AHMET ZILJAN

SI MUND TË DALË JUSUFI

NGA PUSI

A. JASIN DEMIRXHI

ENTUZIAZMI I ADHURIMIT

ISSN 2227-3611 0 7
9 772227 361004

Korrik 2015

VITI: IX

NUMRI: 88

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Artur Tagani

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 607 8484

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.revistaetika.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 4411 9848

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrove të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Ka dy gjëra themelore që e përcaktojnë cilësinë tonë njerëzore, vlerën tonë të Allahu Teala dhe më tej, që na shpien te formimi i miqësisë me Të: besimi dhe devotshmëria. Çdo besimtar, që me mirësinë e Allahu Teala, e njeh Atë si të Vetmin që mund të adhurohet, do të thotë se ka hedhur hapin më të rëndësishëm në jetë, që do ta shpëtojë atë nga ndëshkimi i përhershëm i xhehenemit. Tashmë, pas këtij hapi, i është hapur horizonti i një lartësimi drejt pafundësisë.

Nëse përpiqet me dëshirë, përmallim dhe mallëngjim të madh pa rënë në neglizhencë ndaj Krijuesit fuqiplotë, mund të shtojë çdo çast gurë të çmuar në kurorën e nderimit të tij. Emri i udhëtimit të këtij lartësimi drejt kënaqësisë hyjnore është "udhëtimi i devotshmërisë".

Devotshmëria është një operacion mbrojtjeje kundër çdo lloj rreziku që e ndyn, përdhos dhe në fund, që mund ta rrokullisë personalitetin në esfeli safilin. Ajo është përpjekje për të mbrojtur veten kundër çdo gjëje që mund ta ulë njeriun nga xheneti për të cilin është krijuar.

Ajo e ndihmon njeriun që zemrën, adhurimin, jetën dhe vdekjen e tij t'ia dedikojë vetëm Allahut Teala. Ajo është mundësia për të shprehur dhe për të jetuar jetën me vetëdijen e këtij ajeti kuranor, në të cilin Allahu i Madhëruar shprehet:

Thuj: "Në të vërtetë, namazi im, kurbani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve." (En'am, 162)

Ruajtja e mendimeve, ndjenjave, fjalëve dhe sjelljeve brenda kornizës së një koncepti të tillë, është një fitore e madhe shpirtërore. Dhurata e kësaj fitoreje është arritja e shpëtimit të madh në dynja e ahiret dhe së fundi, fitimi i miqësisë me Allahun Teala. Për udhëtimin e devotshmërisë ka mjete dhe ushqime të ndryshme. Këto janë shprehur me mënyra të ndryshme në Kuranin Fisnik dhe në hadithet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Shkalla e parë e devotshmërisë është qëndrimi larg çdo lloji të shirkut. Mbrojtja nga shirku i hapur është më e lehtë, por të mos biesh në shirkun e fshehtë, nuk është aq e lehtë. Agjërimi, në një këndvështrim, është një mënyrë arritjeje suksesi në atë që është e vështirë, sepse të shtiresh me agjërim, është më e vështirë se sa me ibadetet e tjera. Nisur nga ky aspekt, agjërimin mund ta shikojmë si disiplinë për ta edukuar njeriun, në mënyrë që veprat e tij të jenë të sinqerta.

Agjërimi e bën njeriun të kuptojë aftësitë e tij të kufizuara, ia pastron personalitetin nga egoizmi e mendjemadhësia dhe i jep atij modestinë dhe vetëdijen e të qenit asgjë kundrejt Allahut të Madhëruar. I hap damarët e mëshirës, duke i dhënë mundësinë e kuptimit në shkallën hakka'l-jekin ndaj të uriturve dhe të vetmuarve. Nëse agjërimi mbahet me ndjenja edhe më të thella, i zbukuron fjalët e sjelljet me fisnikëri dhe hijeshi.

Përmbajtja

Besimtari është si uji
Nuredin Jëlldëz

14



8

Begatia e Ramazani
Ali Riza Temel




Lukmani (a.s.)
Osman Nuri Topbash

34



24



28

Agjëroni që të jeni të shëndetshëm
Prof. dr. Mahmud Barsha

5 Adhurimi i ndërthurur me jetën
Ahmet Tashgetiren

11 Dua të bëhesh prej tyre
Sadik Dana

12 Emru bi'l-ma'rif
ve'n-nehju ani'l-munker
Prof. dr. Sulejman Derin

16 Familja e Ibrahimit (a.s.)
Xhafer Durmush

18 Mbrujtja me Kuran
M. Sami Ramazanollu

19 Lumturia
Fatma Dilek

19 Analizimi i një udhëtimi
Murat Akgyn

20 Ngashënjimi i harmonisë
Idris Arpat



50

Zonjë xheneti 22

Adem Saraç

Ebu Bekri 24

Nuredin Jëlldëz

Roli i agjërit në rritjen e devotshmërisë 26

Dr. Adem Ergyl

Mrekullitë e Kuranit 30

Një Ajet - Një Hadith 32

Institucioni i agjërit 40

Enklid Pelari

Të ekspozuar ndaj rrezikut 42

Nuredin Nazarko


Për të arritur urtësinë, shko atje ku gjendet urtësia! 44

Mehmet Lutfi Arslan

Si mund të dalë Jusufi nga pusi 54

A. Jasin Demirxhi

Përpjekja për kalimin
e ulje-ngjitjeve të jetës
Sami Byjykkajnak



47

Turpi është i bukur
Ali Khan

56



Adhurimi i ndërthurur me Jetën

Ahmet Tashgetiren

Po përjetojmë Ramazanin. Po e përjetojmë atë të ndërthurur me jetën.

Megjithatë, jeta nuk ndalon së bashku me Ramazanin, por vazhdon të rrjedhë.

Ashtu si namazi, që është një adhurim brenda jetës edhe agjërimi është një adhurim që përjetohej së bashku me jetën. Në fakt, të gjitha adhurimet përjetohej brenda jetës. Pra, Islami nuk është një fe që jetohej në vetmi, larg jetës dhe vetëm në vende të caktuara, por një fe që e ka ndërthurur adhurimin me jetën ose më saktë, një fe që mëson se si të jetohej me ndjenjën e adhurimit.

Ç'do të thotë kjo?

Për të kuptuar këtë, më parë duhet të shqyrtojmë se ç'është adhurimi.

Adhurim është vetëdija për marrëdhënien midis Krijuesit dhe qenies së krijuar. Pra, vetëdija ndaj robërisë dhe shpagimi i borxhit që lind prej faktit të të qenit rob i Allahut.

Ç'do të thotë kjo?

Kjo do të thotë se çdo grimcë e jetës sime është e ndërlidhur fort me mirësinë dhe bujarinë e Tij. Do të thotë që, para se Ai të urdhëronte "Bëhu!", unë dhe gjithësia ishim një "hiç". Do të thotë që unë duhet ta organizoj jetën time me këtë vetëdije, pra me vetëdijen se kam ardhur prej hiçit me mirësinë dhe bujarinë e Tij. Do të thotë që duhet të jetoj duke pasur kujdes nga Ai, me vetëdijen se Ai nuk do të më lërë të veproj pa kontroll dhe duke marrë për bazë koordinatat e rrugës që Ai ka përcaktuar.

Disa modele sjelljeje që na janë përcaktuar si adhurime, luajnë rolin e stimuluesve, të cilët nuk na lënë të harrojmë këtë marrëdhënie themelore në rrjedhën e jetës së

përditshme. P.sh., në sajë të pesë kohëve të namazit, qëndrojmë pesë herë në ditë në audiencë të Allahut dhe themi: "Erdba, o Zoti im i Madhëruar, po i qëndroj besnik marrëveshjes që kemi bërë në botën e shpirtave para se të krijohem. Duart, gjuhën, syrin, veshin, zemrën, mendjen, mënyrën e mendimit dhe botëkuptimin për jetën i kam të pastra. Nuk e kam njoftosur zemrën gjatë kësaj kohe. Dhe ato pak njolla që kisha, i kam pastruar dhe ja tani, jam para Teje".

Midis dy namazeve mos fut gjynahe, si shkelja e kufijve që të ka vënë Allahu, por jetoje ditën duke qenë i pastër. Me anë të agjërit, lëri mënjandis nevojat të domosdoshme njerëzore në kohë të caktuara për një muaj rresht, duke iu përgjigjur thirrjes së Zotit tënd. Organizojë veten sipas kënaqësisë së Allahut. Dhe meqenëse këtë e bën për hir të Tij, mos i neglizho as kufijtë e tjerë hyjnorë jashtë ngrënies, pirjes dhe jetës seksuale.

Dije se çështja e agjërit nuk është thjesht një dëshirë e Allahut që ti të qëndrosh i uritur, sepse Ai nuk ka nevojë për urinë tënde. Ai dëshiron të bëhesh një rob më i mirë. Dhe meqenëse mund t'i frenosh prirjet njerëzore, si ushqimin, pijen dhe jetën e natyrshme seksuale, vetëm për kënaqësinë e Allahut, tashmë mund t'i respektosh edhe më me dëshirë kërkesat e tjera për hir të Tij.

Meqenëse Allahu të ka vënë përpara një model, si "Ni'mel abd (Robi i mirë)", atëherë si thua, a ta kërkojmë atë në namaz, agjërim, haxh dhe zekat? Nëse ndërton një shtëpi me agjërim, nuk të ka hije t'i vësh shkelmin për disa tundime të epshit.

Agjërimi është si një enë, brenda së cilës do të mbruhesh ti. Zemra jote do të kthehet në një qendër personaliteti, i cili do të mbruhet me dorën e fuqishme të Zotit.

Me anë të zekatit, ndreqi ndjenjat e tua që janë të prira të mburren, duke thënë, "i fitova unë". Pra, rregullo marrëdhënien tënde me pasurinë. Dije se ato t'i fali Zoti yt si furnizim. Mbase ke punuar me mish e me shpirt për t'i fituar, por edhe shpirtin Ai ta ka dhënë. Ndaje një pjesë të pasurisë apo mallit, të cilin e do aq shumë, si të jetë një pjesë e shpirtit tënd. Madje, ndaj një pjesë të mirë të tij dhe jo atë që, po të ta jepnin ty do të rrudhje fytyrën para sa ta merrje. Ndaje dhe jepe

me dashuri dhe respekt, sikur je duke e dhënë në dorë të Allahut ose sikur po i jep borxh Atij dhe në këmbim do të marrësh xhenetin. Jepja të varfrit atë që Allahu e ka lënë në përgjegjësinë tënde.

Me anë të haxhit, shumëzoi me zero të gjitha statuset e tua shoqërore. Qëndro me dy copa pëlhere dhe hapi duart sikur je në atmosferën e mahsherit. Drejtoju Zotit tënd dhe përgjigju Atij pandërprerë. Përfeto ndjenjën e dhënies së llogarisë përpara Allahut, pendohu tek Ai dhe mundohu të ndjesh ndjenjën e pastërtisë shpirtërore... Mendo për një çast, sikur ike dhe nuk do të kthehesh më. Në atë moment nuk je më, asnjë sekondë dhe asnjë ditë më pas. Dhe ashtu, duke u mbështjellë me qefin, sikur mbështillesh me ihram, do të dalësh në udhëtimin e përjetshëm. Çfarë ka në torbën që ke marrë mbi supë?

Virtyte me të cilat do të fitosh kënaqësinë e Allahut apo një grumbull gjynahesh, të cilat do të bëhen shkak i zemërimit hyjnor?

Mos harro marrëdhënien me Zotin tënd.

Mos harro Zotin tënd.

Mos mendo kurrë, qoftë edhe për një çast, se mund të kalosh jashtë fushës së fuqisë së Tij.

Mbaje frymën për disa minuta. Ja, atë ta jep krejt falas Zoti yt. Pa u munduar fare. Të jep një qiell plot frymë, lugina të mbushura me ujë, gjakun që rrjedh në damarët e tu dhe shpirtin që të mban në këmbë.

Ai çdo çast është me ty dhe çdo çast të mbulon me mirësi.

Ai është pranë teje më afër se arteria kryesore në qafën tënde.

Jeto sikur e sheh Atë në çdo moment. Edhe nëse ti nuk e sheh Atë, dije se Ai të sheh ty.

Krijuesi, pavarësisht gjithë këtyre rregullave bazë, e di shumë mirë se njeriu është i dobët dhe shpërbëhet lehtë. Atë e shpërbëjnë marrëdhëniet brenda jetës, siç janë fëmijët dhe familja. Prandaj dhe Allahu na paralajmëron, kur thotë: **"Ata të cilët nuk i pengon shitblerja për të përmendur Allahun dhe të cilët e falin namazin dhe japin zekatin dhe të cilët kanë frikë nga Dita (e Kiametit), kur zemrat dhe shikimet do të jenë të shqetësuara."** (Nur, 37)

Tregtia dhe shitblerja... Kjo është jeta... Nuk mund të shkëputesh prej tyre, kjo dihet. Por as nuk mund të zhytesh në to. Të gjitha këto duhet t'i bësh pa e harruar

*Dije
se çështja
e agjërit nuk
është thjesht një dëshirë
e Allahut që ti të
qëndrosh i uritur,
sepse Ai nuk ka nevojë
për urinë tënde.
Ai dëshiron të bëhesh
një rob më
i mirë.*

Allahun Teala, duke e përkujtuar Atë dhe duke respektuar të gjitha rregullat që ka vendosur Ai për këto punë. Pra, pikërisht ky është namazi i ndërthurur me jetën. Ky është kujdesi ndaj të varfërve, që të bën të ndash një pjesë prej fitimit nga tregtia dhe shitblerja.

Nëse nuk e jetoni jetën me vetëdijen se jeni së bashku me Allahun, kini frikë prej një dite kur do t'u turbullohen sytë. Por, nëse besoni me gjithë zemër se një ditë do të dilni para Allahut dhe, nëse ndjeni një drithërimë duke e ditur se sa e vështirë do të jetë dhënia e llogarisë, atëherë mos e harroni Allahun dhe robërinë ndaj Tij në asnjë çast të jetës!

Allahu Teala paralajmëron:

"O besimtarë, mos lejoni që pasuria dhe fëmijët tuaj t'ju largojnë nga të përmendurit e Allahut. Ata që e bëjnë këtë, do të humbin." (Munafkun, 9)

Pasuria dhe fëmija... Kjo është jeta... Nuk mund të shkëputesh prej tyre. Ato janë gëzimi i zemrës dhe fruti më i ëmbël i jetës. Kjo dihet. Por as nuk mund të zhytesh në to.

Edhe kur dashuria për pasuri-në dhe fëmijët të ta mbështjellin zemrën, nuk duhet ta harrosh Allahun. Duhet ta dish se edhe pasuria, edhe fëmija janë prej mirësive të Zotit tënd. Ai t'i jep, Ai t'i merr.

Të gjitha këto na këshillojnë të përvetësojmë vetëdijen e të qenit së bashku me Allahun edhe në jetën tonë jashtë namazit. Gjithashtu, edhe kur nuk jemi agjërueshëm...

Madje, duhet menduar në këtë mënyrë:

O Allah, u zgjova në agim prej gjumit që është si gjysmë vdekjeje. Më dhurove edhe një ditë... Qofsh i falënderuar pafundësisht. Ja ku jam para Teje dhe do të përpiqem që këtë ditë që ma dhurove ta jetoj në përputhje me kënaqësinë Tënde.

Pastaj do të çelë dita, dielli do të ngrihet në kupën e qiellit dhe ti do të mendosh:

- Pak më vonë do hyjë koha e namazit të drekës dhe unë do të dal përpara Zotit tim. Do të marr abdest dhe në një farë kuptimi, ndërkohë që laj duart dhe fytyrën,

do të pastrohem edhe prej papastërtive të zemrës. Gjithmonë bëhesh pis dhe pastrohesh, bëhesh pis dhe pastrohesh. Ç'është kjo punë? A nuk mund të tregoj më shumë kujdes që të mos bëhem pis?

Allahu Teala urdhëron:

"...Vërtet që namazi të ruan nga shthurja dhe nga çdo vepër e shëmtuar..." (Ankebut, 45)

Pejgamberi (a.s.), thotë: "Nëse nuk ke turp, bëj ç'të duash!". Të turpërohesh... Mbase më parë duhet të turpërohesh prej Krijuesit. Apo jo?

Me Ramazanin, ne dëshirojmë të fitojmë një jetë e cila

jetohet në prani të Allahut. Kjo është një sprovë. Pra, të hyjmë për një muaj rresht në dietën e devotshmërisë ose, nëse mund të shprehemi, të bëjmë një "kurë" me adhurime. Të ndiejmë pas-trimin deri në palcë poshtë një ujëvare mëshire. Të mësohemi me një jetë të re, të organizuar përreth agjërimit.

Resulullahu (a.s.), na këshillon: "Ta fitojmë xhenetin duke e për-jetuar Ramazanin ashtu siç i takon atij". Pra, për ne, kjo është sprovë e nxjerrjes së xhenetit prej Ramazanit.

Nëse gjatë shpërbërjeve që përjetojmë ndiejmë flakët e zjarrit në fytyrat tona, ja ku kemi rastin e Ramazanit, i cili i ka hapur krahët e mëshirës për ne dhe për të cilin Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë: "Ai që nuk përfiton prej tij (Ramazanit), do të poshtërohet".

Me pluset dhe minuset e tij, Ramazani është një sprovë e madhe.

Dëshiroj prej Allahut dhe i përgjerohem Atij të na japë forcën

për ta fituar këtë sprovë.

Iftaret do të na heqin urinë ditore të trupit tonë. Ndërsa agjërimi le të jetë ushqimi i zemrës sonë dhe të na heqë urinë e shpirtit, duke na e ngopur atë me përkujtimin hyjnor.

Le ta dëgjojnë veshët tanë zërin që thotë:

"E meritove të jesh rob i Im, prandaj hyr në mesin e robërve të Mi. Hyr në xhenetin Tim."



O Allah, u zgjova në agim prej gjumit që është si gjysmë vdekjeje. Më dhurove edhe një ditë... Qofsh i falënderuar pafundësisht. Ja ku jam para Teje dhe do të përpiqem që këtë ditë që ma dhurove ta jetoj në përputhje me kënaqësinë Tënde.



Begatia e Ramazanit

All Riza Temel

Allahu Mëshirues dhe Mëshirëbërës i ka caktuar për ne kohët e fitimit të bollshëm dhe faljes. Koha më e bukur, në të cilën mëshira dhe begatia hyjnore zbret me bollëk, është muaji i Ramazanit. Ky muaj i begatshëm, në të cilin sevapet jepen shtatëdhjetë herë më shumë për veprat e mira, është një mundësi e madhe që nuk duhet të na ikë. Arritja e këtij muaji duke qenë i shëndetshëm, është një mirësi hyjnore në vete. Shumë njerëz, që i kishim ndërmjet nesh në Ramazanin e kaluar, tashmë nuk i kemi më. Allahu i Madhëruar na ka dhënë edhe këtë vit mundësinë për ta agjëruar Ramazanin, na ka hapur dyert e xhenetit, na ka mbyllur dyert e xhehenemit, na e ka mundësuar të pastrohemi nga mëkatet, të stolisemi me virtyte dhe të zbukurohemi me cilësi të larta. A ka fitim më të madh se arritja e natës së Kadrit, e cila është më e mirë se një mijë muaj? Muaji i Ramazanit, i cili është totalisht një shkollë adhurimi me taravitë, iftalet, syfyret, leximet e Kuranit, dhikret, tesbihet, ligjeratat, këshillat dhe lëmoshat, është një mundësi e pashoqe për të fituar kënaqësinë e Krijuesit

të Lartësuar dhe për t'u bërë prej atyre që do ta shohin Allahun Teala në xhenet.

Agjërimi është një urë lidhëse, që mundëson kalimin nga bota e përkohshme në atë të përhershmen. Njeriu në këtë muaj është një hero që lufton me armën e vendosmërisë dhe të vullnetit për ta lartësuar botën shpirtërore ndaj asaj materiale, jetën njerëzore ndaj jetës kafshërore, pastërtinë engjëjlore ndaj djallëzisë së shejtanit. Agjërimi i jep atij begati në shëndet, sublimitet në shpirt, dëlirësi në ndërgjegje, liri në vullnet dhe fuqi në zemër. Po ashtu, i jep edhe virtytet si vendosmëri, rezistim, bindje, kënaqësi ndaj caktimit të Zotit, devotshmëri dhe sinqeritet.

Njeriu nuk mund t'i arrijë kënaqësitë e përhershme pa u larguar nga mirësitë provizore. Fëmijët nuk mund t'i konsumojnë ushqimet e mrekullueshme dhe nuk mund t'i shijojnë kënaqësitë e jetës pa u ndarë nga qumështi.

Agjërimi është esenca e lumturisë, që ia bën të ditur njeriut vlerën e mirësive, që ia zgjon ndjenjat e falënderi-

mit ndaj Zotit (xh.xh.), që zhvillon vetëdijen e të kuptuarit të gjendjes së të varfërve, që shton shpresat te njeriu, që e heq vështirësinë e pasioneve dhe të epsheve, që e çliron njeriun nga robërimi i botës materiale dhe e shpie në sigurinë e botës shpirtërore, që i këput zinxhirët e lakmisë e të tamahut, që e shpie njeriun në klimën e qetësisë e bindjes dhe që e lartëson të gjithë qenien tonë me vetëdijen e adhurimit e me nurin e besimit.

Gjelbërimet e përhershme të pranverës shpirtërore çelin në muajin e Ramazanit, në klimën e agjërimit dhe në sezonin e Kuranit. Ditët e Ramazanit janë buqeta me lule, të mbledhura në bahçen e jetës, që i dhurohen Zotit (xh.xh.).

Ditët e Ramazanit janë ditët në të cilat nxirren shpatat e vullnetit e të vendosmërisë dhe luftohet kundër epsheve dhe pasioneve. Në fund të kësaj lufte është fitorja e lumturisë së përhershme.

Xheneti është nën hijen e këtyre shpatave. Xhihadi i madh është xhihadi i bërë karshi vetes. Ai që nuk e fiton këtë xhihad, nuk mund të fitojë asnjë xhihad tjetër. Agjërimi i aktivizon aftësitë mendore dhe shpirtërore. Ai i bën të mbijnë farërat e së vërtetës së subkoshiençës, që gjenden të fshehura në krijimin tonë. Nxjerr në pah pranverën e botës sonë shpirtërore. E pajis njeriun me armën e durimit, që është fuqia më e madhe për të kryer adhurimet dhe për të rezistuar kundër haramëve. Ia mundëson atij që ta përdorë vullnetin me drejtësi dhe virtytshmëri. Njeriu lartësohet shpirtërisht, arrin grada sublime dhe pothuajse bëhet engjëll me ibadetet që kryen muajin e Ramazanit, si agjërimin, taravitë, iftalet, syfyret, Kuranin, mukabeletë, lëmoshën e fitrit dhe itikafin. Në këtë mënyrë, hapen dyert e xhenetit dhe mbyllen dyert e xhehenemit. Njeriu largohet nga mëkatet dhe të këqijat. Shejtanët lidhen me zinxhirë.

Tregtarët e besimit dhe të ibadetit, që dëshirojnë të bëhen të pasur në ahiret, duhet të nxisin për në këtë pazar të përhershëm, të mbushur plot me mirësi hyjnore. Në këtë treg shpirtëror shiten me çmim të ulët urtësitë kuranore, xhevahiret e ibadeteve, stofrat e mirësive, ushqimet e këshillave dhe sugjerimeve, gjerdanet e faljes, vathët e të vërtetës dhe gjëra të ndryshme të devotshmërisë. (Abdurrahman Sheref Gyzeljazëxhë, Hytbe për besimtarët, vëll. 1/427-465, përmbledhje.)



Paraja e vlefshme në këtë pazar lumturie dhe kënaqësie, që bëhet në allishverishet islame, është sinqeriteti. Fitimet e pasinqerta janë si paratë fallso apo malli i prishur. Në këtë mënyrë, të gjitha përpjekjet shkojnë dëm.

Muaji i Ramazanit është një thesar që i përfshin të gjitha mirësitë. E rëndësishme është të zbulohet ky thesar dhe të përfitohet prej këtyre mirësive. Humbja më e madhe është të kthyerit duarbosh nga ky treg, në të cilin ekspozohet çdo lloj gjëje e vlefshme. Në lidhje me vlerën e mbajtjes së agjërimit, i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *“Nëse dikush agjëron një ditë për hir të Allahut, Allahu e largon atë shtatëdhjetë vjet nga xhehenemi.”* (Taxh, 2/90.)

Vendin e ibadeteve dhe të mirësive që bëhen në muajin e Ramazanit, nuk e zë asnjë gjë. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Nëse dikush ha në një ditë të Ramazanit, përveçse kur ka ndonjë arsye të cilën e ka lejuar Allahu, nuk mund ta marrë sevapin e saj, edhe nëse mban agjërim një vit.”* (Taxh, 2/63.) Njerëzit marrin parasysh shumë vështirësi e rrezeqe për të mos u ikur mundësitë që u jepen në këtë botë dhe vrapojnë aty ku është më e lira. Allishverishin e bëjnë në sezonet e zbritjeve. Ata hyjnë në radhë përpara magazinave që bëjnë promocione. Marrin bileta lotarish, edhe pse një në një milion është mundësia për të fituar. Vendosin baste në futboll dhe harxhojnë shuma të konsiderueshme parash, gjoja se do fitojnë shumë. Ata e shëtisin të gjithë vendin e

tregut për t'i blerë gjërat 4-5 lekë më lirë.

Ndërsa, për fitimet shpirtërore nuk e kanë këtë ndjeshmëri. Ndërkohë që fitimet e kësaj bote janë të përkohshme, ndërsa fitimet e ahiretit janë të përhershme. Allahu Teala thotë: **“Pasuria dhe fëmijët janë stoli e jetës së kësaj bote. Por veprat e mira që mbeten përherë, janë më të mira se Zoti yt sa i përket shpërblimit dhe janë më të mira sa i përket shpresës** (për shpëtim).” (Kehf, 46)

Ata që presin sezonin e zbritjeve të çmimeve për të bërë allishverish, duhet ta presin me më shumë entuziazëm muajin e Ramazanit, i cili është sezoni i mëshirës së madhe, faljes dhe sevapit. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë në një hadith fisnik: *“Sikur njerëzit ta dinin begatinë e Ramazanit, do dëshironin që i gjithë viti të*

ishte Ramazan." Sepse në muajin e Ramazanit, falen mëkatet e kaluara. Engjëjt luten dhe i kërkojnë falje Allahut Teala, natë e ditë për agjëruesit. Hapen dyert e xhenetit dhe mbyllen dyert e xhehenemit. Frenohen dëshirat e tepërta dhe të panevojshme të vetes. Shtohet ndihma reciproke dhe solidariteti. Si rezultat, formohen urat e dashurisë dhe miqësisë. Forcohen shtresat shoqërore. Formohet ambienti i paqes dhe sigurisë. Njeriu përparon shumë në rrugën e adhurimit me agjërimin, taravitë, hatmet dhe lëmoshat. Ai i afrohet më shumë kënaqësisë së Allahut Teala dhe ndërmjetësimit të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Agjërimi është një mburojë karshi mëkateve. Statistikat e policisë kanë vërtetuar se në muajin e Ramazanit pakësohen krimet. Muaji i Ramazanit, i cili ka shumë mirësi dhe fitime të pakufishme në aspektin individual dhe shoqëror, shpirtëror dhe fizik, në aspektin e jetës së kësaj bote dhe të jetës tjetër, është një mundësi e mrekullueshme për besimtarët. Nëse kjo mundësi, që na jepet një herë në vit, na ikën pa e vlerësuar, mund të mos e arrijmë më vitin tjetër, sepse ne nuk kemi garanci se do jetojmë deri nesër, e jo më deri vitin e ardhshëm.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *"Kur të falësh namaz, fale sikur të ishte namazi i fundit!"* Sepse, namazin e vaktit tjetër mund të mos e arrijmë.

Në mirësi duhet të nxitojmë. Një i varfër kishte kërkuar ndihmë nga dikush që po merrte abdest. Ai e kishte lënë abdestin përgjysmë dhe menjëherë e kishte ndihmuar. Kur e pyetën dhe i thanë: *"Përse nxitove? Ti mund ta ndihmoje pasi ta mbaroje abdestin."* – ai u dha këtë përgjigje: *"Nuk dihet çfarë mund të ndodhë. Ndoshta shejtani vjen dhe i bën vesvese zemrës sime. Më thotë se unë kam më shumë nevojë dhe ma merr mendjen. Më e mira është të japësh para se të përziej shejtani."*

Me këto që thamë deri këtu, nuk duam të shprehim se ibadetet dhe mirësitë janë të kufizuara vetëm brenda muajit të Ramazanit. Adhurimi është i vazhdueshëm. Siç është e përhershme mëshira dhe mirësia e Zotit (xh. sh.), edhe adhurimi duhet të jetë i vazhdueshëm. Ngaqë muaji i Ramazanit është një sezon në të cilin ka shumë mirësi, edhe adhurimi duhet të shtohet paralelisht me të. Çështja është që t'i mbushim enët kur çezma ka ujë të bollshëm.

Njeriu mërzitet kur i ikën ndonjë mundësi e rëndësishme. Njeriu mërzitet edhe më shumë kur i ikën Ramazani pa e vlerësuar siç duhet. Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), kishte hipur në shkallën e parë të minberit, i ishte shfaqur Xhebraili (a.s.) dhe i kishte thënë: *"Qoftë larg mëshirës ai që e arrin Ramazanin dhe nuk i falen mëkatet!"* (Tergib, 2/92.) Domethënë, nëse njeriu nuk arrin ta fitojë kënaqësinë e Allahut të Madhëruar në muajin e Ramazanit, në mënyrë që Ai t'ia falë mëkatet, atëherë nuk mund ta arrijë këtë në asnjë kohë tjetër. Çfarë mund të bëjë jashtë sezonit të Ramazanit ai që nuk e vlerëson këtë muaj në të cilin çdo ibadet dhe çdo mirësi shpërblehet me shtatëdhjetë fish dhe që nuk e arrin natën e Kadrit, e cila është më e mirë se një mijë muaj?

Ditët kalojnë pa i kuptuar. Jeta harxhohet. Vetën tonë e humbim në preokupimet ditore. E harrojmë vdekjen dhe llogarinë. Privohemi nga fitimet e mëdha, duke vrapuar


pas fitimeve të vogla. Kjo gjendje shpreh shkujdesjen e madhe që na ka kapluar. Njeriu i mençur nuk e harxhon jetën pas gjërave provizore. Ai nuk vrapon pas hijes së zogut që fluturon në qiell dhe nuk i flijon fitimet e përhershme për fitimet e përkohshme. Jetën e tij nuk e zhvlerëson duke u marrë me gjëra të pavlefshme.

Le t'ia vëmë veshin këtij paralajmërimi të Allahut të Lartësuar: ***"O ju që keni besuar! Frikësojuni Allahut dhe çdo njeri le të shikojë se ç'ka përgatitur për të nesërmen! Kijeni frikë Allahun, sepse Ai di çdo gjë që bëni ju!"*** (Hashr, 18)

Në këtë botë duhet të mendojmë për të sotmen dhe për të nesërmen, por ajo që nuk duhet ta nxjerrim kurrë nga mendja është e nesërmyja e ahiretit. E jona është ajo që kemi dërguar përpara. ***"Faleni namazin dhe jepeni zekatin! Çfarëdo të mire që të bëni për shpirtin tuaj, do ta gjeni tek Allahu. Në të vërtetë, Ai sheh mirë gjithçka që bëni."*** (Bekare, 110) ***"Gjithçka që keni ju është kalimtare, ndërsa ajo që ndodhet tek Allahu është e përhershme. Vërtet, Ne do t'i shpërblejmë ata që kanë duruar sipas veprave më të mira që kanë bërë."*** (Nahl, 96)

Thesari i ahiretit mbushet në këtë botë. Sezoni në të cilin mund të mbushet më shumë, është muaji i Ramazanit. Allahu Teala na bëftë prej robërve të kujdesshëm që e vlerësojnë mundësinë të cilën na e ka dhënë në Ramazan në një mënyrë shumë bujare! Amin!





DUA TË BËHESH PREJ TYRE

Ebu's-Suud bin Ebu'l-Ashairi këshilloi një mikun e tij:
"O vëlla! Allahu i Madhëruar të bëftë prej njësuesve të Tij, sepse ata nuk i bëjnë shirk Zotit.

Ata janë njerëz aq të pastër, saqë nuk njohin vështirësi.

Ata janë njerëz aq të sinqertë, saqë e keqja nuk mund t'u afrohet. Ata e përkujtojnë Allahun gjithmonë, madje me shumë lehtësi.

Ata përshtaten me çdo lloj gjendjeje dhe nuk merren me gjëra të padobishme.

Ata nuk kanë dhembshuri ndaj nefsit. Dispozitat fetare gjithmonë kanë përparësi për ta.

Ata janë asketë, kështu që nuk i drejtohen askujt tjetër përveç Allahut Teala.

Ata nuk bëjnë zënka, por janë të kënaqur nga gjendja në të cilën ndodhen. Ata i mëshirojnë njerëzit dhe nuk janë të ashpër ndaj tyre.

Punët e tyre janë këshilla për njerëzit dhe jo shtirje.

Turpërimi nga Allahu i Lartësuar është pothuajse e vetmja gjë me rëndësi për ta. Madhështia e Zotit (xh.xh.), është para syve të tyre.

O vëlla! Përsëri i lutem Allahut Teala që të të bëjë prej atyre që i binden vazhdimisht Atij!

Ata i gëzon vetëm kënaqësia e Allahut të Madhëruar, jo ajo që i pëlqen nefsit.

Ata i janë dorëzuar shpirtërisht Allahut të Lartësuar. Ata janë bërë të atillë që nuk kanë urrejtje dhe zemërim të pavend.

Gjithmonë ndjekin të Dërguarin e Allahut, (a.s.) dhe zbatojnë çdo urdhër të Tij. Të gjithë sahabët e Pejgamberit (a.s.), i përkujtojnë me mëshirë, ndjejnë dashuri ndaj të afërmeve të Pejgamberit dhe i pranojnë virtytet e njerëzve të mëdhenj që kanë jetuar në të kaluarën.

Suu'dh-dhan, domethënë të menduarit keq për të tjerët, është shumë larg tyre. Veçanërisht për besimtarët, domethënë, për ata që i besojnë Allahut, pejgamberëve, engjëjve, librave të Tij dhe Ditës së Gjykimit.

Ata nuk mendojnë keq për asnjë. Ata kanë vetëm dhembshuri dhe mëshirë.

Stolitë e kësaj bote nuk janë të rëndësishme për ta. Për ta, më i forti i dynjasë, nuk është më i forti i vërtetë, më i pasuri, nuk është më i pasuri i vërtetë dhe sulltani nuk është sulltani i vërtetë.

Ata ndejnë keqardhje ndaj atyre që përpiqen për të zhvatur ndonjë gjë nga kjo botë dhe ndaj atyre që gëzohen pasi të zhvatin dhe të marrin. Shkaku është ky: e dinë se asnjë gjë e kësaj bote nuk është e përhershme dhe se herët apo vonë, do të ndodhë ndarja.

Ata i besojnë pjesës që është ndarë për ta dhe e dinë se ajo që është përcaktuar për ta do të vijë patjetër. Veçanërisht, shqetësimi për këtë çështje është shumë larg tyre.

Ata nuk kanë frikë nga asnjë krijesë. Kanë përparuar aq shumë në moral, saqë nuk kanë asnjë cilësi të keqe. Vetën e tyre e kanë privuar nga kjo botë, duke e kundërshtuar në mënyrë të vazhdueshme.

Ata përpiqen që t'ua bëjnë të dashur Allahun robërve të Tij, duke i bërë të vrapojnë në bindje ndaj Zotit, duke i bërë të pohojnë mirësitë që u janë dhënë, duke i bërë të kërkojnë falje për gabimet e tyre dhe veçanërisht duke i bërë të shërbejnë vazhdimisht për hir të Tij.

Ja pra vëlla, unë dua të bëhesh prej këtyre. Allahu Teala i ka bërë këta njerëz të tillë, që nuk i shtrijnë duart te pasuria e njerëzve. Duart dhe gjuha e tyre nuk u bëjnë dëm njerëzve.

Myslimanët jetojnë shumë lehtë me ta. Të keqes nuk i përgjigjen me të keqe, por falin. Ja pra, e gjithë shpresa dhe lutja ime është që ti të bëhesh njëri prej këtyre. Allahu ta mundësoftë këtë! Amin! Amin o Zot!

Imam Sharani ka thënë:

"Të gjitha fjalët e miqve të Zotit përmbajnë moral të lartë, por fjalë kaq përmbledhëse nuk kam parë në asnjë vend. Edhe veprat e të Nderuarit Ahmed Rifaiut janë shumë të larta nga aspekti i moralit." Allahu Teala qoftë i kënaqur prej të dyve!..

Le ta përfundojmë temën tonë me fjalët shumë të vlefshme të Ebu's-Suud bin Ebu'l-Ashair, i cili ka thënë:

"Ji vetvetja, mos ji neglizhent ndaj Zotit (xh.xh.) dhe adhuroje Atë me të vërtetë!

Mos u bëj prej atyre të cilët merren me pamjen e jashtme të ibadetit dhe e harrojnë Zotin (xh.sh.), i Cili është qëllimi në ibadet!



Emru bi'l-ma'ruf

VE'N-NEHJU ANI'L-MUNKER

Njëra prej detyrave më të mëdha të myslimanit është edhe thirrja e njerëzve të Zotit (xh.sh.) dhe të Islami. Muaji i Ramazanit, në të cilin të gjitha klasat e shoqërisë sonë janë më të ndjeshme nga aspekti fetar, është mundësia më e vyer për ta realizuar këtë detyrë. Muaji i Ramazanit, në të cilin shumë njerëz agjërojnë, falin namazet dhe mbushin plot e përplot xhamitë në taravih, është një muaj i shenjtë, në të cilin lidhen shejtanët me zinxhirë. Krahës kësaj, për fat të keq, shumë vepra të ndaluara rreptësisht në Islam, vazhdojnë të bëhen edhe në këtë muaj të madhërishtë. Besimtarit të përsosur nuk i ka hije të mos reagojë kundër këtyre apo t'i neglizhojë ato. Ahmed Gymyshanevi (k.s.), është shprehur: "Atij njeriu që nuk reagon për hir të Allahut, nuk i bën dobi asnjë vepër e tij. Të reaguarit për hir të Allahut Teala nuk është të bërtiturit majtas e djathtas, por t'u tregosh të vërtetën vëllezërve myslimanë që kanë rënë në haram, duke shfaqur dhembshuri ndaj tyre." Imam Rabbani (k.s.), i shikon haramet si një helm që vret shpirtërisht shoqërinë dhe njerëzit. Pastaj thotë: "Ne duhet të qëndrojmë larg sa të kemi mundësi prej gjërave që Allahu Teala i ka bërë haram. Gjërat prej të cilave Allahu (xh.sh.),

nuk është i kënaqur duhet t'i pranojmë si helm vrasës, duhet t'i kujtojmë vazhdimisht gabimet, të ndjemë turp prej tyre dhe të pendohemi për to. Ja, kjo është rruga e adhimit dhe nënshtrimit ndaj Zotit (xh.sh.). Ai që i bën këto gjëra, prej të cilave Allahu Teala nuk është i kënaqur, nuk turpërohet nga gjendja e tij dhe nuk pendohet, është njeri inatçi dhe i pabindur. Kjo gjendje, pothuajse e nxjerr atë nga feja dhe mund ta bëjë prej armiqve të Islamit." (Vëll. III, Letra e 67-ë.) Prej fjalëve të Imamit kuptojmë se vetëm zbatimi i disa farzeve nuk mjafton për shpëtimin e njeriut. E rëndësishme është që myslimani të largohet prej haramëve. Ndërsa besimtarët që nuk bëjnë haram, duhet të përpiqen t'i ndalojnë nga mëkatet ata që bëjnë mëkate. Kjo në Islam quhet emru bi'l-ma'ruf ve'n-nehju ani'l-munker, domethënë, urdhërimi për të mirë dhe ndalimi nga e keqja. Veçanërisht ata që kanë informacion nga feja, duhet t'i ndihmojnë në këtë çështje njerëzit dhe administruesit. Por për fat të keq, disa prej atyre që pandehin se dinë, po bëjnë të kundërtën e kësaj. Kështu, në vend që t'i thërrasin njerëzit të Zotit dhe të e vërteta, përpiqen t'i tregojnë si normale veprat e këqija që bëjnë për shkak të interesave vetjake që

kanë. Imami, në lidhje me këtë çështje, e paralajmëron një person i cili kishte autoritet te padishahu i kohës, Sulltan Xhihangiri duke i shkruar një letër:

“Mirësia më e madhe që shumë prej njerëzve nuk e perceptojnë, ndoshta edhe ti, është kjo: Sulltani i kohës sonë është mysliman që prej shtatë brezave, i përket Ehli Sunetit dhe medhhebit Hanefi. Ngaqë Sulltani i Lartë ua vë veshin dhe ua dëgjon fjalën, ju duhet ta shikoni këtë si mirësi të madhe dhe duhet t’ia shpjegoni Islamin në përputhje me rregullat e Ehli Sunetit. Tashmë, këtë detyrë kryejeni si të dëshironi, direkt apo tërthorazi. Këtë detyrë duhet ta merrni shumë seriozisht dhe përpiquni ta kryeni në mënyrë të vazhdueshme përgjatë bisedave me të.”

Imami ankohet prej shumë njerëzve që gjenden rreth e rrotull padishahut, të cilët hezitojnë për të thënë të vërtetën dhe e udhëzojnë gabim atë për shkak të interesave të tyre. Për njerëzit e tillë, që i shohim shpesh edhe sot, thotë: “Kjo është shumë pikëlluese: Në kohën tonë, e cila është afër Kiametit dhe larg nga koha e Pejgamberit (a.s.), disa dijetarë, duke iu bindur egos së tyre, po përpiqen t’u afrohen prijësve dhe sulltanëve. Ata po tolerojnë shumë për të rënë në sytë e prijësve dhe po përpiqen për të nxjerrë shumë dyshime mbi fenë tonë të vërtetë. Veçanërisht debatojnë mbi çështjet e dyshimta dhe i devijojnë të pasurit.” (Vëll. III, Letra e 67-ë.) Imami shprehet se myslimani i ditur nuk e ka për detyrë të shtojë dyshimet, por për ta lartësuar Islamin kundrejt të gjitha sistemeve njerëzore, sepse sot në botën islame ka shumë njerëz që krahas Islamit i pranojnë si normale sistemet dhe mënyrat e tjera të jetesës. Islamin po dëshirojnë ta burgosin vetëm në xhami, xhenaze dhe disa ditë të mira. Faktikisht, kur një njeri i mençur mendon pak, menjëherë e kupton se sistemet e tjera përveç Islamit janë të gabuara: “Njeriu i mençur nuk e pranon kufirin, sepse kufri shihet qartazi se është diçka e gabuar. Kështu që ai duhet ta kuptojë se kufri është diçka e humbur, pa menduar shumë mbi të dhe duhet t’i refuzojë zotat e pavërtetë pa hezituar aspak. Zoti i vërtetë

është Allahu Teala, që ka krijuar qiejt dhe tokën. Kjo e vërtetë duhet të shprehet me gjithë absolutësinë e saj pa lënë vend për hezitim apo shpjegim. Imami në veçanti, niset nga argumentet që jep Kurani kundër jobesimtarëve që nuk e besojnë Allahun e Lartësuar dhe ndjekin nefsin apo zotat e pavërtetë dhe i fton në meditim. Siç thuhet edhe në ajet, si dje edhe sot, njeriu që i beson shumë shkencës dhe teknologjisë, është i paafte për të krijuar qoftë edhe një mushkonjë. Si ka mundësi që njeriu, i cili është i paafte për të krijuar qoftë edhe një mushkonjë, e cila në pamjen e jashtme duket si e pavlerë, mund të mendojë se e gjithë kjo botë nuk ka krijues dhe zotërues. Imami thotë kështu në lidhje me këtë çështje:

“Ata adhurojnë në vend të Allahut atë që as nuk u bën dëm, as nuk u sjell dobi dhe thonë: ‘Këta janë ndërmjetësit tanë te Allahu!’ Thuaj: ‘A po i tregoni Allahut për diçka që Ai nuk e di në qiej dhe në Tokë? Qoftë i lavdëruar Ai dhe i lartësuar mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)!’” (Junus, 18)

“Vetëm Allahut i takon adhurimi i vërtetë. Sa për ata që marrin mbrojtës të tjerë, përveç Tij, duke thënë: ‘Ne u lutemi atyre vetëm që të na afrojnë tek Allahu’, Allahu me siguri që do t’i gjykojë për mos-pajtimet që kanë pasur. Vërtet, Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar e mohues.” (Zumer, 3)

Kjo lloj metode që e dhamë si shembull nga letrat e Imamit, është vetëm një version. Çdo besimtar mund të zhvillojë metoda të reja sipas mjedisit dhe bashkëbiseduesve të tij. Krahas kësaj, sipas Imamit, prijësit janë shpirti i shoqërisë. Nëse shpirti është i shëndetshëm, edhe trupi është i shëndetshëm. Në të kundërt, kur prishet shpirti, prishet edhe trupi. Përpjek-

ja për t’i ftuar sulltanët dhe prijësit në Islam, është përpjekje për të rregulluar të gjithë njerëzit. Nisur nga kjo, emru bi’l-maruf duhet të përfshijë çdokënd, si liderët, ashtu edhe popullin e thjeshtë. Allahu Teala na e mundësoftë të gjithëve që ta kryejmë me sukses këtë detyrë të shenjtë!

Amin!






Besimtari është si uji

Nuredin Jëlldëz

Besimtari dhe puna që bën ai, janë si uji. Siç është uji baza e jetës, edhe besimtari është një njeri që e ka perceptuar të fshehtën e krijimit të tij dhe të gjithësisë nga ana e Allahut Teala. Njeriu besimtar është i domosdoshëm si uji. Edhe veprat që bën, janë të nderuara. Ndërsa njeriu i privuar nga besimi është si shkuma. Edhe pse ka pamje tërheqëse, ajo është vetëm shkumë. Formohet në ujë, por nuk është si uji. Është e përkohshme dhe e pavlefshme. Veprat e njeriut të privuar nga besimi, nuk kanë vlerë. Ai që nuk është besimtar, bën vepra që do të shkrihen me përkohshmërinë e të përkohshmit, edhe nëse ka pamje madhështore. Ndërsa besimtari është kërkues i xhenetit të përhershëm. Ngaqë veten e shikon si meritues të përhershmërisë, e shfaq këtë cilësi edhe në punët që bën. Ai përpiqet për këtë dhe në këtë mënyrë.

Njeriu besimtar vepron me këtë perceptim kur punon për jetën ditore dhe kur bën ibadet për Zotin (xh.xh.). Ai nuk e shikon të hijshme për veten e tij që të bie në nivelin e shkumës.



Në ibadet përpiqet të arrijë shkallën e duhur. Edhe në marrëdhëniet me njerëzit përpiqet të arrijë nivelin e kërkuar. Nuk i pëlqen të bëhet i zakonshëm dhe i rëndomtë, sepse të jesh një njeri i zakonshëm dhe të bësh vepra të zakonshme, do të thotë të pranosh të jesh si shkuma. Ndërsa ai është si uji. Uji është jetë dhe i domosdoshëm për jetën.

Çfarëdo pune që të bëjë besimtari, ajo është e nderuar, është ujë e pastër .

Kur besimtari kryen ndonjërin prej ibadeteve, për shembull, kur fal namazin, nuk fal një namaz sipërfaqësor në vlerën e shumës. Namazi që fal ai është si uji. Ai namaz është burimi i jetës së tij. Ai bëhet burim jete, pra ashtu siç është uji, kur mban agjërim, kur bën haxhin, kur jep zekatin, kur lexon Kuranin, kur i mban të forta lidhjet farefisnore, kur përkuajt Allahun, kur lexon dhe kur shkruan.

Kur besimtari martohet dhe bëhet zot i familjes, ai përsëri e ruan natyrën e tij të ujit. Edhe nëse të gjithë njerëzit bëhen si shumë, ai është ndryshe prej tyre, është i nderuar dhe bën vepra të nderuara. Martesën e tij e realizon në kushtet e tokës dhe në shkallë qiellore. Ai nuk ka shpresa boshe duke prituri një lumturi të shkurtër, por hedh hapat e duhur për një lumturi të përhershme, duke synuar Xhenetin. Fillon dhe vazhdon me vepra sublime. Nuk shkrihet dot me vlerat e përkohshme. Vështrimet e ndërsjellta të partnerëve, durimi i ndërsjelltë ndaj njëri-tjetrit, shpresat, pritshmëria dhe ngushëllimet reciproke mund të jenë si uji por edhe si shkuma. Besimtarit i intereson uji i jetës në marrëdhëniet brenda familjes në të cilën merren rezultatet e prera për identitetin e tij.

Besimtari që ka fëmijë, e shikon jetën me këtë sy. I lind, i rrit dhe i edukon ata, por nuk i mbush me boshllëk të shumtë. Ai kurrë nuk heq dorë nga uji dhe vazhdimisht përpiqet të bëhet si i tillë. Kësaj i beson si domosdoshmëri e të qenit besimtar.

Durimi i besimtarit nuk është si shumë. Ai që nuk mashtrohet me gjëra të përkohshme, sigurisht se nuk ka një durim sipërfaqësor. Durimi i besimtarit reflekton identitetin e tij. Ai jeton me një durim të ujtë në ditën, natën, punën dhe shtëpinë e tij. Atë durim e ka edhe në ibadet, edhe në marrëdhëniet me të tjerët.

Besimtari është cilësor edhe në fjalët që zgjedh kur flet. Të folurit, të dëgjuarit, madje edhe të medituarit i ka plot jetë. Njeriu mund të njihet nga fjalët që thotë dhe fjalitë që përdor. Nga që identiteti i besimtarit mund të njihet nga gjuha dhe lëvizjet e trupit, ai nuk përdor fjalë të kota dhe nuk shfaq sjellje sipërfaqësore.

Besimtari udhëton, pushon, bisedon dhe argëtohet. Madje, ai argëton edhe të tjerët. Këto i shikon si mirësi të Allahut të Lartmadhëruar. Kur besimtari të arrijë të identifikohet si i tillë, qoftë në xhami apo qoftë në bahçen e çajit, atëherë ai ka filluar të fitojë kënaqësinë e Zotit dhe të njerëzve.

Besimi është një sjellje. Në të njëjtën kohë është një nivel. Është orientim dhe informacion identiteti.

Besimi është personalitet. Ky personalitet asnjëherë nuk është i pavërtetë. Të bëhesh si shkuma që shtohet kur tundet, është tjetër gjë dhe të bëhesh si uji e si baza e jetës, është tjetër gjë. Nëse duhet të zgjedhë, besimtari zgjedh të bëhet si uji.



Xhafer Durmush

Monumenti i mbështetjes dhe nënshtrimit ndaj Allahut

Familja e Ibrahimit (a.s.)

Mbështetje, do të thotë t'i besosh asaj që është te Allahu i Lartësuar dhe të mos ua hedhësh sytë asaj që kanë njerëzit. T'i besosh premtimit të Allahut të Madhëruar dhe të kërkosh mbrojtje vetëm nga Ai në çdo lloj situatë.

Ndërsa nënshtrim do të thotë të pranosh caktimin hyjnor, duke e pritur me kënaqësi shfaqjen e tij ndaj teje. Të qëndrosh i fortë në fe, pa ndryshuar në aparencë dhe në brendësi prej fatkeqësive që mund të të ndodhin. Këto të dyja janë dinamikat bazë që thurin personalitetin e myslimanit duke e mbrujtur me nënshtrim ndaj caktimit. Për këtë arsye, Allahu i Madhëruar urdhëron: **"Mbështetu në të Gjithëjetshmin, i Cili nuk vdes dhe madhëroje Atë me falënderim! Ai i di mjaft mirë gjynahet e robërve të Tij."** (Furkan, 58) Në një ajet tjetër, Allahu i Lartësuar thotë: **"...Besimtarët le të mbështeten vetëm tek Allahu."** (Ibrahim, 11) Allahu Teala u jep siguri robërve të Tij që i mbështeten, duke thënë: **"...Allahu i mjafton kujtdo që mbështetet tek Ai. Allahu e përmbush me siguri vendimin e Tij dhe për çdo gjë Ai ka caktuar masë."** (Talak, 3)

Hadithi fisnik në të cilin i Dërguari i Allahut, (a.s.), shprehet: **"Nëse do t'i besonit Allahut siç duhet, (Allahu) do t'ju furnizonte me risk sikur furnizon zogjtë..."** (Tirmidhi, Zuhd, 33), na afron një shkallë më lart drejt perceptimit të urdhrit hyjnor në ajetet e mësipërme. Me këtë shembull gdhend në mendje një mësim që mund ta shikojë dhe ta marrë çdokush që është i mençur. Pastaj na mëson të lutemi në këtë mënyrë: **"O Zot! Të jam nënshtruar, të kam besuar dhe të jam mbështetur Ty. Fytyrën e zemrën time e kam kthyer nga Ti dhe kam**

luftuar kundër armiqve me ndihmën Tënde." (Buhari, Tehexh Hud, 1)

Tani, njërin prej shembujve më të lartë në çështjen e mbështetjes dhe nënshtrimit ndaj Allahut Teala, duam t'ju japim nga hadithet fisnike të Pejgamberit, (a.s.). Ky shembull flet për nënshtrimin dhe mbështetjen ndaj Zotit (xh.xh.), që kishte Ibrahim (a.s.) dhe familja e tij.

Sipas transmetimit të Abdullah ibn Abbasit, (r.a.), historia e Ibrahimit, (a.s.), i cili me urdhrin e Allahut të Lartësuar e la bashkëshorten e tij Haxheren dhe birin e tij Ismailin afër një vendi ku do të ndërtohej Qabja, tregohet kështu në hadithin fisnik:

Ibrahimi, (a.s.), mori Haxheren dhe birin e tij, Ismailin (a.s.), i cili akoma nuk ishte ndarë nga gjiri dhe i çoi në Mekë. Ata i la nën një pemë të madhe që ndodhej në anën e sipërme të Qabes dhe të Zemzemit.

Atë kohë, në Mekë nuk kishte as njerëz dhe as ujë. Ja pra, Ibrahim (a.s.), e la bashkëshorten dhe birin e tij në atë vend. Pranë u la një torbë me hurma dhe një enë me ujë. Pastaj u kthye dhe filloi të largohej, por Haxherja e ndiqte nga pas dhe i thoshte:

-Ibrahimi! Përse po na lë në këtë luginë që nuk ka njerëz me të cilët mund të flasim dhe nuk ka asgjë për të ngrënë e për të pirë? Ku po shkon?

Këtë pyetje e përsëriti disa herë, por Ibrahim (a.s.), nuk iu përgjigj. Më së fundi, e pyeti:

-Allahu të ka urdhëruar të veprosh kështu?

Ibrahimi (a.s.), iu përgjigj:

-Po, Allahu më ka urdhëruar.

Haxherja i tha:

-Atëherë, Ai nuk na humb ne. Pastaj u kthye pas dhe shkoi te foshnja që kishte në pelena. Edhe Ibrahim (a.s.), vazhdoi rrugën. Kur arriti në vendin e quajtur Senije, ku nuk e shikonte më askush, u kthye nga ana e Qabes, i ngriti duart lart dhe u lut: **"O Zoti ynë, unë kam vendosur disa nga pasardhësit e mi në një luginë që nuk mbillet, afër Shtëpisë Tënde të Shenjtë, që të falin namazin. Prandaj, bëj që zemrat e njerëzve të ndjejnë dashamirësi për ta dhe jepu fruta, me qëllim që ata të të falënderojnë."** (Ibrahim, 37)

Në vazhdimin e hadithit fisnik thuhet kështu rreth kësaj ngjarjeje, që iu bë dhuratë njerëzimit si shembull i lartë në nënshtrim dhe mbështetje ndaj Allahut Teala:

Haxherja i jepte gjë Ismailit dhe pinte ujë nga ena. Së fundi, mbaroi uji në enë. Edhe vetë Haxheren, edhe birin e saj e zuri etja. Kur fëmija filloi të përpëlitej dhe të rrokullisej në tokë nga etja, Haxherja shkoi në kodrën më të afërt, Safa, për të mos parë gjendjen e birit të saj. Doli në majë të kodrës. Pastaj vështroi luginën, duke menduar se mos shikonte ndokënd, por nuk pa asnjë.

Pasi zbriti nga kodra dhe arriti në luginë, e mbledhi fundin e rrobës së saj që të mos e pengonte për të vrapuar. Pastaj filloi të vraponte me fuqinë e fundit të një njeriu që kishte ngelur në gjendje të vështirë. E kaloi luginën dhe shkoi në Merve. Doli në majë të kodrës,

duke menduar se mos shikonte ndokënd, por prapë nuk pa asnjë. Ndërmjet këtyre dy kodrave, shkoi dhe erdhi shtatë herë.

Ibn Abbasi, (r.a.)ma, në sqarim të këtij hadithi ka thënë: "I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *'Ja, për shkak të kësaj, njerëzit ecin me nxitim ndërmjet Safas dhe Merves.'*" (Buhari, Enbija, 9.)

Në vazhdimin e këtij hadithi të gjatë fisnik, tregohet për gjetjen e ujit të Zemzemit nga ana e Haxheres, ardhjen në Mekë të fisit Xhurhum dhe interesimin e vizitën që i bënte Ibrahim (a.s.), familjes së tij, pasi Ismaili (a.s.), arriti moshën e pjekurisë dhe u martua.

Me këtë ngjarje historike shumë emocionuese, desha t'ju them këtë: Sjelljet tona janë të vlefshme në raport me nënshtrimin dhe mbështetjen që kemi ndaj Allahut të Madhëruar. Pra, janë të vlefshme aq sa jemi të kënaqur nga Ai (xh.sh.). Aq sa t'i mbartim këto vlera në jetën tonë të përditshme, aq mund të bëhet edhe rregullimi i marrëdhënieve ndërnjerëzore.

Më e rëndësishmja e të gjitha këtyre dhe puna më e begatë që mund të bëhet për të rregulluar njerëzimin, siç shprehet edhe në lutjen e Ibrahim (a.s.), është vendosja e namazit në qendër të jetës dhe përpjekja për ta falënderuar Allahun e Lartësuar për mirësitë e pafundme që na ka dhënë.



EDUKATA E LOTËVE

Pasi Allahu i Madhëruar e njofton njeriun për regjistrimin e të gjitha veprave të mëdha apo të vogla, të fshehta apo të qarta që bën ai, e urdhëron t'i ndjekë me seriozitet paralajmërimet në Kuranin Fisnik. Për shembull, Allahu Teala kërkon që të kemi disiplinë në të qeshur e në të qarë dhe thotë: *"Le të qeshin pak dhe të qajnë shumë si dënim për atë që kanë bërë."* (Teube, 82)

Nga ky ajet kuptojmë se ne e kemi për detyrë të shikojmë të Dërguarin e Allahut (a.s.), në të gjitha detajet, që nga gjestet dhe mimika e deri te të qeshurit dhe të qarët. Edhe të qarët, edhe të qeshurit duhet të kenë një masë siç na ka mësuar Ai (a.s.).

Transmetohet se kur vdiq bija e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), gratë filluan të vajtonin. Omeri (r.a.), u zemërua dhe deshi t'i ndëshkonte.

I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha: *"Mos i prek o Omer! Lëri*

të qajnë." Ato i paralajmëroi: *"Largohuni nga mënyra e të qarit të shejtanit!"* Pastaj bëri këtë shpjegim, që na mëson të rezistojmë me seriozitet ndaj fatkeqësive: *"Nëse të qarët bëhet me sy dhe me zemër, është prej Mëshiruesit, nëse bëhet edhe me gjuhë, është prej djallit."* (Ahmed bin Hanbel, I, 238, 325.)

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: *"Qarja pa zë dhe dridhja në zemra është prej mëshirës hyjnore."* (Dejlami, Musned, hadithi nr. 241.) Po ashtu, ka njoftuar se *"është shkak për të shpëtuar nga zjarri i xhehenemit."* (Shik. Tirmidhi, Fadailu'l-Xhihad, 8.)

Gjallëria në burimet e lotëve dhe mëshira në zemra, janë kapitali më i vlefshëm i këtij umeti dhe dega që mund të mbahemi e që mund të tërheqim mëshirën hyjnore. Por nuk duhet të harrojmë se këto duhet të jenë brenda kornizave të traditës profetike.

MBRUJTJA me Kuran



Allahu Teala thotë:

“Sa për ata që u udhëzuan me udhëzimin hyjnor, (sa më shumë të dëgjojnë Kuran) Allahu u jep sukses dhe ua shton udhëzimin. Atyre u jep devotshmëri e vetëpërmbytje.” (Muhamed, 17)

Domethënë se hipokritët dëgjojnë Kuran, por nuk përfitojnë prej tij. Ndërsa atyre që Allahu Teala i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, përkundrazi, ua shton edhe më shumë udhëzimin, sepse kurdo që dëgjojnë Kuran, përpiqen për ta mësuar kuptimin e tij dhe besojnë me sinqeritet duke u bindur se ai (Kurani) është i vërtetë. Allahu i Madhëruar u jep devotshmëri zemrave të tyre. Si rezultat i kësaj devotshmërie që u jep në zemër Allahu Teala, ata përpiqen t'i zbatojnë urdhrat e Kuranit Fisnik dhe largohen prej ndalesave të tij.

Nisur nga kjo, kushdo që e ka të dobët devotshmërinë në zemër, domethënë ka pak frikë nga Allahu i Madhëruar, e ka të dobët edhe zbatimin e urdhrave të Allahut të Lartësuar. Si rezultat, bën shumë lëshime dhe nuk largohet aq shumë nga haramet.

Baza e devotshmërisë është zbatimi i të gjitha urdhrave hyjnorë dhe largimi në mënyrë kategorike nga të gjitha haramet që Allahu Teala i ka ndaluar.

Ata që ua shtojnë besimin besimtarëve janë Kurani dhe Suneti i Pejgamberit (a.s.).

Në suren Ankebut, thuhet:

“Ata që luftojnë për të ndihmuar fenë Tonë, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt udhëve Tona. Më të vërtetë, ndihma e Allahut është me muhsinët / punëmirët!” (Ankebut, 69)

Siç shpjegohet edhe në Tefsirin Hazin ue Medarik,

synimi me fjalën muxhadele (luftë), sipas një kuptimi, është përpjekja dhe munda për të kërkuar dije. Nisur nga kjo, kuptimi i ajetit është: “Ata që përpiqen dhe mundohen për të marrë dituri, sigurisht, Ne do t'i udhëzojmë drejt rrugës së dijes. Më të vërtetë, ndihma e Allahut është me punëmirët!”

Sipas një kuptimi tjetër, fjala muxhadele do të thotë zbatim i Sunetit të të Dërguarit të Allahut (a.s.), veprim me dijen e marrë dhe pendimin e bërë për mëkatet.

Sipas Fahri Raziut, kuptimi i ajetit është ky: “Ata që bazohen në argumentet të cilat vërtetojnë njësimin e Zotit dhe përpiqen të meditojnë mbi to, me të vërtetë do t'i udhëzojmë në besimin e drejtë.”

Muhsinët / vepërmirët janë ata që i kryejnë ibadetet sipas rregullave të sheriatit.

Enesi, (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë në një hadith kudsij:

“Allahu Teala ka thënë: ‘Nëse robi më afrohet një pëllëmbë, Unë i afrohem një krah. Nëse më afrohet një krah, Unë i afrohem një pash. Nëse vjen te Unë duke ecur, Unë shkoj te ai duke vrapuar.’ (Buhari)

Në ajetet fisnike, thuhet:

“...Allahu ia udhëzon zemrën kujtdo që i beson Atij...” (Tegabun, 11)

“...Atij që bën vepër të mirë, Ne do t'ia shtojmë shpërblimin. Allahu, me të vërtetë, është Falës dhe Mirënjohës.” (Shura, 23)

“Atij që dëshiron shpërblim në jetën tjetër, Ne do t'ia shtojmë atë. Ndërsa atij që dëshiron shpërblim në këtë jetë, Ne do t'i japim pjesë prej saj, por ai nuk do të ketë pjesë në jetën tjetër.” (Shura, 20)

Lumturia

Për disa, lumturia vjen vetvetiu, ndërsa dëshpërimi vjen prej një shkakut. Për disa të tjerë është krejt e kundërta.

A është një zgjedhje lumturia, e cila është synimi ynë i vetëm pas të cilit vrapojmë, nga e cila ikim pa e kuptuar, ndërkohë që përpiqemi për ta arritur, të cilën nganjëherë e presim pa bërë asnjë gjë dhe ia kuptojmë vlerën shpeshherë pasi ta kemi humbur? A kemi mundësi të themi: Sido që të jenë kushtet, preferoj të jem i lumtur?

Tani dua t'ju tregoj për një ngjarje që e kam parë në televizor dhe që më ka prekur. Në një program, po bëhej një reportazh me një burrë të shkretë e të rraskapitur që jetonte në gërmadha. Prezantuesi i zgjati mikrofonin dhe e pyeti: "A mërzhitesh?" Përgjigjja që dha burri i ngratë, ishte: "Jo, nuk mërzhitem." Buzëqeshja e tij kur u përgjigj, tregoi qartazi sinqeritetin e tij. Ndoshta ky është kuptimi i fjalës: "Thesaret janë të fshehura nën gërmadha." Mesa duket, ai e kishte gjetur thesarin e tij në ato rrënoja.

Ai që kërkon lumturinë dhe ai që kërkon dëshpërimin, arrijnë ta gjejnë një rrugë për të shkuar te synimi i tyre.

Të gjithë pohojmë se dëshirojmë të bëhemi të lumtur, por thellë në vetvete nuk ngurojmë të gjejmë pretekste për t'u dëshpëruar. Dhimbjet e së kaluarës dhe shqetësimet për të ardhmen, mjaftojnë për t'i shkatërruar edhe gastet më të bukura.

Në filmat e vjetër thuhet: "Jam aq i lumtur, saqë frikësohem mos e humb këtë lumturi." Ky këndvështrim ka hasur në shumë replika. Ndoshta ky është reflektimi i këndvështrimit tonë shoqëror ndaj lumturisë. Nëse lumturia është e lidhur me kushtet, kategorikisht ndryshon edhe ndjenja që formohet kur ndryshojnë këto kushte. Të frikësuarit nga kjo është rezultati i karakterit tonë, që nuk i perceptojmë si të përkohshme gjërat që i duam.

Në jemi të përkohshëm dhe duam atë që është e përkohshme, pastaj frikësohemi dhe brengosemi nga të zhdukurit e saj. Shpirti nuk duhet të konsiderohet i padrejtë kur kërkon Atë që është i përhershëm, sepse qëllimi i krijimit të shpirtit është kërkimi dhe admirimi i Tij. Ngaqë shpirti është krijuar për xhenetin dhe ngaqë mallëngjehet për "selamin" e përjetësisë, mirësitë e kësaj bote nuk janë zgjidhje për hallin e tij, edhe nëse rrjedhin si rrëkeja.

Formula e lumturisë, edhe pse është e ndryshme nga ajo e këngëve, me të vërtetë është shumë ashiqare. Allahu thotë në Kuran: "...Me të vërtetë, Allahu shpie në humbje ata që Ai do, ndërsa udhëzon në rrugë të drejtë ata që kthehen tek Ai, ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve qetësohen kur përmendet Allahu. Vërtet, zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut!" (er-Ra'd, 28.)

Analizimi i një udhëtimi

Për ta mësuar lumturinë e vërtetë, këtë herë shkuam në kohën e lumturisë, pra në kohën e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Para na doli tregimi i një udhëtimi të bekuar. Mësimet rreth familjes, i patëm marrë nga ajetet e Kuranit dhe nga histori të ndryshme. Njëra prej këtyre historive është edhe udhëtimi i bekuar i Profetit Muhamed (a.s.) me shokun e tij Ebu Bekrin (r.a.).

Një rrugë, dy udhëtarë dhe një udhëtim i vështirë. Pas kishin armikun, ndërsa përpara një rrugë të gjatë. Mbi supet e tyre rëndonte lodhja e një udhëtimi të gjatë. Një moment, vendosën të pushonin. Gjetën një vend. Njëri prej udhëtarëve hyri i pari në shpellë, në mënyrë që tjetrit të mos i ndodhte ndonjë gjë e keqe. E pastroi vendin brenda. I mbylli të gjitha vrimat, në mënyrë që të dashurin e tij të mos e dëmtonte ndonjë gjë. Ndërsa vrimën e fundit e mbylli me dorën e tij, ngaqë nuk kishte gjë tjetër për ta mbyllur. Të gjithë e dini këtë udhëtim dhe i njihni udhëtarët e bekuar të këtij udhëtimi. Njëri është më i dashuri, i Dërguari i Allahut (a.s.) dhe tjetri është i dashuri i më të dashurit, Ebu Bekri (r.a.).

Një rrugë, dy udhëtarë dhe një udhëtim i vështirë. Prapa kishin barrën që ua patën ngarkuar vitet në supet e tyre dhe gjallërinë e rinisë. Ata vendosin për ta vazhduar rrugën bashkë për ta hedhur nga supet e tyre qoftë edhe pak lodhjen që ua kishin dhënë vitet, për të arritur prehjen... Rruga është e gjatë dhe e lodhshme. E mbushur me pengesa dhe gropa. Të ecurit bashkë kërkon sakrificë.

Dy udhëtime që i ngajë shumë njëri-tjetrit. Vetëm koha dhe njerëzit janë të ndryshëm. Dy njerëz që e duan njëri-tjetrin. Një udhëtim i gjatë dhe i vështirë. I dashuri i më të dashurit, Ebu Bekri (r.a.), na jep një mësim që prej shekujsh. Sigurisht se për ata që kanë vendosur të ecin bashkë në rrugë dhe që e duan njëri-tjetrin...

Tani është koha e mësimet.

Ebu Bekri (r.a.), kaloi një hap përpara Tij, në mënyrë që të mos dëmtohej i dashuri. Pastaj u përpoq t'i mbyllte të gjitha vrimat nga të cilat mund të dëmtohej Ai. Kur nuk gjeti gjë tjetër për t'i mbyllur vrimat, trupin dhe qenien e tij e bëri mburojë për të dashurin. Me këtë histori, që prej shekujsh, na është treguar se si duhet të sillemi ndaj të dashurit tonë.

Po ne, a i kemi mbyllur vrimat nga të cilat mund të dëmtohet i dashuri ynë? A e kemi sakrifikuar veten, në mënyrë që ai të mos dëmtohet? A u kemi rezistuar dot gjarpërinjeve që kafshojnë, vetëm e vetëm që ai të jetë mirë?

Udhëtimi është i gjatë dhe i vështirë, por nëse e keni gjetur Ebu Bekrin tuaj, udhëtimi është po aq i bukur dhe i sigurt.

Të gjesht Ebu Bekrin tënd...

Të jesh Ebu Bekër...

Sa e vështirë, apo jo?

Ngashënjimi I HARMONISË

Idris Arpat

Allahu i Lartësuar thotë në Kuranin Fisnik: **“Me të vërtetë, Ne i dhamë Daudit mirësi prej Nesh (dhe thamë): ‘O male dhe zogj! Lavdërojeni emrin Tim bashkë me Daudin’. Ne ia zbutëm atij hekurin (dhe i thamë): ‘Puno parzmore të gjera! Thuri ato me maja të barazpeshuara dhe bëj vepra të mira! Pa dyshim, Unë shoh çfarë punoni ju.”** (Sebe, 10-11)

Muhjiddin ibnu'l-Arabiu ka thënë: “Pejgamberi (a.s.), ka lënë dy trashëgimi të mëdha: fisnikërimin e personalitetit dhe dashurinë ndaj së bukurës.” (Revista Letërsia turke, 426, fq. 39.)

E para është edukimi dhe e dyta pothuajse shpreh rezultatin e së parës. E para është zbukurimi i njeriut dhe e dyta është zbukurimi i mjedisit në të cilin jeton.

Kur shtjellojmë natyrshmërinë e njeriut, ajetet dhe hadithet fisnike në lidhje me të dhe shpjegimet e shkencëtarëve, shihet qartë se njeriu duhet të jetojë duke i pakësuar gabimet dhe duke i shtuar virtytet. Unë mendoj se baza e të gjitha mirësive në jetë është që njeriu, i cili është krijuar në formën më të bukur, të rritet shpirtërisht, mendërisht dhe fizikisht. Është e qartë se një njeri që ka dituri, ndjenjë dhe vizion nuk kënaqet me një jetë boshe dhe të zakonshme, vrapon pas idealeve të larta dhe përpiqet jashtëzakonisht që

dynjanë ta kthejë në xhenet. Ja, pikërisht në këtë pikë do të ishte e drejtë të themi se lartësohet personaliteti i njeriut dhe mirësitë bëhen bazat e tij. Është e qartë se një njeri me vlera dhe me shpirt të ndjeshëm mahnitet ndaj çdo lloj bukurie. Nga kjo mahnitje lindin shumë gjëra të bukura. Kjo është një çështje që dihet. Këto dy parime janë dy themele të pandashme. Ndoshta është më e drejtë të themi që secili prej tyre është ndërmjetësues për tek tjetri.

Çdo gjë që ka krijuar Allahu Teala, e ka krijuar në formën më të bukur. Gjithësia pothuajse është krijuar duke përdorur matematikën dhe gjeometrinë e shkallës më të lartë. Në çdo gjë ku nuk ka ndërhyrje të njeriut, sado që të shikoni, do të përballeni me një masë dhe harmoni.

Ibnu'l-Arabiu ka thënë: “Njeriu ka ardhur në këtë botë për arritjen e përsosmërisë dhe për vështtrimin e bukurisë.” Njeriu e arrin përsosmërinë duke vëzhguar bukurinë në mënyrë të vazhdueshme. Mund të thuhet edhe e kundërta: Sa më shumë të përparojë në rrugën e përsosmërisë, do t'i shtohet edhe më shumë kureshtja për harmoninë. Ai që shikon bukur, mendon bukur. Ai që mendon bukur, e shijon jetën dhe arrin kënaqësitë shpirtërore.

Universi është i mbushur me bukuri. Disa njerëz kanë

një bukuri që lapsi dhe fjalët nuk mjaftojnë për ta përshkruar. A është e mundur të përshkruhet bukuria e një fëmije të pafajshëm?

Si ta përshkruajmë bukurinë e një mali dhe të një përroi? Siç nuk është e mjaftueshme ta lexosh dhe ta ndjesh bukurinë e malit, nuk është e mjaftueshme ta shohësh edhe me syrin e lirë. Atë duhet ta shikojmë me syrin e zemrës. Për ta bërë këtë, duhet të ndikohemi shpirtërisht, të mahnitemi dhe të ndiejmë admirim. Ky është një virtutet i posaçëm për njerëzit e mëdhenj. Ai nuk arrihet lehtë. Përballë madhësisë së malit mund të ndikohen shkallë-shkallë me mijëra njerëz, por numri i njerëzve që mahniten dhe ndiejnë admirim, nuk i kalon gishtat e dorës. Kjo është një shkallë sublime, që nuk arrihet lehtë.

Bukuria e mijëra maleve dhe e mijëra përrenjve. Gjithë ato bukuri të një përroi apo një mali në mijëra persona të ndryshëm.

Bukuria e pemëve, e kimbave, e zogjve, e shirave që bien, e dëborës dhe e grumbujve të reve. Miliarda bukuri të veçanta të miliarda pemëve, miliarda kimbave dhe miliarda zogjve.

Shirat që bien në errësira të frikshme, rrufetë që shpërthejnë dhe bubullimat që tronditin qiellin e tokën...

Çfarë dëshiron të thotë Krijuesi i Lartësuar me këto shfaqje bukurie? Cili është synimi hyjnor? Kujt i flasin këto mijëra bukuri nëpër majat e maleve, që këmba e njeriut s'ka arritur t'i shkelë?

Këto pyetje na shpien te mendimet dhe kërkimet.

Ka shumë gjëra të bukura që kalojnë pranë njeriut dhe ikin prej tij, por ai nuk i percepton, ngaqë është i zhytur në neglizhencë. Sa të paktë janë ata që i kuptojnë këto mirësi të papërshkrueshme!

Çdo gjë që e ka krijuar Allahu i Madhëruar, e ka krijuar në formën më të bukur. Ngado që të shikoni, do vini re harmoni, ekuilibër dhe përputhje.

Edhe pse nuk është e prerë se rregulli "përsoseni moralin tuaj me moralin hyjnor" është hadith, specialistët thonë se shpreh një kuptim të vërtetë. Ky rregull lind mendimin për t'i dhënë hakun punës që bën. Allahu Teala, i Cili çdo gjë e ka krijuar në mënyrë të përsosur, pëlqen robërit që përpiqen t'ia japin hakun punës. Një njeri që e percepton se jeton nën mbikëqyrjen hyjnore, sigurisht se përpiket të jetojë, flasë dhe veprojë sipas kënaqësisë së Zotit (xh.xh.). Një vepër që do të paraqitet në audiencën e madhe, duhet të jetë një vepër së cilës i është dhënë haku. Mendimi për ta bërë diçka sipas kënaqësisë së Allahut të Madhëruar, në të njëjtën kohë është ibadet.

Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), po varroste birin e Tij, Ibrahimin, i tha varrmihësit ta bënte varrin të sheshtë. Kur e pyetën për arsyen e kësaj, u shpreh se syrit nuk i dukej mirë dhe jo se mund t'i bëjë ndonjë dëm të vdekurit. Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), kërkoi që edhe fundi i varrit, që do të mbulohej pas dhjetë minutash, të dukej mirë për syrin, imagjinojeni se sa rëndësi i jepte harmonisë së një ndërtese, lagjeje apo qyteti që do të formohej. Përsëri është ky i Dërguar (a.s.), që ka thënë: *"Me të vërtetë Allahu urdhëron që çdo gjë ta bëni bukur."*

Përshkrimet e Xhenetit, që nga fillimi e deri në fund, janë të një natyre që zgjojnë mallin për harmoni. Njëri prej synimeve hyjnore prej këtyre përshkrimeve mund të jetë ky: Kur të formoni botën tuaj, merrni parasysh xhenetin! Xheneti është "daru's-salam" / vendi i paqes. Allahu Teala thotë në Kuran:

"Ai ka krijuar jetën dhe vdekjen, për t'ju provuar se kush prej jush do të veprojë më mirë. Ai është i Plotfuqishmi dhe Falësi i madh." (Mulk, 2)

Çështja për të cilën po sprovohemi është: "Cili prej nesh do të jetë më vepërmirë?"

Sigurisht se me veprën kuptohet qartë që është ajo e mira. Vepër do të thotë punë dhe sjellje. Rezultati i sjelljes është vepër. Kjo vepër, siç mund të jetë ibadet dhe moral, mund të përmbajë edhe ndjenja e mendime. Por mund të jetë plotësisht edhe materiale.

Çdo lloj vepre që mund të bëjmë, duhet të synojmë ta kryejmë në formën më të bukur. Siç nuk ka fund e mira dhe mirësia, gjithmonë nuk do të ketë fund edhe bukuria. Pamjaftueshmëria me gradën e arritur është ajo ndjenjë që e shpie njeriun në kërkimin e bukurive të reja, cilësive të larta dhe mallit për gjërat sublime. Kjo realizon zhvillimin e botës njerëzore drejt përsosjes materiale dhe shpirtërore.

Xheneti është vendi në të cilin çdo lloj bukurie është në kulmin e saj. Më mirë se Xheneti nuk ka. Prandaj le të themi: Esmau'l-Husna do të shfaqen atje përgjithmonë në mënyrë të përsosur. Në shfaqjen e secilit prej emrave, nuk bëhet fjalë për përjetim vështirësie nga ana e Fuqisë së Lartë. Nisur nga kjo, Xheneti do të jetë një vend tërësisht tjetër në të cilin do të ketë mirësi e bukuri, që fjalët nuk mund t'i shprehin. Krijuesi i Lartë do ta vazhdojë krijimin e Tij. Deri ku do të arrijë kjo?

Ja, këtu është vendi ku mbarojnë fjalët.



Adem Saraç

Zonjë

Një ditë prej ditëve të bukura të jetës plot sihariqe të Pejgamberit (a.s.)...

Një ditë që do ta bënte Ummu Ejmen Berekën të fluturonte nga gëzimi...

Njëra prej zonjave sahabe fatlume, e cila me moralin e saj të bukur, kishte hapur derën ndaj një bote të re, e bëri rrugën me hapa të shpejtë dhe shkoi në shtëpinë e Ummu Ejmenit. Fryma po i merrej. Gjendja e saj e shqetësoi Ummu Ejmenin! Edhe pse po merrte frymë me vështirësi prej lodhjes, menjëherë i tha:

-O Ummu Ejmen! A e di çfarë ka thënë i Dërguari i Allahut?

-Nga ta di nëse nuk ma thua! Por ji e sigurt se çfarëdo që të ketë thënë, patjetër është e vërtetë. Për këtë nuk kam aspak dyshim!

"Ai që dëshiron të martohet me një grua prej banorëve të Xhenetit, le të martohet me Ummu Ejmenin!"

Ummu Ejmeni u hodh nga vendi me një lëvizje të pavetëdijshme sikur të kishte pësuar një goditje në zemër! U zverdh në fytyrë dhe i ndryshoi ngjyra! Mezi arriti të fliste.

-A e kupton se çfarë thua?

-Unë të tregova atë që tha i Dërguari i Allahut, (a.s.), për ty!

-Pse u zverdhe kaq shumë?

1. Ibn Is'hak, Siretu Ibn Is'hak Musemma bi Kitabi'l Mubtede' ve'l-Meb'as ve'l-Megazi; fq. 385; Ibn Hisham, es-Siretu'n-Nebevije, vëll. 2, fq. 342

-Me të vërtetë ka thënë ashtu i Dërguari i Allahut, (a.s.)?

-Unë të tregova vetëm ato që tha! Ne e dimë të gjithë se ti nuk mendon të martohesh.

-Nuk është kjo që më tronditi mua, fqinje!

-Çfarë të tronditi atëherë?

-Fjala e Tij!

-Edhe unë prandaj erdha tek ti, që të të lajmëroja! Çdo fjalë e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), është e vlefshme për ne! Por këtë fjalë e tha veçanërisht për ty! Unë u gëzova shumë për ty dhe desha të ta sillja lajmin menjëherë!

-Ma thuaj edhe një herë atë që tha!

-Ai që dëshiron të martohet me një grua prej banorëve të Xhenetit, le të martohet me Ummu Ejmenin!

Ummu Ejmeni u përkeqësua përsëri. Pothuajse do t'i binte të fikët. Mezi e mblodhi veten, u ngrit dhe iu drejtua fqinjës së saj:

-A me të vërtetë ka thënë kështu? A kështu ka thënë i Dërguari i Allahut (a.s.)?

-Çfarë po të ndodh, Ummu Ejmen?

-A mund ta përsëritësh edhe një herë? A mund ta përsëritësh edhe një herë atë fjalë të mrekullueshme?

-Ai që dëshiron të martohet me një grua prej banorëve të Xhenetit, le të martohet me Ummu Ejmenin!

-Aman o Zot!



Xheneti

Ummu Ejmeni po lëkundej si një rrap i madh majtas e djathtas. Sapo do të rrëzohej, e kapi fqinja e saj...

-Çfarë ke për hir të Zotit? Nëse nuk dëshiron të mar-tohesh, mos u marto Ummu Ejmen! I Dërguari i Allahut, (a.s.), nuk të detyron për këtë.

-Për fat të keq, çështja nuk është martesë, fqinje! Mua më tronditën fjalët mahnitëse të Tij!

-Si?

-Përgëzimi "*grua prej banorëve të Xhenetit*" që ka thënë për mua!

-Si nuk e kuptova unë këtë! Edhe pse të njoftova për këtë përgëzim! I Dërguari i Allahut, (a.s.), të cilëson si "*grua prej banorëve të Xhenetit*".

-Me të vërtetë, a je e sigurt se ka thënë kështu?

-Jo vetëm unë, por të gjithë që gjendeshin aty e dëgjuan këtë. Pas pak do të vijnë edhe ata për të të përgëzuar.

-"*Grua prej banorëve të Xhenetit!*" Aman o Zot! Sa larg jam unë dhe sa larg është të qenët grua prej banorëve të Xhenetit!

-Por i Dërguari i Allahut, (a.s.), ashtu tha!

-Nëse Ai ka thënë, ka thënë të vërtetën, por unë nuk e meritoj këtë!

-A e di më mirë ti se Ai, o Ummu Ejmen?

-Estagfirullah! Me mijëra herë estagfirullah! Sigurisht se Ai (a.s.), e di më mirë.²

Ummu Ejmeni u ul në vendin ku ishte dhe filloi të qante. Nga ana tjetër qante me dënësë: "*Grua prej banorëve të Xhenetit, ë? Grua prej banorëve të Xhenetit?* Po qante aq shumë, saqë fqinja e saj s'po e qetësonte dot.

Fqinja e saj e pa se kjo qarje me dënësë ishte nga gëzimi i përgëzimit "*grua prej banorëve të Xhenetit*" dhe nuk ndërhyri më. Madje, nuk rezistoi dot dhe filloi të qante bashkë me të.

Si të mos qante? A nuk qahet për një gëzim të tillë?

Ndërkohë erdhën edhe gratë e tjera. Edhe ato sollën të njëjtin përgëzim. Ato e përgëzonin dhe e uronin këtë zonjë të bekuar.

Ummu Ejmeni (r.a.), e cila dëshmoi çdo gjë të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), që nga lindja e derisa ndërroi jetë, kishte një zemër shumë të ndjeshme dhe të butë. Ajo e donte të Dërguarin e Allahut (a.s.), më shumë se veten e saj.

Ummu Ejmeni jetonte çdo çast me të Dërguarin e Allahut, (a.s.), në çdo gjë reflektonte atë dhe e gjithë jeta e saj pothuajse ishte e veshur me atë (a.s.). Ajo e donte aq shumë Pejgamberin (a.s.), saqë një ditë ai tha: "*Ajo ishte nëna ime pas nënës sime.*"

Ummu Ejmeni e kishte përqafuar Islamin me të gjithë qenien e saj dhe që në këtë botë, u bë prej të përgëzuarve me Xhenet.

Lum për ata që janë përgëzuar nga i Dërguari i Allahut (a.s.)!

2. Ibn Haxher Askalani, Isabe fi Temjizi's-Sahabe, 11849; Muhammed Raci Hasen Kennas, Rasûlullah'in Etrafindaki Hanım Sahâbîler, fq. 71



EBU BEKRI

Nuredin Jëldëz

Allahu qoftë i kënaqur prej tij. Në muret e xhamive tona është shkruar emri i Tij. Emri i tij përkujtohet bashkë me emrin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Ai u bë simboli i besnikërisë, miqësisë dhe sakrificës. Deshi me gjithë zemër dhe arriti kulmin e dashurisë. Deshi, po aq edhe u desh. Ai nuk u harrua dhe nuk do të harrohet deri në mëngjesin e Kiametit.

Ai doli në krye të njerëzimit si njeriu i parë dhe i vetëm. U bë emri i parë i këtij umeti pas Pejgamberit, (a.s.). Në emër të tij u shkruan libra dhe u bënë poezi. U bë shembull dhe u mor për shembull. Atë e deshi Allahu, e deshi i Dërguari i Allahut, e deshën të gjithë besimtarët.

Që nga dita e parë e deri në ditën e fundit, u bë

shoku dhe ngushëlluesi i të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), i kërkoi, dha pasurinë, fëmijët dhe jetën. I harroi ato që dha, por kurrë nuk harroi të jepte. Allahu i Lartësuar e kishte zgjedhur atë si mikun e parë të pejgamberit të fundit. Edhe ai ia dha hakun kësaj zgjedhjeje. Çdo ditë e tij ishte më produktive se dita e mëparshme. Ai shfaqti shembujt më të lartë të besnikërisë dhe mirësisë. Nuk hezitoi dhe as nuk u lodh. Jetën e kësaj bote prej njëzet e pesë vitesh që e kaloi si besimtar, e administroi në shërbim të së mirës me plot qenien e tij. Mblodhi të gjitha veprat e bukura dhe shkoi te Zoti (xh.xh.). Ditën dhe natën, atë që kishte dhe atë që s'e kishte, domethënë çdo gjë e vlerësoi në mënyrën më efikase.

Askush nuk e pa të lodhej dhe asnjëherë nuk e shfaqti një gjë të tillë. Duroi, rezistoi dhe arriti pozitën më të lartë, pastaj u largua nga kjo botë...

Allahu qoftë i kënaqur prej tij!

Ai jetoi si një personalitet, i cili nuk konsiderohet se është kuptuar derisa të flasim për të dy anët e tij. Ana e parë e tij ishte ana që e bënte si të gjithë shokët e tjerë. Edhe ai e fali namazin si gjithë të tjerët. Madje, e fali në mënyrën më të bukur. U bë njëri prej xhematit. Më së fundi, u bë imami i atij xhemati. Bëri haxhin dhe u bë prijës i haxhit. Ishte njëri prej atyre që jepte zekat. Mbajti agjërim në muajin e Ramazanit. Mori pjesë në luftën e Bedrit dhe në luftën e Uhudit. Çdo gjë që e bënte një besimtar, e bëri edhe ai. Ditën e kaloi me vepra që dokumentonin se e donte Allahun Teala. U qëndroi pranë vëllezërve besimtarë dhe u interesua për ta. U dha lirinë robërve të tij. I vizitoi të sëmurët dhe mori pjesë në xhenazen e atyre që ndërruan jetë. U bë prej atyre që shfaqnin vetëm mirësi. Emri i tij përmendej i pari, kur bëhej fjalë për bindjen e menjëhershme ndaj ajeteve të durimit. Çfarëdo që urdhëroi Allahu Teala, ai e zbatoi, madje u përpoq që ta zbatonin edhe të tjerët.

Ky është identiteti i parë i Ebu Bekrit. Ky identitet i dha atij cilësinë "mysliman i mirë". Bëri çdo gjë që bënë të tjerët, madje, në formën më të mirë. Mori sevape dhe fitoi atributë.

Allahu qoftë i kënaqur prej tij. Në atë identitet të pasiqd të Ebu Bekrit, kishte edhe një anë tjetër që doli në pah. Me këtë anë të dytë, e meritoi të bëhej burri i parë i këtij umeti pas të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Fronin që e pati bërë në zemrat e të tjerëve, e forcoi edhe më shumë në politikë, histori dhe në çdo fushë të këtij umeti. Këto vepra të Ebu Bekrit, që shndërroheshin në një pasuri ahireti për të, u bënë fitim edhe për umetin. Për të bërë, i bëri Ebu Bekri, por fitoi edhe umeti. Kjo anë e tij, që e bënte umetin të fitonte me atë që bënte ai, edhe pse ishte një prej umetit, e nxori nga të qenët një sahab i zakonshëm, e

bëri një sahab të pasiqd dhe një besimtar me grada më të larta.


Kur bëri hixhretin bashkë me të Dërguarin e Allahut, (a.s.) dhe në ditët kur qëndruan në shpellë, ai ishte Ebu Bekri i parë. Në atë shpellë fitoi sevape dhe atributë të mëdha. Ditën kur ndërroi jetë i Dërguari i Allahut, (a.s.), Ebu Bekri e mori përballë tij edhe Umerin, që s'po e përballonte dot këtë ngjarje që i mbyti në pikëllim qiejt e tokën dhe i tha: "Kushdo që e ka adhruar Muhamedin, le ta dijë se Muhamedi ka vdekur. Kushdo që ka adhruar Allahun, Allahu është i Gjalli dhe i Përjetshmi." Me këtë sjellje, Ebu Bekri, (r.a.), na tregoi identitetin e dytë të tij. Mendimi për ta mbajtur në planin e parë fenë e mikut të tij

të dashur, Pejgamberit (a.s.), me të cilin qëndroi nga dita e parë e deri në atë të fundit, është një shfaqje e të qenit një Ebu Bekër tjetër. Allahu qoftë i kënaqur prej tij. Të qarët e tij atë ditë, mund të shihej si të qarët më me vend, por në vend që të qante, mendoi për të ardhmen e umetit. Harmoninë njëzet e pesëvjeçare e la në një anë dhe ngriti në këmbë hilafetin, duke u shqetësuar për të ardhmen e umetit. Në vend që të mbante zi pas Pejgamberit, (a.s.), vendosi të përhapte fenë e Tij sa të mundej. Ushtrinë e Usamës e nisi për në front. E mbloodhi Kuranin. Rezistoi kundër mosdhënies së zekatit. E

mbajti gjallë Sunetin e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Muhamedi, (a.s.), ndërroi jetë, por Ebu Bekri nuk lejoi të vdiste feja e Tij.

Me këtë anë të tij, Ebu Bekri u bë burrë i këtij umeti. Allahu qoftë i kënaqur prej tij! Mendoi dhe bëri gjëra të mëdha. Nuk jetoi për veten e tij. Qëndroi pa gjumë për umetin. Kohën nuk e kaloi me kujtime, por pas la kujtime të pafundme. Ai shkoi te Zoti (xh. sh.), si një njeri që mund të merrej shembull.

Allahu qoftë i kënaqur nga ai sahab i madh dhe shembullor! Sigurisht se askush nuk do ta meritojë deri në Kiamet që t'i thuhet "ja myslimani shembullor", siç thuhet për Ebu Bekrin.



Roli i agjërimit në arritjen e devotshmërisë

Ka dy gjëra themelore që e përcaktojnë cilësinë tonë njerëzore, vlerën tonë te Allahu Teala dhe më tej, që na shpien te formimi i miqësisë me Të: besimi dhe devotshmëria. Çdo besimtar, që me mirësinë e Allahu Teala, e njeh Atë si të Vetmin që mund të adhurohet, do të thotë se ka hedhur hapin më të rëndësishëm në jetë, që do ta shpëtojë atë nga ndëshkimi i përhershëm i xhehene-mit. Tashmë, pas këtij hapi, i është hapur horizonti i një lartësimi drejt pafundësisë.

Nëse përpiqet me dëshirë, përmallim dhe mallëngjim të madh pa rënë në neglizhencë ndaj Krijuesit fuqiplotë, mund të shtojë çdo çast gurë të çmuar në kurorën e nderimit të tij. Emri i udhëtimit të këtij lartësimi drejt kënaqësisë hyjnore është “udhëtimi i devotshmërisë”.

Devotshmëria është një operacion mbrojtjeje kundër çdo lloj rreziku që e ndyn, përdhos dhe në fund, që mund ta rrokullisë personalitetin në esfelin safilin. Ajo është përpjekje për të mbrojtur veten kundër çdo gjëje që mund ta ulë njeriun nga xheneti për të cilin është krijuar.

Ajo e ndihmon njeriun që zemrën, adhurimin, jetën dhe vdekjen e tij t’ia dedikojë vetëm Allahut Teala. Ajo është mundësia për të shprehur dhe për të jetuar jetën me vetëdijen e këtij ajeti kuranor, në të cilin Allahu i Madhëruar shprehet:

Thua: “Në të vërtetë, namazi im, kurhani im, jeta ime dhe vdekja ime, i përkasin vetëm Allahut, Zotit të botëve.” (En'am, 162)

Ruajtja e mendimeve, ndjenjave, fjalëve dhe sjelljeve brenda kornizës së një koncepti të tillë, është një fitore e madhe shpirtërore. Dhurata e kësaj fitoreje është arritja e shpëtimit të madh në dynja e ahiret dhe së fundi, fitimi i miqësisë me Allahun Teala. Për udhëtimin e devotshmërisë ka mjete dhe ushqime të ndryshme. Këto janë shprehur me mënyra të ndryshme në Kuranin Fisnik dhe në hadithet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.).

Në këtë material do të përpiqemi të tregojmë disa vlera që agjërimi gdhend në personalitetin tonë përgjatë udhëtimit të devotshmërisë. Sepse në fund të ajetit fisnik, që njofton obligueshmërinë e agjërimit, thuhet se “në sajë të agjërimit, mund të arrihet devotshmëria” dhe është tërhequr vëmendja ndaj “agjërimit”, sikur Allahu Teala dëshiron të thotë:

“O robërit e Mi që dëshironi të bëheni të devotshëm! Ja një mënyrë që mund t’ju shpjerë te devotshmëria”

Cila mund të jetë fshehtësia që e bën agjërimin kaq ndikues në arritjen e këtij rezultati? Sigurisht se vetëm Allahu Teala i di të gjitha të fshehtat, sepse vetëm Ai e di totalisht të dukshmen dhe të padukshmen. Për

1. Bekare, 183.

këtë arsye, së pari u besojmë shpalljeve që vijnë nga Ai, pastaj mundohemi të kuptojmë urtësinë e tyre. Nisur nga ky aspekt, mund t'i radhisim në këtë mënyrë disa urtësi në lidhje me të fshehtat e agjërimit, që të shpien te devotshmëria:

- Agjërimi është edukimi i kërimit të kënaqësisë së Allahut Teala. Kushti i parë që një vepër të pranohet si ameli salih / vepër e mirë, është kryerja e saj për hir të Allahut të Lartësuar. Domethënë, largimi nga shtirja që është shirk i fshehtë.

Shkalla e parë e devotshmërisë është qëndrimi larg çdo lloji të shirkut. Mbrojtja nga shirku i hapur është më e lehtë, por të mos biesh në shirkun e fshehtë, nuk është aq e lehtë. Ja pra, agjërimi, në një këndvështrim, është një mënyrë arritjeje suksesi në atë që është e vështirë, sepse të shtiresh me agjërime, është më e vështirë se sa me ibadetet e tjera. Nisur nga ky aspekt, agjërimit mund ta shikojmë si disiplinë për ta edukuar njeriun, në mënyrë që veprat e tij të jenë të sinqerta.

- Agjërimi është edukim i vullnetit dhe durimit. Baza e fitimeve materiale dhe fizike mbështetet shpeshherë në një vullnet dhe durim serioz. Ata që nuk janë të vendosur, nuk mund të korrin fitore. Ruajtja e ekuilibrit kur ndodhin fatkeqësi dhe tragjedi, produktiviteti i veprave të mira, kapërcimi i vështirësive dhe arritja e synimeve të planifikuara, gjithmonë realizohen me durim.

Veçanërisht, durimi ka një rol shumë të rëndësishëm në ndihmën hyjnore që u vjen robërve. Në ajetin 153 të sures Bekare, thuhet:

“O besimtarë! Kërkoni ndihmë për veten nëpërmjet durimit dhe namazit! Në të vërtetë, Allahu është me të duruarit.” Edhe devotshmëria është një cilësi fetarizmi, që mund të arrihet vetëm me durim, sepse për t'u thënë ndalo dëshirave të vetes përgjatë gjithë jetës, domosdoshmërisht duhet një durim i madh. Ja pra, agjërimi është si një mësim praktik, që i mëson durimin njeriut. Ndërsa Ramazani fisnik konsiderohet si një kamp shpirtëror, në të cilin mësohet durimi.

- Agjërimi është një praktikë direkte, që tregon se si mund të luftohet me nefs. Dëshirat e nefsit janë të panumërta dhe të pangopshme. Ai që nuk di t'u thotë stop atyre, në fund bie rob i tyre. Nëse dëshirat nuk disiplinohen, mund të arrijnë deri aty sa të bëhen zot i zotëruesit të tyre. Në këtë mënyrë, jeta kalon duke kënaqur nefsën dhe duke u shërbyer dëshirave të tij.

Ja pra, agjërimi e bën njeriun t'i frenojë dëshirat, duke e kufizuar për një kohë të caktuar edhe prej nevojave natyrale. Fakti që i Dërguari i Allahut, (a.s.), i ka këshilluar të agjërojnë ata që nuk mund të martohen, është i shkëlqyer për të treguar ndikimin e agjërimit në edukimin e dëshirave vetjake.

- Agjërimi është një ibadet, që të kujton rëndësinë e disiplinës së ushqimit në lartësimin shpirtëror, duke tërhequr vëmendjen drejt ndërveprimit mes trupit dhe shpirtit. Kurani Fisnik shprehet se **“mohuesit hanë sikur hanë kafshët.”** (Muhammed, 12)

Ushqimi është një nevojë, por nëse jeta konsiderohet se është vetëm ngrënie dhe pirje, tregon se kemi dalë jashtë njerzillëkut. Nisur nga ky këndvështrim, agjërimi është një ibadet, që ia kujton njeriut se nuk është një gjallesë e zakonshme dhe i hap atij horizontet e lartësimit shpirtëror. Ngrënia e tepërt e bën njeriun më pak të ndjeshëm në aspektin shpirtëror.

Pothuajse të gjithë dijetarët shpirtëror të fesë islame, kanë theksuar ngrënien e pakët për përparimin shpirtëror. Pothuajse të gjithë të devotshmit e kishin bërë simbol të tyre ushqimin e pakët. Të mëdhenjtë e Islamit gjithmonë na e kanë kujtuar se të ngrëniet e pakët e mban zemrën të gjallë, ndërsa të ngrëniet e shumtë i bën pre të neglizhencës të gjitha bukuritë shpirtërore.

- Agjërimi është një ushqim i fortë shpirtëror, i cili ia forcon njeriut anën e tij engjëlllore. Madje, disa dijetarë, si Ibn Arabiu, janë shprehur se agjërimi nxjerr në pah të fshehtën² e emrit es-Samed të Allahut Teala. Në këtë mënyrë, kanë thënë se agjërimi ka një rol të rëndësishëm në edukimin e njeriut me moralin që kërkon Allahu Teala.

- Agjërimi është si edukimi i dhikrit të vazhdueshëm, d.m.th. të mos e harrosh asnjëherë Allahun dhe ta kujtosh vazhdimisht me zemër. Sepse kalimi i më shumë se gjysmës së ditës me ibadet, është mënyra më e bukur për të zbatuar urdhrin e Allahut:

“Përkujtojeni Allahun shumë!” (Ahzab, 41)

Ja pra, agjërimi është njëri prej ibadeteve të rëndësishme, që i japin zemrës qetësinë shpirtërore.

- Agjërimi është një ibadet influencues për arritjen e virtyteve të larta, si mëshira, modestia dhe mirësjellja. Agjërimi e bën njeriun të kuptojë aftësitë e tij të kufizuara, ia pastron personalitetin nga egoizmi e mendjemadhësia dhe i jep atij modestinë dhe vetëdijen e të qenit asgjë kundrejt Allahut të Madhëruar. I hap damarët e mëshirës, duke i dhënë mundësinë e kuptimit në shkallën hakka'l-jekin ndaj të uriturve dhe të vetmuarve. Nëse agjërimi mbahet me ndjenja edhe më të thella, i zbukuron fjalët e sjelljet me fisnikëri dhe hijeshi.

Përfundimisht, agjërimi është një shkollë që e zbukuron adhurimin me petkun e devotshmërisë, e pastron personalitetin dhe bëhet shkak që ibadeti të pranohet dhe nderohet në audiencën e Allahut Teala.

2. es-Samed: Është emër hyjnor që shpreh se Allahu Teala nuk ka nevojë për asgjë dhe se çdo gjë ka nevojë për Të.



Agjëroni

që të jeni të shëndetshëm

Prof. dr. Mahmud Barsha

Agjërimi, të cilin Allahu e ka obliguar për myslimanët, përmban në vetvete çështje adhurimi, dobi fetare, shpirtërore dhe etike. Gjithashtu, ai përmban edhe dobi mjekësore, për të cilat është shprehur i Dërguari i Allahut në thënien e tij: “Agjëroni që të jeni të shëndetshëm.” (Taberaniu)

Po, me vetëm dy fjalë lakonike është shprehur Profeti (a.s.), që para 15 shekujsh, kur shkenca dhe shkencëtarët e kësaj kohe akoma nuk kanë mundur t’i paraqesin njeriut një këshillë shkencore ose një rregull mjekësor më të arrirë e më madhështor se sa ky hadith profetik.

Këtu do të përmend disa nga dobietë mjekësore, të cilat shkenca bashkëkohore akoma vazhdon të zbulojë të reja pas të rejash.

Studimet dhe kërkimet shkencore kanë vërtetuar se agjërimi (heqja dorë) nga ushqimi është çështje e natyrshme, të cilën Allahu e ka obliguar për të gjitha qeniet e gjalla, në periudha të caktuara kohore. E gjithë këtë vetëm për mbrojtjen, forcimin dhe vazhdimësinë e llojit të tyre. Agjërimi është çështje e njohur edhe për kafshët edhe insektet, disa prej tyre agjërojnë

(largohen) nga ushqimi për një periudhë kohore që arrin në disa muaj, e disa të tjerë në disa ditë. Por edhe bimët agjërojnë një periudhë të gjatë, për të çelur gjethe të blerta e të bukura, e kështu fillon jeta pranverore shumë e lulëzuar, që përhap gjallëri dhe bukuri pas një gjumi të qetë dimëror në të cilin ishin duke agjëruar.

Vërtet ne gjejmë në librat e historisë se agjërimi nuk ka qenë i njohur vetëm te popujt që kanë pasur shpallje hyjnore, por edhe tek fiset që nuk u ka arritur thirrja e të dërguarve e të cilët në mesin e tyre nuk kanë pasur profetë. Rrethanat e tyre natyrore i kanë detyruar të agjërojnë për periudha të gjata apo të shkurtra kohore për motive të panjohura dhe për stimul vetjak.

Agjërimi nga ushqimi ruan detyrën kryesore, të rëndësishme dhe të gjallë tek njeriu, e cila është funksioni i përshtatjes dhe i harmonizimit me ushqimin e paktë.

Studimi dhe kërkimi i këtij funksioni ka qenë nga më të rëndësishmit për të cilin u kujdes shkenca bashkëkohore. Dr. Alexis Carrel, fitues i çmimit Nobel në mjekësi, në librin e tij “Njeriu, ky i panjohur” thotë:

“Në të vërtetë tejkalimi në sasi dhe, me tepri i vakteve



ushqimore dëmton një funksion, i cili kryen një rol të madh në ekzistencën e llojit njerëzor e ky është funksioni i përshtatjes me ushqimin e pakët. Të gjitha fetë hyjnore të mëparshme s'pushuan së ftuari njerëzit në obligimin e agjërimit, sepse ndalimi nga ushqimi në fillim shkakton ndjenjën e urisë dhe e pason me atë të dobësisë. Por, në anën tjetër ndodhin dukuri të fshehta më shumë të rëndësishme se ato të parat, si: sheqeri i depozituar në mëlçi lëviz dhe rinovohet, gjithashtu aktivizohet me të dhjami i depozituar në lëkurë, rinovohen proteinat e muskujve, gjëndrave dhe qelizat e mëlçisë, dhe të gjitha gjymtyrët e trupit sakrifkajnë lëndët e tyre të posaçme për ruajtjen e plotë të mesatares së brendshme, si dhe ruajtjen e shëndoshë të zemrës. Gjithashtu agjërimi pastron plotësisht indet tona.

Pra agjërimi kryen për trupin një operacion pastrimi dhe rinovimi, sikur atij i është rikthyer ndërtimi i tij nga fillimi, pa helme, i shëruar nga sëmundjet dhe përsëri i fuqishëm për të përballuar vështirësitë.

Dobi mjekësore e agjërimit është edhe forcimi i aparatit imunitar. Dr. Abdul Xhevvad Es-Savi në librin e tij "Agjërimi, një mrekulli shkencore", i miratuar nga Asambleja e mrekullive shkencore të Kuranit dhe Sunetit, në Arabinë Saudite, shkruan për të dhëna të shumta statistikore shkencore, të cilat po i përmbledhim më poshtë:

1. Agjërimi fetar forcon aparatit imunitar, mbron trupin nga sëmundjet e shumta, ku përmirësohet dhjetëfish treguesi i punës së qelizave limfatike, ashtu siç shtohet me një përqindje të madhe, numri i qelizave përgjegjëse për imunitetin specifik (qelizat limfatike T). Gjithashtu shtohen disa nga llojet e trupave kundërvepruese në trup dhe aktivizon reagimin imunitar për shtimin e proteinave dhjamore me dendësi të ulët.

2. Agjërimi mbron nga dhjamosja dhe rreziket e shumta të saj si: sëmundjet e enëve të gjakut, p.sh. insuficiencën

kardiake, atakun në zemër, arteriosklerozën; dhimbjet e kyçeve, dëmtimin e vertebrave, etj.

3. Agjërimi mbron trupin nga formimi i gurëve në veshka, meqenëse rrit mesataren e sodiumit në gjak dhe ndalon formimin kristalor të kripërave të kalciumit.

4. Agjërimi mbron nga rreziket e helmeve të grumbulluara në qelizat e tij dhe mes indeve, si pasojë e ngrënies së ushqimeve, sidomos atyre të ndenjura e të paketuara, si dhe nga marrja e ilaçeve dhe thithja e ajrit të ndotur nga këto helme.

5. Agjërimi ul dhe qetëson nxitjen e instinktit seksual, sidomos tek të rinjtë, dhe për këtë mbron trupin nga shqetësimet psikike e trupore, dhe nga devijimet morale. Për këtë i Dërguari i Allahut ka thënë: "O ju të rinj! Kush prej jush ka mundësi të martohet, le të martohet dhe kush nuk ka mundësi, le të agjërojë, sepse ai është mburojë." (Transmeton Muslimi).

6. Agjërimi mbron nga sëmundjet mendore dhe psikike. Është vërtetuar ndikimi i tij mbi të sëmurët skizofrenë, ku për këtë dr. Nikolaiv nga Instituti Psikik në Moskë, tregon se sëmundjet mendore munden të mbahen nën kontroll nën veprimin e agjërimit dhe dietës. Pas një studimi që është bërë me 1000 të sëmurë mendorë, që iu përmbajtën agjërimit, u evidentua se përmirësimi ka qenë i dukshëm te 65% e tyre. Natyrisht ai këtu flet për agjërimin mjekësor, të cilin shkencëtarët bashkëkohorë e kanë përshtatur nga agjërimi islam, por pa e njohur agjërimin fetar. Me këtë rast është vërtetuar dobia e agjërimit mjekësor si në mjekimin e shumë sëmundjeve të veçanta ashtu edhe në mbrojtjen nga disa sëmundje të ndryshme.

7. Agjërimi aktivizon gjëndrat me sekrecion të brendshëm në trup, si: gjëndra e pankreasit, e herdheve, të vezoreve etj.

8. Agjërimi aktivizon gjallërimin e nxjerrjes së palcës nga kocka përgjegjëse për formimin e rruazave të kuqe të gjakut në trup.

9. Agjërimi gjallëron aktivitetin e zorrëve dhe i forcon ato, u shton fuqinë për nxjerrjen jashtë të lëngjeve tretëse, gjë që e bën agjërimin, ilaçin më të mirë në shqetësimet kronike të zorrëve të shoqëruara me keqtretjen e lëndëve ushqyese të ndryshme.

Salavatet dhe Selamet qofshin mbi ty o i Dërguari i Allahut, që vetëm me dy fjalë "Suumu tesahhuu" (Agjëroni që të jeni të shëndetshëm) përfshive të gjithë shkencën bashkëkohore të agjërimit dhe umetit tënd i sigurove shëndet të plotë.

Përktheu dhe përshtati:
Ma. Zamira Bushati (Puka)

MREKULLITË E Kuranit

DALLGË NËN OQEAN

Është një ajet madhështor në Kuran, që sa herë e përmend, më kujtohet madhështia e Krijuesit xh.sh.: **“Ose (veprat e tyre) janë si errësirat në det të thellë, të cilin e mbulojnë valë mbi të cilat ka valë dhe mbi ato retë e dendura, pra, errësira njëra mbi tjetrën, sa që nuk mund ta shohë ai as dorën e vet. Ai të cilit Allahu nuk i jep dritë, nuk ka për të pasur dritë.”** (Nur, 40) Në këtë ajet Zoti xh.sh. i krahason punët e mosbesimtarëve me një njeri që jeton në thellësitë e oqeanit dhe i cili për nga sipër mbulohet prej valëve të thella. Pastaj vjen një shtresë e dytë dallgësh në sipërfaqe të ujit, që e mbulojnë atë dhe sipër këtyre dallgëve ka re të dendura, që eklipsojnë dritën e diellit. Ky njeri pra, jeton në errësira të mbivendosura sipër njëra-tjetrës. Në këtë ajet ka një fakt shkencor i cili u klasifikua si teori e mirëfilltë shkencore vetëm në fund të vitit 2007. Kjo ndodhi pasi disa shkencëtarë zbuluan se në thellësitë e oqeanëve ka valë (rryma) të brendshme uji, të cilat ndryshojnë nga dallgët sipërfaqësore të detit. Domethënë ka valë për thellësitë dhe valë për sipërfaqet detare. Këtë gjë e shpreh më së miri ajeti kuranor, ku Zoti xh.sh. thotë: **“...e mbulojnë valë sipër të cilave ka valë...”**. Këto valë i kanë surprizuar shkencëtarët, të cilët me modesti pohojnë se as që e mendonin se mund të ekzistonin të tilla.

TYMI NE QIELL

Kjo është një re e madhe tymi kozmik. Sipas hulumtuesve, fillimi i universit ka qenë i mbushur me këto re para miliarda vjetësh. Grimcat përbërëse të këtyre reve i ngjasojnë tymit normal në tokë, prandaj ata e quajnë "smoke". E habitshme është po ashtu, se Kurani e ka përmendur këtë realitet shkencor para katërmbëdhjetë shekujsh kur thotë: **"Mandej e mësyu qiellin** (krijimin e qiellit) **e ai ishte tym** (mjegullinë që ishte si materie e parë) **dhe atij e tokës u tha: 'Qasjuni urdhrit Tim me dëshirë ose me dhunë!' Ato të dyja thanë: 'Po i qasemi me dëshirë!'"** (Fusilet, 11)

*"Elif Lám Râ. Ky është një Libër,
vargjet e të cilit janë radhitur mrekullisht
dhe janë parashtruar me hollësi
nga ana e Një të Urti të Gjithëdijshtëm."*

(Hud, 11)

Një Ajet

Nën hijen e Kuranit, njeriu mëson të përsiatet mbi natyrën, të thellohet në ndjenja dhe mendime, të jetojë me fisnikëri. Jeta konsiderohet si rasti më i vlefshëm, prej të cilit duhet përfituar. Sepse rruga e lumturisë dhe bukurisë kalon nëpër këtë jetë. Njeriu zhvillon një perspektivë të re dhe një botëkuptim të bazuar në tevhid. Kjo perspektivë e re sjell një ndryshim rrënjësor në mënyrën e vlerësimit të marrëdhënieve midis njeriut dhe mjedisit përreth. Në hijen e Kuranit koncepte të tilla si fitimi-humbja marrin një kuptim tjetër, kështu që kriteret që përcaktojnë fitimin apo humbjen ndryshojnë. Fitimi në këtë botë nuk shikohet gjithmonë si fitim dhe humbja në këtë botë nuk shikohet gjithmonë si humbje. Nuk janë të pakta rastet, kur shumë vetë në planin tokësor duket sikur janë duke fituar, por që në të vërtetë janë duke humbur dhe anasjelltas. Fitimi i vërtetë nuk i përket kësaj bote, por ahiretit. Për rrjedhojë, jeta në të gjitha aspektet e saj, duke filluar nga jeta individuale, në jetën familjare, nga jeta profesionale në jetën sociale, shndërrohet në një transaksion shpirtëror. Nëpërmjet Kuranit, njeriu fiton edhe në këtë botë edhe në botën tjetër. Kurse qytetërimi i sotëm ndoshta siguron fitim në këtë botë, por në botën

tjetër humbja është e sigurt, sepse nuk ka krijuar një ekuilibër midis materiale dhe shpirtërore. Sipas Kuranit, njeriu nuk është thjesht një qenie materiale, por një qenie ku shpirti dhe materia janë të ndërthurua ngushtë me njëra-tjetrën. Vlerat shpirtërore janë thelbësore, përcaktuese në jetën e njeriut. Kurani i mëson njeriut se shpirtërorja është thelbësore dhe e përhershme, kurse materialja është e përkohshme. Kështu, njeriu bëhet dëshmitar se të mirat e kësaj bote janë të përkohshme dhe të pavlefshme në krahasim me mirësitë e botës tjetër.

Nën hijen e Kuranit, çdo ajet që lejojmë përçon një kuptim të ri në botën tonë shpirtërore.

Kurani i vjen në ndihmë njeriut në momentet kur mendon se jeta e ka humbur kuptimin. Kurani e ngushëllon dhe e lidh përsëri me jetën. Duke u dhënë drejtim mendimeve, sjell gëzim dhe lumturi në zemrën e njeriut. Ai kupton nën hijen e Kuranit se çdo gjë vepron sipas përcaktimit absolut hyjnor. Atë që e ndihmon Allahu, nuk ka kush e poshtëron dhe, kë poshtëron Allahu, nuk ka kush e ndihmon. Në këtë mënyrë, njeriu kupton se krenaria dhe nderi vijnë nga Allahu dhe jo nga pozitat e kësaj bote.

Pejgamberi -salallahu alejhi ve selem-, ka thënë:

"Allahu nëpërmjet Kuranit, disa popuj i lartëson, kurse disa të tjerë i poshtëron."

Umeri (r.a.), e përmend hadithin në një dialog të zhvilluar me mëkëmbësin e Mekës, Nafi ibn Abdulharis, ku ky i fundit, kishte emëruar një skllav të liruar si përfaqësuesin e tij në Mekë.

Nëpërmjet Kuranit lartësohen ata që e besojnë, veprojnë sipas tij dhe gjithë jetën e tyre e rregullojnë sipas direktivave të tij. Dhe për këtë nderim që i bëjnë Kuranit, Allahu i lartëson në këtë botë, duke u dhuruar një jetë të lumtur dhe në botën tjetër, duke i shpërblyer me xhenet. Kurse ata që nuk e respektojnë Kuranin, Allahu i poshtëron në këtë botë dhe në botën tjetër i pret një poshtërim më i ulët. Siç e konfirmon këtë fakt edhe vetë Kurani:

"Nëpërmjet tij, Ai shumëkënd e lë në humbje e shumëkujt ia ndriçon rrugën e drejtë." (Bekare, 26)

Në shumë ajete të Kuranit jepen shembuj se si janë ndikuar njerëzit prej tij. Allahu në një ajet thotë:

"Ne shpallim nga Kurani atë që ësh-të shërim dhe mëshirë për besimtarët e që mohuesve keqbërës u shkakton vetëm humbje."

Si përfundim, Allahu lartëson atë që e lexon Kuranin dhe me sinqeritet vepron sipas tij, ndërsa atë që e lexon Kuranin për hipokrizi dhe nuk e praktikon, Ai e poshtëron.

Përmendja e këtij hadithi nga Umeri (r.a.), në fund të dialogut përmban një mesazh të rëndësishëm për të gjithë. Shembulli sublim i drejtësisë, Umeri (r.a.), ka dashur të përçonte mendimin se përmes lidhjes së sinqertë me Kuranin, një person që, deri para pak kohësh ishte një skllav i rëndomtë dhe i pavlerësuar në syrin e njerëzve, arriti pozita mjaft të larta, deri sa të udhëhiqte një popull të tërë. Dhe këtë pozitë e meritojnë të gjithë ata besimtarë, që janë të lidhur fort pas librit të Allahut.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. Çdo përpjekje për të mësuar Kuranin është virtyt.
2. Kush lexon Kuranin dhe e rregullon jetën sipas porosive të tij, Allahu e lartëson.

Një Hadith



URTËSI NGA TË DASHURIT E ALLAHUT

LUKMANI (A.S.)

Lukmani (a.s.), ka thënë:

“Biri im! Ato që ka premtuar Allahu, po vijnë drejt jush me shpejtësi. Edhe ju po shkoni me shpejtësi drejt botës tjetër. Kjo botë ju ka kthyer shpinën dhe po largohet prej jush, ndërsa bota tjetër po vjen drejt jush duke vrapuar. Padyshim se vendi (i pafundësisë) drejt së cilit po shkoni, është më afër jush se sa vendi (i përkohshëm), prej të cilit po ndaheni.”

Aventura e jetës së njeriut, është një skenë mësimdhënëse më vete: njeriu vjen në këtë botë pa sjellë asgjë dhe shkon nga kjo botë pa marrë asgjë. Zoti ynë, na sprovon me gjërat më tërheqëse të kësaj bote. Një njeri, i cili nuk është edukuar shpirtërisht, kaplohet në mënyrë ambicioze nga dashuria për këtë botë, në mënyrë të vetëdijshme ndaj kësaj të vërtete të qartë. Ai i shkel kufijtë hyjnorë për gjëra që një ditë do t’u thotë lamtumirë. Ai përpiqet vazhdimisht të ndërtojë këtë botë që është vendi i tij i përkohshëm, duke shkatërruar botën tjetër që është vendi i tij i përjetshëm.

Edhe sikur t’i ketë të gjitha një person i vetëm dhe të jetojë qoftë edhe njëmijë vjet, sa vlerë kanë mirësitë e përkohshme? Vendi ku ai do të përfundojë, a s’është një gropë e kësaj toke të zezë? Kjo botë është e pabesë; çdo gjë që të jep, një ditë do ta marrë patjetër. Ndërsa robti, i ngelet vetëm llogaria dhe dënimi. Nisur nga kjo, jeta e kësaj bote e cila jetohet në mënyrë të pavetëdijshme nga bota tjetër, edhe sikur të kalojë

midis luksit dhe lumturisë, në të vërtetë, çfarë është tjetër përveçse falimentimit të përjetshëm?

Lumturia e vërtetë, është shkuarja në botën e përjetshme me një zemër të pastër duke fituar kënaqësinë, dashurinë dhe miqësinë e Allahut Teala në këtë botë të përkohshme. Njeriu me të vërtetë i mençur, është ai që nuk e harron kurrë vdekjen dhe përgatitet që sot për vendin ku dëshiron të shkojë në botën tjetër. Allahu Teala, urdhëron:

“O besimtarë! Frikësohuni Allahut dhe secili le të shikojë se çka ka përgatitur për nesër. Frikësohuni Allahut! Me të vërtetë All-llahu e di se çfarë punoni.” (Hashr, 18)

Nga ana tjetër, Allahu Teala, urdhëron: **“Pasha muzgun e agimin!”**², duke u betuar në atë moment madhështor kur të gjitha krijesat zgjohen në një ditë të re. Pra, Zoti ynë, dëshiron që ne të bëjmë kujdes ndaj urtësive të këtij momenti dhe të thellohemi në meditimin rreth tij. Kështu që, edhe ne, në kohën para agimit, duhet të hyjmë në atmosferën e një meditimi të tillë:

Allahu Teala, më hapi një fletë të re prej kalendarit të jetës sime. Mirëpo, shumë të tjerëve nuk ia dha këtë mundësi. Dje, shumë njerëz që ishin ende në jetë, sot nuk janë më. Kjo ditë e re, më largoi edhe një ditë më tepër nga kjo botë dhe më afroi edhe një ditë më tepër drejt botës tjetër. Çdo frymëmarrje, më afron

1. Shih. Bejhaki, ez-Zuhdu'l-Kebir, fq. 201, nr. 501.

2. Shih. Kuran, Fexhr, 89/1.



drejt frymës së fundit. Atëherë, si duhet ta përdor këtë ditë, me çfarë duhet ta mbush faqen time të sotme? Sepse, ditari im në të cilin melekët Kiramen Katibin (shkruesit/regjistruesit) shkruajnë (veprat e mia), do të dërgohet në ditën e kiametit si dosje në gjykatën hyjnore...

Nisur nga kjo, nuk duhet ta harroj kurrë, se jeta e vërtetë, është ajo e botës tjetër dhe se në këtë botë, jam dërguar për të fituar botën tjetër. Ditën time të sotme, duhet ta jetoj sikur të ishte dita ime e fundit dhe çdo frymëmarrje duhet ta konsiderojë si të fundit për mua.

"U shkatërruan ata që thanë; E bëj nesër!" thotë Pejgamberi (a.s.). Nesër nuk dihet nëse do jem gjallë apo jo! *"Fale namazin si dikush që po ndahet (nga kjo botë)!.."*, thotë përsëri Pejgamberi ynë (a.s.).³ Atëherë, namazin duhet ta fal me frikë-respekt ndaj Allahut, duhet të shlyej borxhet e mia materiale dhe shpirtërore, duhet të hallal-lohem me ata që kanë haqe dhe të drejta mbi mua, nuk duhet të cenoj askënd dhe nuk duhet të cenohem nga askush dhe përreth meje duhet të përhap gjithmonë mirësi e mëshirë. Shkurtimisht, duhet të zotëroj një zemër të ndjeshme dhe delikate, si ai që po ndahet nga kjo botë...

Lukmani (a.s.), ka thënë:

"Biri im! Bëj tregti me Allahun që të fitosh vazhdi-

*misht pa pasur asnjë kapital!"*⁴

Momentet më të fitimprurëse të kësaj bote, janë ato që kalohen duke qenë të nënshtruar ndaj Allahut. Ndërsa tregtia më fitimprurëse në këtë botë, është ajo ku jepet e përkohshmja dhe fitohet e përjetshmja. Për këtë arsye, fati më i madh i besimtarit, është kur ai i dorëzohet plotësisht urdhrave të Allahut Teala duke u bërë një rob i devotshëm.

Ai që bëhet rob i devotshëm i Allahut, shpëton nga robëria ndaj krijesave të Tij dhe fiton lirinë e vërtetë. Në të kundërt, njeriu nuk mund të shpëtojë nga të qenit skllav i tiranëve, peng i pasurisë dhe rob i dëshirave të egos. Dhe shpagesa e vetme për shpëtimin nga këto lloj robërish, është lidhja me Allahun Teala dhe dorëzimi ndaj urdhrave të Tij. Për besimtarin, në jetën e kësaj bote, nuk ka tregti më fitimprurëse se kjo, sepse ai që ia shet veten Allahut, pra që heq dorë nga dëshirat dhe epshet e egos dhe i dorëzohet plotësisht urdhrave të Allahut, ka dobi nga kjo botë. Në të kundërtën, ai që lidhet fort me këtë botë, privohet nga kënaqësia e Allahut. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

"Kush dëshiron shpërblimin e jetës tjetër, Ne do t'ia shtojmë atë. Kurse atij që dëshiron fitimin e kësaj bote, Ne do t'i japim një pjesë prej saj, por në botën tjetër nuk do të ketë pjesë (për të)." (Shura, 20)

Për të shkujdesurit që rraskapiten në këtë botë

3. Ibn-i Maxhe, Zuhd, 15.

4. Ahmed, ez-Zuhd, Bejrut 1999, fq. 43, nr. 269; Bejhaki, ez-Zuhdu'l-Kebir, fq. 281, nr. 721.

duke u përpjekur për interesat e kësaj bote në vend të kënaqësisë së Allahut, Kurani Fisnik, shprehet: **“që kanë punuar, por janë rraskapitur kot.”** (Gashije, 88/3.) Për të mos rënë në këtë përfundim të hidhur, duhet të bëjmë pjesë në kategorinë e atyre për të cilët Kurani Fisnik, shprehet:

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre në këmbim të xhenetit...” (Teube, 111)

Sipas një transmetimi, ky ajet fisnik është zbritur në lidhje me besën e dhënë në Akabe nga besimtarët e Medinës, të cilët e ftuan në vendin e tyre Pejgamberin (a.s.), i cili po luftonte për teuhidin (njësimin në Allahut) në Mekë mes vuajtjesh të mëdha. Gjatë kësaj besëlidhjeje, Abdullah bin Reuaha (r.a.), u ngrit në këmbë dhe tha:

“O Rasulallah! Mund të na vësh çdo kusht që të duash, për Zotin dhe për veten tënde.” Pas këtyre fjalëve, Pejgamberi (a.s.), tha:

“-Kushti në lidhje me Zotin tim, është që ta adhuroni Atë dhe të mos i shoqëroni Atij asgjë. Ndërsa kushti në lidhje me veten time, është që të më mbronin ashtu siç mbronin jetët dhe pasuritë tuaja.”

Grupi i sahabëve fisnikë, që kishin ardhur nga Medina, pyetën:

“-Nëse veprojmë kështu, çfarë do të kemi si shpërblim?” Pejgamberi ynë (a.s.), përgjigjet:

“-Do të keni xhenetin!” Me të dëgjuar këtë, të pranishmit thanë:

“-Çfarë tregtie fitimprurëse! As nuk do të kthehemi nga kjo (besa e dhënë) dhe as do ta dëshirojmë kthimin!” (Ibn Kethir, Tefsir, II, 406.)

Allahu Teala, tregtinë më të bukur dhe më fitimprurëse, e përkufizon kështu:

“Padyshim, se ata që lexojnë Librin e Allahut, falin namazin dhe japin fshehtazi apo haptazi nga ajo që u kemi dhënë Ne, mund të shpresojnë në një fitim që nuk do të humbasë. Allahu do t’ua plotësojë atyre shpërblimin dhe t’ua shtojë mirësitë e Tij...”

(Fatir, 29-30)

Në këto ajete, mësojmë se hapi i parë i tregtisë që do të jetë shkak i shpëtimit të përjetshëm, është të lexosh Kuran dhe t’ua mësosh atë të tjerëve, të bësh një jetë të bazuar në kriteret e Kuranit dhe të fitosh një shpirt të butë e të thellë në saj të urtësive të Tij.

Ndërsa hapi i dytë, është falja e namazit... Pra, të takohesh me Allahun në namaz. Allahu Teala, na tregon se Ai ndodhet gjithmonë me ne dhe dëshiron që edhe ne të jemi gjithmonë me Të. Kështu që, namazi i cili është edhe miraxhi i shpirtit tonë, është mundësia më e madhe e përjetimit të takimit hyjnor në kushtet e kësaj bote. Për këtë arsye, Allahu Teala, urdhëron: **“...bëj sexhde dhe afroju Zotit tënd!”** (Alak, 19)

Mirza Mazhar (Allahu e mëshiroftë), ka thënë:

“Çdo punë e ka mënyrën e vet të kryerjes. Namazi ka mbledhur në vetvete të gjitha cilësitë. Ai përmban leximin e Kuranit, salavatet për Pejgamberin (a.s.) dhe dritën e istigfarit dhe dhikrit. Nëse namazi kryhet duke pasur kujdes ndaj të gjitha cilësive të tij, në të do të shfaqen gjendjet shpirtërore më të bukura dhe më frymëzuese që i ngajnë atyre të Epokës së Lumturisë.”⁵

Ndërsa hapi i tretë i tregtisë që do të na sigurojë shpëtimin e përjetshëm, është dhurimi fshehtas dhe haptas. Besimtari duhet të zgjedhë dhurimin e fshehtë. Mirëpo, edhe kur të jetë i detyruar të dhurojë në mënyrë të hapur, -për shkak të rrezikut hipokrizisë- duhet të tregojë kujdes më të madh në ruajtjen e sinqeritetit.

Lukmani (a.s.), ka thënë:

“Biri im! Besimtari ka dy zemra; në njërin ushqen shpresën, në tjetrën frikën.”⁶

Në çështjet e kësaj bote, frika dhe dashuria nuk mund të bashkohen në një zemër. Mirëpo, gjendja ndryshon në çështjet shpirtërore. Nëse një besimtar i devotshëm thellohet në meditimin e mirësive të panumërta të

5. Abdullah Dehlevi, *Makamat-i Mazharije*, fq. 73.

6. Ahmed, *ez-Zuhd*, fq. 87, nr: 537.

Allahut, zemra e tij mbushet me dashuri. Duke iu bindur urdhrit të Allahut; **“Lexo, me emrin e Zotit tënd, i Cili krijon (gjithçka)!”**, në sajë të çdo krijese që e sheh me syrin e dashurisë, takohet shpirtërisht me Krijuesin. Dhe për të mos e humbur këtë afërsi e miqësi, tregon një kujdes të veçantë, sepse shqetësimi ndaj cenimit të dashurisë së Allahut, ia drithëron zemrën.

Jeta e pejgamberëve dhe të dashurve të Allahut, është e mbushur me shfaqje të tilla. Madje edhe Ibrahim (a.s.), i cili ishte Halili/Miku i Allahut, për shkak të këtij shqetësimi, iu lut Zotit; **“(O Zot!) Mos më turpëro në Ditën, kur do të ringjallen njerëzit!”**⁷

“Hauf” dhe “Rexha”, pra frika dhe shpresa, është një ekuilibër që duhet të gjendet gjithmonë në zemrën e besimtarit. Në zemrën e besimtarit, duhet të gjendet gjithmonë në formë të ekuilibruar frika nga privimi i kënaqësisë e dashurisë së Allahut dhe nga dënimi i Tij dhe shpresa për fitimin e mëshirës dhe faljes së Tij të pafundme. E rëndësishme, është që besimtari ta ruajë këtë gjendje ekuilibri deri në frymën e tij të fundit, sepse Kurani Kerim dhe Hadithet fisnike, na bëjnë të ditur se do të ketë prej atyre që, duke qenë një pëllëmbë afër xhenetit, do të meritojnë xhehenemin dhe prej atyre që, duke qenë një pëllëmbë afër xhehenemit, do të meritojnë mëshirën e Allahut Teala.

Me një fjalë, në frymën e fundit, nuk dihet se kush do të shpëtojë me besim. Në lidhje me këtë çështje, përveç pejgamberëve dhe atyre që ata kanë përgëzuar me xhenet, askush tjetër nuk ka garanci. Megjithatë, në një ajet fisnik, urdhërohet:

“O besimtarë, nëse e ndihmoni Allahun, edhe Ai do t’ju ndihmojë dhe do t’ju bëjë të qëndroni fort në këmbët tuaja.” (Muhammed, 7) Duke u nisur nga kjo, për të shpëtuar me besim në frymën e fundit, besimtari duhet të përpiqet gjatë gjithë jetës edhe në drejtim të kënaqësisë hyjnore, por edhe të lutet e t’i kërkojë mbrojtje Allahut me shpresën për të arritur mëshirën

e Tij. Siç shprehet edhe Jusufi (a.s.):

“...(Zoti im!) Bëj që të vdes si mysliman dhe më fut në mesin e të mirëve (në botën tjetër)!” (Jusuf, 101)

Lukmani (a.s.), ka thënë:

“Biri im! Kjo botë është një det i thellë. (Dijetarë pa urtësi dhe) Shumë njerëz, janë mbytur dhe kanë humbur në këtë det. Anija jote në këtë det, le të jetë besimi (me gjithë zemër) në Allahun. Pajisjet e anijes, le të jenë devotshmëria dhe adhurimet! Ndërsa velat e saj (që e drejtojnë), le të jetë feja! Dhe me një anije të tillë dil për udhë duke u mbështetur në Allahun. (Si përfundim) Mbase shpëton, por mbase edhe nuk shpëton!”⁸

Pajisjet më të rëndësishme që njeriu, i cili është udhëtar i përjetësisë, duhet të marrë në këtë botë, janë padyshim besimi dhe punët e mira. Me gjithë këtë, një besimtar i devotshëm, sado punë të mira të bëjë, kurrë nuk e konsideron të sigurt se do të shpëtojë dhe do të bëhet prej bano-rëve të xhenetit duke u mbështetur në punët e tij. Edhe pse punët i bën në mënyrën më të bukur, ai nuk shpreson në to, por në mëshirën dhe faljen e Allahut. Kjo gjendje, është një element i rëndësishëm i devotshmërisë që i mbron besimtarët nga sëmundja e mendjelehtësisë, e cila e bën njeriun të mbështetet vetëm në punët e tij. Për këtë arsye, të dashurit e Allahut, megjithëse kanë bërë një jetë jashtëzakonisht të devotshme, përsëri e konsideronin veten në fund të karvanit njerëzor dhe mundoheshin të shtonin edhe më tepër përpjekjet e tyre për të qenë të devotshëm me frikën se të gjithë do të shpëtonin dhe ata jo.

Halid Bagdadi, i cili për shkak të dijes dhe urtësisë që zotëronte, në kohën e tij njihej edhe si “Dielli i diejve”, në sajë të ndjenjave që i kishte falur devotshmëria, e këshillon kështu vëllain e tij:

“...Mos shih askënd me nënçmim dhe as veten mos e konsidero të lartë! Të gjithë punën dhe mundin dedikojë adhurimeve shpirtërore dhe fizike! Megjithatë,

7. Alak, 96/1.

8. Shu'ara, 26/87.

9. Bejhaki, ez-Zuhdu'l-Kebir, Bejrut 1996, fq. 139, nr: 269.

veten konsideroje si "një të mjerë që nuk ke mundur të bësh asnjë punë të mirë"!.. Betohem në Allahun, se që prej ditës kur më ka lindur nëna, nuk besoj të kem bërë qoftë edhe një punë të mirë... Nëse nuk e sheh veten si të falimentuar në të gjitha punët e mira, ky është kufiri i fundit i injorancës. Edhe kur ta shohësh veten të falimentuar, bëj kujdes; mos e humb shpresën prej mëshirës së Allahut! Sepse për robin, begatia e mirësisë së Allahut, është më e mirë se të gjitha punët e njerëzve dhe xhinëve së bashku..."

Nga një pikëpamje tjetër, sado gjynahe të ketë bërë, asnjë rob nuk duhet t'i humbasë shpresat, duke mos e llogaritur fare mëshirën e Allahut dhe duke e konsideruar veten si banor të xhehenemit. Zoti ynë i Madhëruar, urdhëron:

"Thuaj: "O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti." (Zumer, 53)

Për të arritur mëshirën hyjnore me të cilën lajmërohem në këtë ajet fisnik, duhet të marrim parasysh edhe këtë ajet që vjen menjëherë pas tij dhe t'i drejtohem Allahut me teube:

"Kthehuni tek Zoti juaj dhe nënshtrojeni Atij, para se t'ju vijë dënimi, sepse atëherë nuk do të mund t'ju ndihmojë kush!" (Zumer, 54)

Po ashtu, edhe Pejgamberi ynë (a.s.), ka thënë:

"Nëse besimtari do ta dinte forcën dhe mënyrën e dënimit të Allahut, nuk do të shpresonte kurrë për xhenetin. Edhe mohuesi, nëse do ta kuptonte mirë mëshirën e Allahut, nuk do t'i priste kurrë shpresat nga xheneti i Tij." (Muslim, Teube, 23.)

Gjithashtu, edhe sahabët fisnikë, të cilët në lidhje me çështjen e frikës dhe shpresës u edukuan me frymën e Kuranit dhe Sunetit, kishin arritur një gjallëri të lartë shpirtërore dhe një zemërbutësi të jashtëzakonshme. Ibn Ebi Mulejke (Allahu e mëshiroftë), thotë:

"Arrita (të njihesha me) tridhjetë veta prej sahabëve

të Rasulullahut (a.s.). Të gjithë ata kishin frikë se mos ishin hipokritë. Asnjë prej tyre, nuk mund të thoshte se kishin arritur një besim (të fortë) si ai i Xhebrilit dhe Mikailit." (Buhari, Iman, 36.)

Madje edhe një figurë e madhe e islamit, si Omeri (r.a.), nuk e konsideronte veten të shpëtuar nga ky shqetësim. Pejgamberi (a.s.), vetëm Hudhejfetu'l-Jemanit (r.a.), ia kishte treguar personat të cilët bartnin shenja hipokrizie në zemër. Omeri (r.a.), e dinte këtë gjë dhe një ditë gjatë kohës kur ishte Halife, shkoi tek Hudhejfe dhe i rrëfeu për shqetësimin e madh që ia prishte qetësinë e zemrës:

"- O Hudhejfe! Për hir të Allahut, më thuaj; a ka shenja hipokrizie tek unë?"

Hudhejfe (r.a.), i përgjigjet:

"-O Halife! Vetëm ty të jap garanci; në ty nuk ka asnjë shenjë hipokrizie!.."

Pavarësisht të gjitha virtyeteve që zotëronte, Omeri (r.a.), për shkak të ekuilibrit midis frikës dhe shpresës që kishte në zemrën e tij, është shprehur:

*"Nëse nga qielli do të vinte një zë, e do të thoshte: O njerëz! Vetëm një person do të hyjë në xhehenem», unë do të kisha frikë se mos vallë jam unë ai. E nëse do të thoshte: «O njerëz! Vetëm një person do të hyjë në xhenet», atëherë unë do të mbushesha me shpresë, se mos vallë jam unë ai."*¹⁰

Me një fjalë, zemra e besimtarit duhet të jetë gjithmonë në gjendje vigjilente për shkak të frikës dhe e qetë për shkak të shpresës.

Lukmani (a.s.), ka thënë:

*"Biri im! Merr nga kjo botë aq sa të mjafton! Mos u zhyt në të aq sa të dëmtosh botën tjetër! Por edhe këtë botë mos e braktis plotësisht, që të mos ngelesh nevojtar ndaj njerëzve (t'u bëhesh barrë). Agjëro aq sa të thyesh epshin. Por mos agjëro aq shumë sa (të dobësohesh e) të të pengojë nga namazi! Sepse tek Allahu, namazi është më i dashur se agjërimi!"*¹¹

10. Ali Muttakî, XII, 620/35916. Gjithashtu shih. Ibn-i Rexheb Hanbeli, *Tahuif mine'n-Nar*, Dimeshk 1979, fq. 15.

11. Bejhaki, *ez-Zuhdu'l-Kebir*, fq. 84, nr. 91.

Besimtari duhet të jetë gjithmonë i matur, pra, duhet të ruhet nga rënia në ekstreme, qofshin ato lëshime apo teprime. Në punët e tij në lidhje me këtë botë ose me botën tjetër, madje edhe në jetën e tij të adhurimit, nuk duhet ta teprojë asnjëherë. Ai gjithmonë duhet të qëndrojë brenda kufijve që ka caktuar Allahu dhe i Dërguari i Tij duke bërë një jetë të ekuilibruar. Nga kjo, varet edhe vazhdimësia e devotshmërisë në masën e pranueshme.

Një ditë, Rasulallahu (a.s.), tha:

“- Qëndroni në rrugën e mesme. Ta dini, se askush nuk do të shpëtojë në sajë të punëve të tij.” Sahabët e pranishëm, pyetën me habi:

“- As ju nuk mund të shpëtoni, o i Dërguar i Allahut?” Pejgamberi ynë (a.s.), u përgjigj:

“- Po, as unë nuk mund të shpëtoj. Mirëpo, nëse Allahu më fal me mëshirën dhe bujarinë e Tij, ndryshon puna!” (Muslim, Munafikin, 76, 78)¹²

Ashtu siç neglizhenca ndaj adhurimeve do ta vërë njeriun në pozitë të vështirë në botën tjetër, po ashtu edhe veprimi me një entuziazëm të tepruar, pas një farë kohe mund të shkaktojë lodhje, mërzitje dhe gabime. Prandaj, si parim duhet marrë gjithmonë rruga e mesme. Kjo ndodhi është një shembull i bukur i këtij fakti:

Një ditë, Rasulullahu (a.s.), po u tregonte sahabëve të tij në lidhje me Kiametin. Ata u prekën shumë dhe filluan të qanin. Më vonë, dhjetë prej tyre u mbledhën në shtëpinë e Osman bin Maz'unit për të biseduar. Në përfundim të bisedës vendosën, se që prej atij momenti, ta braktisnin këtë botë, të agjëronin ditën, të kalonin gjithë natën deri në mëngjes me adhurime, të mos hanin mish, të afroreshin më rrallë tek gratë e tyre, të mos përdornin erë të mirë dhe të mos shëtitnin e të udhëtonin nëpër tokë. Kur Pejgamberi (a.s.), e mori vesh këtë, në fillim i qortoi ata, pastaj i mbledhi sahabët dhe iu drejtua me këto fjalë:

“Çfarë kanë disa, që ia bëjnë vetes haram marrëdhënien me gratë e tyre, ngrënie e pirjen, erën e mirë, gjumin dhe kënaqësitë e lejuara të kësaj bote? Padyshim se unë nuk ju urdhëroj të bëheni murgjër. Në fenë time nuk braktiset ngrënia e mishit dhe nuk ka largim nga gratë. Po ashtu, nuk mund të braktisësh as këtë botë e të mbyllesh në manastir. Udhëtimi (lëvizja nëpër tokë) i popullit tim është agjërim, ndërsa murgjëria (devotshmëria) e tyre, është xhihadi. Adhuroni Allahun, mos i shoqëroni Atij asgjë, bëni umren dhe haxhin,

falni namazet, jepni zekatin dhe agjëroni Ramazanin. Bëhuni të drejtë, që edhe të tjerët të bëhen të drejtë si ju. Popujt para jush, u shkatërruan për shkak të teprimeve. Ata ia vështirësuan fenë vetes dhe Allahu ua vështirësoi atyre. Ata që ndodhen sot në kisha dhe manastire, janë trashëgimia e tyre.”

Në lidhje me këtë, u zbrit edhe ky ajet fisnik:

“O besimtarë! Mos ia ndaloni vetes gjërat e mira, të cilat Allahu jua ka lejuar dhe mos e kaloni kufirin! Vërtet, Allahu nuk i do ata që e kapërcejnë kufirin.” (Maide, 87)¹³

Lukmani (a.s.), ka thënë:

“Biri im! Ki frikë Allahun dhe mos u shtir para njerëzve sikur e ke frikë Allahun, me qëllim që ata të të japin ndonjë gjë, ndërkohë që zemra jote është e mbushur me gjynahe.”¹⁴

Dyfytyrësia dhe abuzimi me ndjenjat fetare, është një nga cilësitë më të shëmtuara që nuk mund të përputhet kurrë me moralin islam. Të shtiresh si besimtar i devotshëm përpara njerëzve për hir të interesave personale dhe kur ndahesh prej tyre vepron në kundërshtim me besimin, shkakton dënimin e Allahut Teala, i Cili di çdo gjë që ndodhet në zemra. Për këtë arsye, Rasullullahu (a.s.), është shprehur:

“Ajo që kam më shumë frikë për popullin tim, është shirku ndaj Allahut. Me këtë, nuk dua të them, që ata do të adhurojnë Hënën, Diellin apo idhuj (të tjerë). Ajo që me të vërtetë më frikëson, janë punët që bëhen për qëllime të tjera përveç kënaqësisë së Allahut dhe dëshirat/synimet e fshehta (ndjenja e dyfytyrësisë).” (Ibn Maxhe, Zuhd, 21.)

Ajo që e dallon besimtarin e vërtetë, është dashamirësia, sinqeriteti dhe besnikëria. Siç shprehet edhe Mevlana i nderuar:

“Ose duku siç je, ose bëhu siç dukesh!..”

Allahu Teala na e bëftë të mundur, të bëjmë një jetë të devotshme të zbukuruar me sinqeritet, dashamirësi, besnikëri e edukatë dhe të mund të shërbejmë me entuziazmin e besimit në rrugën e kënaqësisë së Tij.

Amin!..

13. Shih. Uahidi, fq. 207-208; Ali Kari, *Mirkat*, I, 182-183.

14. Ahmed, *ez-Zuhd*, Bejrut 1999, fq. 44, nr. 270.

12. Shih. Buhari, Rikak, 18, Merda 19.



INSTITUCIONI

i agjërimit

Enklid Pelari

Shumë njerëz mund të habiten nga emërtimi apo cilësimi që i bëjmë agjërimit kur themi se ai është institucion. Mirëpo, nëse do ta analizonim me imtësi funksionin dhe rolin e tij në shoqëri, pa dyshim që do të dilnim në konkluzionin se ai është më shumë se kaq. Them i agjërimit është institucion, pasi ai kontribuon në rregullimin e marrëdhënieve midis njerëzve, sheshon rezervat që njerëzit kanë akumuluar karshi njëri-tjetrit dhe nxit për një bashkëjetesë të paqte, kur thuhet në tekstet fetare se besimtari duhet t'i largohet çdo lloj forme agresioni.

Ashtu si çdo shtyllë apo aspekt i fesë nxit për solidaritetin dhe për rritjen e cilësisë së jetesës në shoqëri, po ashtu edhe agjërimit e luan këtë funksion. Fjala bie, zeqati nxit për të ndihmuar njerëzit në nevojë. Haxhi është një manifest ku luftohet diskriminimi, po të marrim në konsideratë se si Ihrami (uniforma e pelegrinazhit) është e njëjlojtë për të gjithë pa dallim race apo statusi social. Ndërsa vetë agjërimit është

institucion për arsytet e mëposhtme:

Institucioni i agjërimit nxit për solidaritet social.

Bashkëshortja e Profetit Muhamed (a.s.), Aishja (r.a.), thotë: "Ishte Muhamedi (a.s.) bujar, por akoma më bujar ishte në ramazan". Po ashtu, agjërimit unifikon të varfrit e të pasurit, pasi ka shumë të pasur që nuk e dinë se ç'do të thotë të jesh i varfër apo të rrish pa bukë. Kështu, kur ata e ndejnë dhembjen nën lëkurën e tyre, atëherë tek ta aktivizohen dhe sensibilizohen ndjenjat humane dhe solidare.

Them i solidaritet, pasi siç dihet, njerëzit i bashkojnë hallet dhe problemet. Të gjithë në këtë ditë kanë një problem që i shqetëson, ai është mungesa e ushqimit. Materializmi i tepërt vret shpirtin thuhet në filozofi, ndërsa e anasjellta e kësaj është se agjërimit rilind aspektin human e social në shpirtin e njeriut, duke e bërë atë më altruist dhe e nxit që të jetojë me dhimbjen e tjetrit.

Ramazani ka shërbyer si një lloj opozitarizmi ndaj regjimit komunist. Megjithëse komunizmi me agresivitetin e tij tentoi të penetronte në çdo qelizë të shoqërisë, madje arriti të ndante nga shtrati edhe çiftet nëpërmjet zboveve, apo megjithëse tentoi të prodhonte fëmijët dhe brezat e rinj komunistë, e jo ti edukonte ata –siç thotë Izetbegoviçi, sërish ai kandili që i fshihej errësirës së komunizmit më shumë sesa i fshihej errësirë së natës, shërbeu si një lloj oponence e fortë ndaj komunizmit dhe si një neuron përçues i fesë në brezat e së ardhmes.

Agjërimi është edhe institucion arsimor, pasi vetë Islami ecën me devizën: “Edukimi i përket njeriut, ndërsa dhuna i përket kafshës”, dihet dhe ajeti Kuranor ku Zoti (xh.sh.), thotë në suren Bekare: “nuk ka dhunë në fe”. Në filozofi thuhet se nga dhimbja lind mëshira. Kështu edhe shpirti si qenia më e lirë zbutet nga vuajtjet. Pra agjërimi është një proces i cili kultivon mëshirën tek njerëzit dhe dhembshurinë ndaj tjetrit. Pra një shkollë mëshire.

Agjërimi skalit durimin dhe lufton parazitizmin social. Në filozofi thuhet se sëmundja më e madhe që mund ta kaplojë njeriun është dorëzimi përpara çdo rrethane. Fjala bie, sikur rinia sot të mos u ishte dorëzuar rrethanave moshore të saj, por t'i ishte përveshur mësimi të profesioneve, ndoshta nuk do të ishte në gjendjen që e ka kapluar. Pra, problemi më i madh qëndron kur njeriu u dorëzohet situatave dhe nuk sakrifikon, pasi vetë sakrifica është çmimi i suksesit. Ne shohim se njerëzit e suksesshëm në jetë kanë punuar për orë të tëra, kanë lexuar për ditë të tëra pa pushuar. Studentët kanë investuar vitet më të bukura të jetës së tyre për të arritur të zotërojnë një profesion. Pra, nuk ka sukses pa luftuar më parë me luksin dhe komoditetin spontan.

Trupi nuk është zgjidhja, por vet problemi. Kështu, nëse njeriu do t'i dorëzohej çdo kërkesë të trupit të tij, atëherë ai do të bëhej medoemos qenie kriminale. Instinkti i të ushqyerit thotë dua të ha, por a mund të vjedhim një restorant për të ngrënë, instinkti i rehatimit të gjymtyrëve kërkon një mjet komod për të udhëtuar, por a do të thotë kjo që ne t'i dorëzohemi kësaj kërkesë të instinktit dhe të vjedhim makina, në mënyrë që të udhëtojmë në mënyrë të rehatshme. Pra në momentin që njeriu u dorëzohet totalisht kërkesave të fizikut të tij, ai ka humbur çdo betejë në jetë. Në të kundërt, janë ata që sakrifikojnë. Kush sakrifikon në agjërim, nuk e ka më problem sakrificën për gjëra të vogla. Kështu pra, agjërimi e kalit shumë mirë këtë pjesë dhe lufton përtacinë dhe parazitizmin social.

Institucioni i agjëritit lufton korrupsionin dhe krimin. Të satët janë ata njerëz që kanë lënë drogat në ramazan, krimin, tregtinë e paligjshme e informale, veset e dëmshme për shoqërinë, si vjedhja, manipulimi etj. Në ramazan njeriu del nga pushteti i trupit të tij dhe e sundon atë. Kështu ramazani është një ofertë që njeriu t'u largohet veseve dhe kjo në vetvete përmirëson cilësinë e jetës normale dhe ul kriminalitetin.

Agjërimi si institucion shëndetësor. Nuk kishte sesi të trajtonin agjërimin dhe të mos flisnim për efektet e tij çudibërëse në anataominë e trupit të njeriut. Nobelisti Karl në librin e tij: “Njeriu, kjo qenie e panjohur” thotë se: “Shumë vakte ushqimore dhe larmia e tyre nxjerrin jashtë funksioni punën e stomakut i cili është krijuar për t'u adaptuar me ushqimin e paktë. Për këtë arsye, njerëzit gjatë historisë kanë agjëruar. Fetë gjithmonë i kanë ftuar njerëzit që të privohen nga të ushqyerit për një kohë të caktuar. Kjo, pasi agjërimi pastron dhe rinovon të gjitha gjymtyrët bashkë me komponentët e tyre të posaçëm, në mënyrë që të rinovohen balancat e brendshme dhe të ruhet shëndeti i qelizave.”

Ndërsa Mak Von, një shkenctar në fushën e mjekësisë thotë: “Çdo njeri duhet të agjërojë, edhe nëse nuk është i sëmurë. Kjo, pasi helmet ushqimore të cilat akumulohen në trup e bëjnë njeriun si të sëmurë duke sjellë rëndimin e trupit dhe inaktivitet. Kështu, kur njeriu agjëron, atij i shpërbëhen helmet derisa trupi pastrohet. Sipas z.Von, qelizat e njeriut duan përafërsisht 20 ditë që të rigjenerohen totalisht, prandaj agjëruarit pas një farë kohe ndjejnë një lloj force dhe potenciali të brendshëm që nuk e kishin provuar më parë.

Madje vetë Mak Von i kuronte pacientët e tij që vuanin nga sëmundje të stomakut me agjërim dhe u thoshte: “Agjërimi është shkopi magjik për sëmundjet e stomakut, gjakut, reumatizmit etj”.

Siç e shohim, për nga aspekti social influenza dhe kontributi i agjëritit është multidimensional, pra tamam një institucion mrekullibërës për shoqërinë. Ndërsa e përkthyer në planin personal besimtarët myslimanë besojnë se agjërimi është reanimacioni hyjnor për të mjekuar shpirtin e rënë në gjendje kome nga plagët që ka marrë gjatë vitit prej pasioneve dhe mëkateve të trupit. Inercia rutinore e jetës ka nevojë për një frenim dhe ndalesë pauze, në mënyrë që njeriu të meditojë edhe shpirti të marrë frymë apo të ushqehet me adhurime. Ja pse agjërimi është kaq i dashur për njeriun, dhe shoqërinë!

Të mbushur plot me adhurime dhe të gëzuar e paçim këtë muaj!



Të ekspozuar ndaj rrezikut

Nuredin Nazarko

Jeta e njeriut mbi sipërfaqen e tokës, nuk është një zgjedhje personale e tij. Ne nuk mund të përcaktojmë kohën dhe hapësirën në të cilën do të vijmë në jetë, kohën dhe hapësirën në të cilën do të japim të qarën e parë dhe frymën e fundit. Kjo pafuqi është shenjuese e kufizueshmërisë së njeriut dhe dëshmuar e faktit të pazhbëshëm se njeriu nuk mund të jetë kurrësi fryt i “rastësisë” dhe zot i vetvetes, pavarësisht sesi e perceptojnë veten shumë syresh. Njeriu endet mes kufijve të të qëndruarit mbi botë, i shoqëruar nga kjo dobësi, e cila është aty për t’i kumtuar në çdo moment se është një krijesë, e cila nuk mund ta ketë ditur se kur do vinte në jetë dhe as nuk mund ta dijë se kur dhe ku do të ndërrojë jetë. Krahas mosnjohjes së këtyre dy momenteve kyç për njeriun, ka dhe një mori gjërash të cilat janë të parrokshme nga arsyeja njerëzore, pjesë e së fshehtës, pjesë e së pazbulueshmes. Askush nuk mund të ndërhyjë tek e pazbulueshmja. Askush nuk mund të zbërthejë kuptimin e së fshehtës, sado mendjehollë që të jetë. Ndokush edhe mund të çalltisë me pyetje të tipit “kërkim llogarie”, se përse nuk i është dhënë mundësia për të ditur më tepër mbi të pazbulueshmen,

se përse të mos e njohë atë çfarë mund t’i ndodhë në të ardhmen e panjohur, meqënëse edhe ajo është pjesë e fshehtësisë. I torturuar vazhdimisht me të tilla pyetje pa përgjigje, e gjen veten të zbuluar përballë dobësisë si njeri. Por edhe përtej faktit të qartë, të pafuqisë për të rrokur thelbin e të pazbulueshmes, kokëfortët tregohen shpërfillës dhe hidhen si trumcakë zevzekë degë më degë, duke refuzuar atë që është e qartë si drita e diellit.

Sipërfaqja e tokës mban gjithkënd, por vetëm përkohësisht. Në mes kufijve të përkohësisë njeriut i duhet të sakrifikojë për të siguruar ushqimin e nevojshëm, fizik apo metafizik. Natyrisht që në këto përpjekje dhe sakrificë, jo të gjithë arrijnë në të njëjtin nivel mirëqenieje. Dikush pasurohet materialisht e dikush varfërohet. Dikush pasurohet metafizikisht e dikush varfërohet. Jeta nuk ecën asnjëherë në vijë konstante dhe për këtë duhet të jemi të parapërgatitur, në mënyrë që luhatjet apo zig – zaget e jetës të mos na tronditin shpirtërisht dhe fizikisht. Në rrugëtimin e gjithsecilit hasen pengesa, vështirësi, të cilat duhen përballuar dhe kapërcyer. Ka prej atyre që mposhten nga këto

pengesa dhe vështirësi, ashtu siç ka dhe prej atyre që i kapërcejnë ato me sukses. Të përballurit me sfidat e jetës dhe vështirësitë e surprizat e saj, është një ligj që askush nuk mund ta shmangë, sepse nuk është pjesë e dëshirës së njeriut, sepse në qoftë se njeriu do ta njihte të fshehtën me siguri që do të shmangte të keqen dhe do të përvetësonte vetëm të mirat dhe begatitë. Por, realiteti jetësor flet ndryshe, dhe nuk mund të flasë sipas përfytyrimeve të njërit apo tjetrit. Sikur bota të rregullohej sipas dëshirave të njërit apo tjetrit, as që do të ishte, jo më të ishte kjo që është, ngaqë ajo që është mrekulli nuk mundet absolutisht të marrë jetë prej asaj qenieje që është e dobët dhe nuk njeh se ç'mban në brendësi të vetvetes.

Koha që i është dhënë njeriut për të reflektuar mbi mrekullinë e jetës dhe jo vetëm, është më se e mjaftueshme. Njeriut nuk mund t'i ofrohet një shans i dytë për të jetuar mbi sipërfaqen e tokës, prandaj shfrytëzimi i përkohësisë është mundësia e vetme që njeriu të mendojë mbi atë që është e dukshme dhe e padukshme, mbi atë që është e zbulueshme dhe e fshehtë. Njeriu është i lirë të zgjedhë, të vendosë dhe të marrë mbi veten e tij përgjegjësinë për rrugën që zgjedh në përkohësi. Disa zgjedhin të jenë me përkohësinë e disa zgjedhin të kundërtën. Të zgjedhësh rrugën e metafizikes nuk është gjithaq meritë e njeriut që ka bërë zgjedhjen. Është një dhuratë, e cila nuk iu bëhet shumë njerëzve. Arsytet pse janë në botën e fshehtë. Ata të cilët zgjedhin të hapërojnë në rrugën e metafizikës, duhet të kenë të qartë se zgjedhja e kryer ka një rëndësi të veçantë, jo thjesht se kanë bërë një zgjedhje ndryshe, nga pjesa materialistike. Zgjedhja e këtij drejtimi, për t'i dhënë kuptim jetës, është tepër e rëndësishme, për atë çfarë e pret njeriun në botën e fshehtë, qoftë kjo e ardhmja e panjohur apo dhe paspërkohësia.

Fakti që dikush kryen një zgjedhje metafizike për të drejtuar jetën e tij në përkohësi nuk mjafton, për të pasur një perceptim të plotë, mbi dy elementët në të cilët duhet të bazohet zgjedhja e njeriut, sinqeriteti dhe drejtësia. Çështja nuk është që ne të merremi me brendësinë e njeriut që kryen zgjedhjen, sepse kjo është çështje personale dhe është vetë ai që teston veten për këta dy elementë. Por krahas testimit që i bën njeriu vetes ka dhe testim tjetër, i cili i bëhet njeriut nga Ai, për të cilin kryhet zgjedhja. Mos vallë mendoi njeriu që do të hynte në sferën e metafizikës dhe nuk do të provohej, nëse hyrja ka qenë e sinqertë dhe e drejtë? Të provuarit mbi këto dy virtyte, është ligj dhe rregull që zbatohet mbi cilindo që vendos të hapërojë në sferat e metafizikës. Askush që është me vetëdije të plotë dhe në moshën për të mbajtur përgjegjësi për vendimet që merr, nuk del dot pa u zhytur në thellësitë

e detit të provës. Del nga këto thellësi, vetëm ai që është i sinqertë dhe i drejtë.

Duke qënë se çdokush është i ndryshëm nga tjetri në të gjitha aspektet, edhe kuptimësia mbi natyrën e provës dhe të ecurit gjërat mirë në këtë jetë, është e ndryshme madje edhe vetë brenda atyre që kanë zgjedhur rrugën e metafizikës. Njeriu që jetën e vet e ndërton sipas rregullit, *këtu dhe tani*, konsideron ecje mirë të jetës vetëm në rastin kur arrin të jetë i pasur dhe të zotërojë të mira materiale. Në qoftë se ndodh e kundërta, atëherë mendon që nuk i ka punët mirë dhe jeta nuk po ecën siç duhet. Mosecja mirë e jetës sipas përfytyrimit të këtij njeriu, sjell dhe pasoja të cilat mund të jenë që nga ato më të lehtat (*shqetësim, mërzë, dëshpërim*) e deri tek ato më të rëndat (*depression dhe çrregullime të personalitetit*). Ai as që ndalet të reflektojë se pse jeta e tij rrjedh me këto luhajtje dhe zig – zage, sepse nuk e ka nocionin e provës që duhet të kalojë sinqeriteti dhe drejtësia. Natyrisht që edhe njeriu i, *këtu dhe tani*, provohet me atë që i jepet apo nuk i jepet, por ajo që na intereson është perceptimi që ka njeriu i, *këtu dhe atje*, mbi ecurinë e jetës.

Ashtu si dhe pjesa që i përket, *këtu dhe tani*, edhe pjesa që i përket *këtu dhe atje*, jeton mbi sipërfaqen e tokës dhe madje në bashkëveprim me pjesën, *këtu dhe tani*. Ardhja tek *këtu dhe atje*, nga *këtu dhe tani*, mbart rrezikun e mbartjes së cilësive të kohës kur njeriu ka jetuar në, *këtu dhe tani*. Ky rrezik mbetet evident në rast se ardhja tek, *këtu dhe atje*, nuk realizohet mbi bazën e sinqeritetit dhe drejtësisë. Pa këta dy komponentë, njeriu edhe pse ka hyrë në sferën e metafizikës, percepton dhe gjykon në të njëjtën mënyrë, sikur të ishte ende në sferën e *këtu dhe tani*, mbi rrjedhën e jetës dhe natyrën e provës. Jo rrallë ndesh njerëz, që edhe pse i përkasin tashmë sferës së metafizikës, mendojnë se jeta nuk po u ecën siç duhet, se sikur janë lënë në harresë, se sikur nuk janë parë me dashamirësi nga Ai, që iu mundësoi mbërritjen tek sferat e metafizikës. Mbërritja në të tilla mendime, është situata më e rrezikshme në të cilën mund të gjendet njeriu që beson së i përket metafizikës. Në rast se këto mendime nuk luftohen rrezikojnë të kthehen në pjesë të qenësishme të njeriut dhe situata është serioze. Rreziku i daljes nga sfera e metafizikës është prezent në çdo moment. Detyra e atyre që i përkasin kësaj sferë është të luftojnë me mish e me shpirt, duke iu përmbajtur sinqeritetit dhe drejtësisë, për të qëndruar në kufijtë e sferës metafizike. Kush nuk i kushton vëmendjen e duhur këtij rreziku, duhet t'i bëjë mirë llogaritë me veten dhe të mos fajësojë askënd veç vetvetes për ekspozimin real ndaj vdekjes së jetës.



Për ta arritur URTËSINË, shko atje ku gjendet URTËSLA!

Mehmet Lutfl Arslan

Do të shkosh, duhet të shkosh. E rëndësishme nuk është të shkosh, por e rëndësishme është të arrish urtësinë. Sot do të shkosh, nesër do të kthehesh. Pa u realizuar këto vajtje-ardhje, nuk arrihet urtësia.

Kur i riu po trokiste atë ditë në derën e të urtit, ishte aq shumë i dëshpëruar saqë mund të qante po ta preknin. Vallë, a nuk duhej të ishte i lumtur? Ja, më së fundi hyri në universitetin që u përpoq me vite të tëra për ta fituar. Madje, do të studionte në degën që dëshironte, por duhej të shkonte në një qytet tjetër.

Ja, ky ishte burimi i dëshpërimit të tij: Do të ndahej nga i urti.

Kur i dha selam të urtit, atë që e brente nga brenda ia dërgoi me një shikim të dëshpëruar:

“Kjo është një vizitë lamtumire...”

I urti e nderoi atë me një pritje jo të zakonshme. E pyeti se cilën degë kishte fituar dhe se ku do të rrinte. Gjithashtu i foli për ato që kishte përjetuar në vendin që i riu do të shkonte. I urti i fliste plot entuziazëm dhe bënte shaka.

Ndërkohë që i riu e dëgjonte me një vëmendje të shqetësuar, nga ana tjetër e dinte se ishte e pamundur që i urti të mos e kuptonte gjendjen e tij.

“Vallë, përse nuk flet për ndarjen?”

Për një çast heshtën të dy. I riu pa disa ndriçime të paqarta në sytë e të urtit, që i reflektonte përshtypshmëria e tij. Atë çast harroi çdo gjë. Pothuajse u zhyt aty dhe filloi të kërcente në lumin vëlla me dëshpërimin e tij. Papritur, sytë e të urtit që ishin ngulitur në zbrazëti, e hodhën

shikimin te sytë e të riut. I riu u ndje sikur kishte marrë ndonjë goditje në kokë. Koka sikur i shkoi mbrapa. Në një moment, vetëm në një moment... Tashmë i riu e kishte marrë atë që i duhej për lamtumirën... Në një moment, vetëm në një moment...

I urti ishte shumë i aftë për ta fshehur atë që nuk po binte fjala. Por sot po fliste i emocionuar sikur e kishte harruar nga vinte dhe shkonte fjala.

-Do të shkosh, duhet të shkosh. E rëndësishme nuk është të shkosh, por e rëndësishme është të arrish urtësinë. Sot do të shkosh, nesër do të kthehesh. Pa u realizuar këto vajtje-ardhje, nuk arrihet urtësia. Për ta arritur urtësinë, duhet të shkosh atje ku gjendet urtësia.

I riu sikur ngriu në vend për shkak të ndjesisë së papërkufizueshme që mori nga shikimi i mëparshëm. Ai nuk pandehte se veshët i dëgjuan ndonjë gjë, por zemra i kishte dëgjuar shumë. I riu e dinte se ato që po dëgjonte tani, ishin fjalë që duheshin dëgjuar jo me veshë, por me zemër.

-Do të shkosh, por do të shkosh për t'u kthyer. Ata që do të kthehen, nuk konsiderohen të shkuar. Jemi këtu, jemi bashkë. Ku mund të ketë kurbet për ata që jetojnë në botën shpirtërore? Për njerëzit e tjerë çdo vend është kurbet, ndërsa për ata që jetojnë në botën e zemrës, kurbeti nuk ekziston.

Kur po fliste, sytë i ishin bërë bu-rime dhembshurie dhe po i rridhnin. Zëri iu dridh si një babai që po i thotë fjalët e fundit fëmijës së tij, ose i riu pandehi ashtu:

-Përderisa të shkosh jo pas dëshirave vetjake, por pas zemrës tënde, nuk ke shkuar askund, por jemi bashkë.

I riu ndjeu sikur u qetësua qoftë edhe pak. Në ato momente iu kujtuan fjalët që i pati thënë i Dërguari i Allahut (a.s.), Muadhrit (r.a.), në momentin e ndarjes kur e dërgoi në Jemen. Kur i pati lexuar për herë të parë ato kujtime të mrekullueshme që e mbytën Muadhin në lot, pati shkruar këto në fletoren e tij:

"Devotshmëria është stacioni i fundit i atyre që duhen. Në këtë botë, vetëm ky stacion mund t'i qetësojë ata. Çdo dashuri që nuk të shpie te ai stacion është gënjeshtër dhe çdo i dashur që nuk ta premton atë

stacion është gënjeshtar. Në çdo dashuri që fundi i saj na shpie te devotshmëria, fryn një fllad i pafundësisë që na i freskon zemrat. Ndërsa dashuritë që fundin e kanë në errësi, na e shtrëngojnë zemrën edhe në kohët më të vështira..."

I urti po heshtte. Kur ai heshtte, mendonte se orkestra e pafundësisë ka filluar të luajë melodinë e dëshpërimit. Përsëri ishte duke u përhumur, por zëri i të urtit e prishi heshtjen:

-Këshillat e sheriatit të dalin dhe të mjaftojnë për sa i përket çështjes se çfarë duhet të ndjekësh dhe prej çfarë duhet të largohesh. Andaj mos prit ndonjë shtesë prej meje. Unë vetëm po të them këtë: Dashuria dhe urrejtja jote asnjëherë të mos e kalojnë cakun!

Të riut menjëherë i erdhi në mendje ky hadith: "Kur ta duash mikun, duaje me masë, sepse ndonjë ditë mund të bëhet armiku yt. Edhe armikun urreje me masë, sepse ndonjë ditë mund të bëhet miku yt."

-Në momentin kur e ndjen dashurinë, aty bien dy fara. Njëra është fara e pemës që shkon drejt Zotit (xh.xh.), ndërsa tjetra është fara e pemës që ka hedhur rrënjë në gropat e xhehenemit. Që të dyja rriten bashkë. Të duash për hir të Allahut Teala, do të thotë ta shtypësh farën e keqe para se të mbijë. Edhe nefs i ka pjesë nga dashuria. Ajo pjesë mund ta devijojë

njeriun. Kështu është edhe urrejtja... Por ata që sprovojnë me urrejtje janë të paktë, sepse ajo është pak punë trimash...

I riu nuk e kuptoi aq qartë fjalinë e fundit, por shikimi i të urtit që bëri përmbi syzet e tij, po i tregonte se në të vërtetë, kjo nuk ishte ajo që duhej të dëgjonte:

-Këdo që të duash, fillon e formohet një lidhje ndërmjet atij dhe teje. Kështu ndodh edhe në lidhje me atë që zotëron... Atë që e posedon, e përvetëson. Atë që e përvetëson, e do. Kështu që lidhesh me atë që do. Asnjëherë mos thuaj për asnjë gjë se është e imja! Sepse, asgjë nuk është e jotja. Asgjë nuk e ke dashur ti, por ta kanë dhënë dhe ta kanë bërë të dashur. Nëse i shikon gjërat në këtë mënyrë, nuk do të të ngelet mall i pavlerë. Kështu që nuk do të pendohesh për atë që do dhe që posedon.

Në çdo dashuri që fundi i saj na shpie te devotshmëria, fryn një fllad i pafundësisë që na i freskon zemrat. Ndërsa dashuritë që fundin e kanë në errësi, na e shtrëngojnë zemrën edhe në kohët më të vështira...

I riu i dëgjoi ato që kishte për të dëgjuar.

“Këto fjalë ishin të mjaftueshme për atë që është njeri. Tashmë edhe nëse shkoj larg, nuk do të thotë se jam larguar nga këtu. Jam këtu, jam në vendin e sulltanëve shpirtërorë, vendi i cili është devotshmëria. Përderisa të jem i gjallë, nuk ka largim shpirtëror për mua, por vetëm largim fizik...”

Ndërkohë që e ndjeu veten të qetësuar, filloi të priste shenjë e largimit që do t'i jepte i urti.

I urti i ngriti duart dhe po qeshte:

“Të thashë mos kërko ndonjë gjë shtesë, por ja që sot po dëshiroj të flas. Allah, Allah...”

I riu u bë kureshtar. Domethënë se i urti do të thoshte edhe ndonjë gjë tjetër. Andaj u gëzua.

-Dëshiron të bësh çdo gjë. Përpara ke një horizont të pafund. Pengesat as që i shikon madje... Synimet e vogla të duken pak. Vogëlsia e njerëzve të habit. Sepse ti kërkon këtë botë. Do ta marrësh dhe do të luash me të si me një kokërr tespijesh. Po njerëzit? Sa shumë që merren me punët e zakonta, apo jo? Kështu mendon. Veçanërisht ata që janë mbi moshën mesatare. Ata pothuajse kanë humbur në jetën e përditshme. Kur t'u flasësh atyre për horizontet, zbrazëtira që bie në sytë e tyre nuk është gjë tjetër përveçse një humnerë e pafundme, apo jo?

I riu për një moment mendoi se i urti ia mori mendjen në dorë si një tabletë dhe ia lexoi.

“Si mund ta lexojë kaq qartë?

U përpoq të mos i binte në sy, por...

-Për shembull, të ngrihesh çdo ditë 15 minuta më herët se dita që kaloi... Apo nuk është ky qëllimi?

I riu heshti.

-Kuptoj vetë nëse është apo jo qëllim. Provoje një herë dhe shikoje nëse do të arrish t'ia dalësh mbanë. Nuk është e lehtë. Atyre që nuk janë të aftë edhe në fushat e tyre, nuk u vlerësohet asgjë. Të tillët, shkatërrohen në gjendjen e tyre të shkretë dhe zhduken, një. Të përshtatesh me ritmin dhe harmoninë e sistemit, do të thotë ta dish vendin tënd të zinxhirit i krijesave dhe të jetosh sipas saj, dy. Të

mendosh se kjo është gjë e zakonshme, është gjëja më e mirë e zakonshmërisë, tre.

I riu e mori fletoren e shënimeve dhe filloi t'i shkruante ato që dëgjoi. Në ato momente, i urti u ngrit në këmbë dhe filloi të shkonte drejt derës. Domethënë se kishte ardhur koha e largimit.

Ndërkohë që i urti fliste, edhe i riu përpiquej ta arrinte duke i shkruar nga pas:

-Lexoji shpesh muavidhetejnit. Domethënë, suren Felek dhe Nas... Gjithmonë kërko mbrojtje te Zoti i Felekut, në mënyrë që të të nxjerrë nga errësira e nefsit dhe e të tjerëve dhe të të shpjerë te drita e së vërtetës. Mos u beso shumë ndjenjave, sepse nuk mund ta dish nga vijnë dhe për ku janë drejtuar, por ti i di rregullat e tyre. Për këtë arsye, gjithmonë duhet të kesh rregulla, masa dhe kritere...

Ndërkohë që i urti po kalonte nga librat, papritur ndaloi. U kthye dhe e pa të riun duke i buzëqeshur:

-Ndalo të të them diçka para se të dalësh!..

Dorën e çoi te rafti i librave, në të cilin nuk gjendeshin libra të zakonshëm dhe tërhoqi një libër prej tyre. I pa kopertinën, u kthye dhe i buzëqeshi të riut. Tha “Bismillah”, e hapi dhe lexoi aty ku i ranë sytë:

-Ai që shëtit, gjen ushtarë. Ai që rri, bëhet ushtar...

Pastaj qeshi derisa iu dukën edhe dhëmballët dhe i tha:

-Sot e paske fatin mjaft të hapur. Të qoftë rruga e mbarë!

Edhe i riu po buzëqeshte kur po dilte, por jo për shumë kohë, sepse pas dy-tre minutave ndjeu se zemra iu shtrengua. Ja, tashmë i kishte ardhur brengosja që gjithmonë e pati shpresuar. Ai nuk arriti të mendonte as për shkakun e saj. Në fytyrë iu shfaq një fisnikëri ngjyrë bezhë. Buzëqeshja i ngriu dhe gjërat që kishte në brendësi filluan të shtypeshin. Nga mesi i zemrës iu shkëput një shprehje dhe i doli prej gjuhe:

“Kur të vijë brengosja, urtësia kthehet drejt qiellit. Atëherë do të thotë se ushqimi ynë qiellor ka filluar të zbresë.”

*Gjithmonë
kërko mbrojtje
te Zoti i Felekut,
në mënyrë që të të
nxjerrë nga errësira e
nefsit dhe e të tjerëve
dhe të të shpjerë te drita
e së vërtetës.*



Sami Byjkkajnak

PËRPPJEKJA PËR KALIMIN E ULJE-NGJITJEVE TË JETËS

Kurani Fisnik shprehet se njeriu ka dy rrugë në jetën e kësaj bote:

“Allahu i thërret njerëzit për në Shtëpinë e shpëtimit (xhenet) dhe udhëzon kë të dojë në rrugën e drejtë.” (Junus, 25)

“Vallë, a nuk ju kam urdhëruar, o bijtë e Ademit, që të mos e adhuronit djallin, se ai është vërtet armik i hapët i juaji...” (Jasin, 60)

Nisur nga ajetet e mësipërme, njeriu ose është në rrugën që e shpie në mirësi, ose është në rrugën që e shpie në të keqe. Domethënë, në këtë jetë ka dy rrugë që njeriu mund të ndjekë... Rruga që tregon Allahu Teala dhe rruga në të cilën shejtani përpjeket t'i tërheqë njerëzit. Jeta e kësaj bote rrjedh në rrjedhën e këtyre dy rrugëve. Kur njeriu të ecë në rrugën e mirësisë,

sigurisht se do të përballet me ulje-ngjitje. Ja pra, këto ulje-ngjitje janë sprovimi i njeriut. Allahu Teala e shpall në suren Beled se cilat janë ulje-ngjitje dhe thekson se njeriu mund t'i përballojë këto vetëm me ndihmën e Tij.

Allahu i Lartësuar thotë se “ulje-ngjitjet janë lirimi i robit”. Kuptimi i ajetit kur zbriti ishte lirimi i njerëzve që janë robëruar. Edhe Ebu Bekri, (r.a.), i ka liruar shtatë robër vetëm e vetëm për ta kaluar këtë provë. Të gjithë e dimë lirin e Bilal bin Rebahut (r.a.).

Bilalin e patën shtrirë në rërë të nxehtë. Politeisti Umejje bin Halefi i urdhëroi robërit e tjerë:

“Vendosini sipër Bilalit një gur të madh, të nxirë nga temperatura e diellit dhe të nxehtë!”

Menjëherë vjen njeriu i shembullor, Ebu Bekri (r.a.).

Bilali rënkonte:

"Allahu është një!" Ebu Bekri, (r.a.), i bën një propozim material këtij politeisti materialist:

"Të jap robin tim që është prej fesë tënde dhe i pasur, ndërsa ti më jep Bilalin!"

Politeisti i madh u habit. Një propozim i madh, sepse mendja e atij punonte vetëm për para. Menjëherë pranoi. Një rob me para kundrejt një robi që s'ka asgjë. Në këtë mënyrë, Ebu Bekri, (r.a.), liroi shtatë robër.

Një ditë, babai i tij, Ebu Kuhafe i tha:

"Bir! Ti po liron robërit. Kjo është diçka e vyer, por të paktën liro robër me trup të madh, të dobishëm dhe që mund të na ndihmojnë, në mënyrë që edhe punët tona të shkojnë mirë..." Ebu Bekri, (r.a.), dha këtë përgjigje që tregonte përpjekjen për ta kaluar këtë provë:

"Unë nuk po i liroj robërit për interesin tim. Ata po i liroj vetëm për të fituar pëlqimin e Allahut Teala."

Sot ky ajet ka dy kuptime për ne:

I pari, lirimi i njerëzve që u është robëruar zemra.

Në kohën tonë ka shumë njerëz që janë robëruar. Robërit e televizorit, robërit e kompjuterit, robërit e parasë, robërit e fëmijëve, robërit e femrave, robërit e bixhozit, robërit e alkoolit dhe robërit e argëtimit që e kanë lidhur veten në mënyrë të pakufizueshme me to...

Allahu Teala po na thërret në shekullin e njëzetë e një-të dhe po na thotë:

"O ju që e shikoni veten në rrugë të drejtë! O ju që pranoni se po ecni në rrugë të drejtë! Asgjë nuk arrihet pa kaluar nga këto ulje-ngjitje! Nëse jeni në rrugë të vërtetë, duhet t'i kaloni këto ulje-ngjitje. Njerëzia e robëruar po ju pret. Nëse nuk mund ta ndihmoni ndonjë që ka rënë në dallgët e kësaj jete, atëherë nuk mund ta kaloni këtë ulje-ngjitje."

I dyti, çdo njeri duhet të bëjë vepra të mira, në mënyrë që të shpëtojë nga fundi i keq, sepse shpëtimi i çdo njeriu është në lidhje me veprat që ka bërë. Ky shpëtim arrihet duke luftuar kundër mashtrimeve të shejtanit dhe dëshirave të nefsit që urdhëron të keqen dhe për të cilën thuhet: "Armiku më i madh i yti është nefs i që e ke në brendësi." (Keshfu'l-Hafa, 1, 160.) (Elmallëllë, 9, 229.)

Domethënë, kuptimi i lirim të një robi, siç ka lidhje me botën e brendshme të njeriut, edhe në aspektin social është ndihma ndaj njerëzve që e kanë robëruar

veten e tyre. Zoti i Lartësuar thotë se "sprova është të japësh për të ngrënë edhe në ditët e vështira". Edhe në hadithin fisnik thuhet: *"Shpëtoje veten nga zjarri, qoftë edhe me një gjysmë hurme."* Të dhënët kur ka, është e vështirë për atë që është bërë rob i nefsit. Të dhënët kur s'ka, është po aq i vështirë. Të dhënët për hir të Allahut duhet të bëhet zakon edhe kur ka, edhe kur s'ka. Vetëm me këtë është e mundur që t'i kalojmë ngjitje-zbritjet e kësaj jete, të bëhemi si sahabët dhe ta fikim llambën, në mënyrë që të ngopet mysafiri. Të bëjmë sikur hamë, në mënyrë që të ngopet mysafiri. Kjo shprehje që kalon në Kuranin Fisnik në lidhje me përkufizimin e të devotshmit, tregon se mund të jepet edhe në vështirësi:

"Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe xhenetit, hapësira e të cilit është sa qiejt e toka dhe që është përgatitur për të devotshmit, të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit." (Al Imran, 133-134)

Të japësh edhe në mirëqenie, edhe në vështirësi, është gjëja që i vjen më rëndë vetes. Nisur nga kjo, të dhënët për hir të Zotit sjell më shumë shpërblim dhe sevap, sepse Allahu Teala thotë:

"Mirësia nuk është të kthyerit e fytyrës suaj nga lindja dhe perëndimi, por mirësia është (cilësi) e atij që beson Allahun, Ditën e Fundit, engjëjt, Librin dhe profetët; e atij që me vullnet jep nga pasuria e vet për të afërmit, jetimët, të varfrit, udhëtarët e mbetur rrugës, lypësit dhe për lirim të robëruarve; e atij që fal namazin dhe e jep zekatin; dhe e atyre që i plotësojnë premtimet, kur marrin përsipër diçka; e atyre që durojnë në kohë skamjeje, sëmundjeje dhe lufte. Këta janë besimtarët e vërtetë dhe këta janë ata që e kanë frikë Allahun." (Bakara, 177)

"Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë rob edhe pse vetë janë nevojtare." (Insan, 8) Të japësh në ditë të vështira është altruizëm. Domethënë, të mendosh për gjendjen e të tjerëve duke e lënë mënjane gjendjen tënde. Domethënë, t'u japësh përparësi të tjerëve ndaj vetes tënde. Kjo është një gjendje që nefs i e pranon me shumë vështirësi. Ndërkohë që nefs i thotë "unë", myslimani ndihmon të tjerët duke u shprehur me gjithë fuqinë që ka: "Jo unë, por të tjerët..."

Në ajetet e tjera tregohet se kush duhet të merret nën mbrojtje në ditë të vështira. Së pari flitet për jetimin. Allahu Teala thotë: **"Jetimin e afërm."** (Beled, 15)

Mukatili, i cili ishte prej komentuesve të periudhës

së parë të Kuranit, shprehet se Zoti (xh.sh.), me këtë ajet ka për qëllim jetimin me të cilin dhënësi ka lidhje farefisnore. Për këtë arsye, të ushqyerit e jetimit të afërm është më i vertytshëm. Ai e vërteton këtë duke thënë se marrësi është edhe jetim, edhe i afërm i dhënësit. Thuhet se në përmbajtjen e kësaj fjale, siç hyjnë të afërmit nga farefisi, hyjnë edhe të afërmit nga aspekti i fqinjësisë.

Jetimët janë amaneti i Allahut për njerëzit, ashtu si pasuria dhe fëmijët e tyre. Allahu Teala, siç kërkon që njeriu t'i ndihmojë të tjerët me pasurinë që i ka dhënë, po ashtu kërkon të ndihmohet duke u marrë nën mbrojtje edhe jetimi të cilin e ka lënë amanet. Për këtë arsye, gjyshërit tanë kanë formuar vakëfet e "Daru'l-Ejtam". Në këtë mënyrë, ua përkëdhelën kokën jetimëve të cilët janë amaneti i Allahut, dhanë mund për t'i edukuar ata si njerëz të së ardhmes dhe i futën të gatshëm në jetën sociale, sepse, kur jetimët të mos kenë përkujdesje, zvarriten në ndonjë zbrazëti. Fëmijët që nuk u përkëdhelet koka, fillojnë t'i shohin të tjerët si armiq. Si rezultat, bëhen individë të dëmshëm dhe të rrezikshëm për shoqërinë. Për këtë arsye, Allahu kërkon që të shfaqim një ndjeshmëri të veçantë kundrejt jetimëve dhe thekson se kjo është një sprovë e vështirë.

Ndërsa ajeti: **"Ose të varfrin e mjerë."** (Beled, 16) – që përmendet në pjesën e dytë të atyre që duhet t'u jepet edhe kur jemi në vështirësi, është ai i varfër që është shtrirë përtokë për shkak të varfërisë. Ai nuk ka asgjë për t'u mbuluar dhe asgjë për të shtruar poshtë. Domethënë, njeri shumë i varfër që nuk posedon asgjë.

Transmetohet se Ibn Abbasi (r.a.), kishte rastisur në një të varfër i cili ishte shtrirë përtokë. Nisur nga kjo, kishte thënë: "Ky është prej atyre që Allahu i Madhëruar ka kërkuar t'i ndihmojmë duke thënë: **"Ose të varfrin e mjerë."** (Beled, 16) Allahu i Lartësuar e përmend të varfrin dy herë ngaqë myslimanët nuk i ndihmojnë të varfrit aq sa kërkohet. Ndërkohë myslimani duhet ta dijë se ngritje-zbritjet e kësaj jete kalohen duke i ndihmuar të varfrit. Këto janë gjërat që e çojnë njeriun në xhenet dhe që e bëjnë të lumtur edhe në jetën e kësaj bote. Allahu Teala, për t'i inkurajuar njerëzit në lidhje me këtë, para se të tregojë se cilat janë ngjitje-zbritjet e jetës, njofton se njeriu nuk tenton për t'i kaluar këto ngjitje-zbritje. Në të njëjtën kohë, edhe ky hadith fisnik

që transmetohet nga i Dërguari i Allahut (a.s.), tregon se atyre që përpiqen t'i kalojnë këto ulje-ngjitje, u hiqen disa cilësi të këqija.

Një burrë shkoi te i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve selem dhe iu ankua për ashpërsinë e zemrës së tij. I Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha:

"Ledhato kokën e jetimit dhe jepu për të ngrënë të varfërve." (Ahmed bin Hanbel, Musned, 5, 250.)

Islami interesohet për botën e jashtme të njeriut, aq sa interesohet edhe për botën shpirtërore të tij. Nisur nga ky këndvështrim, Islami përpiket ta zhdukë çdo vështirësi në shoqëri. Islami i rregullon rregullat e shoqërisë, sepse njeriu është një qenie sociale. Njeriu e ka të pamundur të qëndrojë i ndarë nga të tjerët. Ngaqë njeriu është qenie sociale, duhet t'i rregullohen edhe dispozitat e jetës shoqërore. Ja, në këtë pikë ndërhyjnë Islami. Vendosi kufijtë dhe jep urdhra për të

siguruar një jetë të qetë në shoqëri.

Këta urdhra mundësojnë daljen në pah të myslimanëve të sinqertë. Nëse myslimani nuk është i sinqertë, nuk mund të lirojë robër, nuk mund të japë kur është në vështirësi, nuk mund të përkujdeset për asnjë përveç vetes së tij dhe nuk mund t'ia ledhatojë kokën jetimit. Kur të vijë në një gjendje që s'i bën dot këto, atëherë bëhet neglizhent dhe i duket e vështirë jeta e ahiretit, sepse sprovat që përmendëm më lart, kërkojnë përpjekje serioze dhe dhënie nga pasuria për hir të Allahut për të fituar ahiretin me punë të mira

pa pasur ndonjë interes material te ato. Të japësh është e vështirë. Allahu Teala i jep njeriut në mënyrë të pakufishme, por njeriu është koprrac dhe nuk dëshiron që të ndajë me të tjerët edhe gjysmën e bukës. Kur Allahu i Madhëruar flet për ngjitje-zbritjet (sprovat) e jetës, shprehet se nuk është e mjaftueshme që njeriu thjesht të thotë se ka besuar, madje kjo nuk ka asnjë kuptim, prandaj, e rëndësishme është që të kalohen këto sprova. Këto ngjitje-zbritje kalohen duke shpenzuar prej gjërave materialo-shpirtërore. Siç nuk jetohet në këtë botë pa fituar para, edhe ahireti nuk fitohet pa harxhuar para dhe pa bërë vepra të mira vullnetarisht dhe pa e sensibilizuar zemrën për këto punë. Këtë duhet ta bëjmë, sado që nefs i nuk e pranon...

Lum për ata që ia imponojnë bindjen nefsit, i kalojnë ulje-ngjitjet e jetës dhe fitojnë ahiretin!..

"O ju që e shikoni veten në rrugë të drejtë! O ju që pranoni se po ecni në rrugë të drejtë! Asgjë nuk arrihet pa kaluar nga këto ulje-ngjitje! Nëse jeni në rrugë të vërtetë, duhet t'i kaloni këto ulje-ngjitje. Njerëzia e robëruar po ju pret. Nëse nuk mund ta ndihmoni ndonjë që ka rënë në dallgët e kësaj jete, atëherë nuk mund ta kaloni këtë ulje-ngjitje."

Si duhet të jetë RIVALITETI?

Ahmet Zijljan

Të gjithë po garojnë... Popujt garojnë, shtetet garojnë, firmat dhe institucionet garojnë... Edhe biznesmeni përpiqet për të fituar. Në këtë mënyrë, garon me shumë konkurrues të tij. Për këtë arsye, i përdor avantazhet, fuqinë, teknologjinë, përvojën dhe mundësitë e tij. I mban të fshehtat e prodhimit dhe marketingut. Respekti ndaj të fshehtave të profesionit është themelor.

Nëse gara dhe rivaliteti për të fituar bëhen brenda disa rregullave të caktuara, janë gjëra të bukura dhe të dobishme për njerëzimin. Për shembull, njerëzit kanë nevojë për këpucë. Edhe prodhuesit e këpucëve kanë nevojë për lëndën e parë, për disa mjete dhe produkte industriale, në mënyrë që ta bëjnë këtë prodhim. Me mijëra punë në mijëra sektorë... Punësim...

Njerëzit përpiqen për të fituar riskun. Për këtë arsye, mundohen të gjejnë më të mirën, më cilësoren dhe më të lirën kur konkurojnë. Teknika dhe informacioni do të zhvillohen. Edhe dëshirat e njerëzve janë të ndryshme nga njëra-tjetra. Të gjithë kërkojnë atë që pëlqejnë. Në sajë të kësaj do të dalë në pah një kërkim më i bukur dhe më estetik. Do të dalë kultura dhe arti. Nëse rivaliteti bëhet kështu, është i bukur. Nisur nga kjo, ajo bëhet e dobishme për njeriun dhe shoqërinë. Por ka edhe gjëra

që bëhen për të mos lënë rival. Ka prej gjërave që bëhen për ta zhdukur rivalin, për t'ia marrë frymën dhe për t'u monopolizuar duke përdorur forcën materiale. Këto nuk janë gjëra të bukura. Këto i dëmtojnë edhe njerëzit.

Feja jonë nuk i pranon si fitime hallall rivalitetet e padrejta, si formimin e monopolit, mbajtjen stok të mallit për ta shitur më shtrenjtë në kohë krize etj. Njerëzit duhet të kenë iniciativë të lirë dhe ta kërkojnë riskun në treg, duke e lënë atë të funksionojë në gjendjen e tij normale.

Meqë kemi rastin, po ndajmë me ju një kujtim, të cilin e kemi përjetuar edhe me përvojën tonë, në lidhje me rëndësinë e ekuilibrit të humbjes dhe fitimit në botën



e biznesit. Në këtë kujtim bëhet fjalë edhe për çështjen e rivalitetit:

Akoma nuk patëm ardhur në Stamboll. Kolegu im në profesion, Ekrem Sevinçeri, i cili në atë kohë kishte blerë një makineri dhe po e sillte në Gaziantep, më tha:

“Firma në të cilën bleva makinerinë, po shet një furrë që than copën për këpucë. A të intereson?” Unë i thashë:

-Po, më intereson.

Kur erdhëm në Stamboll, u njohëm me personin që shiste furrën. Ai kishte një furrë tharjeje të copave. Atë kohë, prodhimin e copave e bënte një firmë e madhe që quhej Derby dhe ky person. Kjo furrë thante dhe forconte copën së cilës i hidheshin ilaçe kimike. Kjo bëhej me qëllim për të forcuar pjesët e përparme dhe të pasme të këpucëve. Ky ishte një produkt industrial në prodhimtarinë e këpucëve.

Ky personi dëshironte të na e shiste furrën pesëdhjetë e pesë mijë lira. Në fakt ajo ishte një objekt i vjetër që mund të gjendej me dhjetë mijë lira... Por kishte teknologji dhe një prodhim që klientët prisnin gati për ta marrë. Ky personi ishte i gatshëm të na e jepte për pesëdhjetë e pesë mijë lira. Unë isha i qetë, ngaqë e dija se ku prodhohej ky produkt, si shitej dhe se sa shitej. Desha ta marr, por kishte diçka që nuk më linte nga brenda dhe ma prishte mendjen. Ky personi thoshte: “Në ditë mund të bëni 150-200 copë. Harxhimi për çdo copë është nëntë lira.”

Unë po mendoja në vetvete: “Prodhimi kushton nëntë lira dhe mund të shitet me katërmëdhjetë lira. Pesë lira ngelin fitim për çdo copë. Nëse prodhojmë dyqind copë në ditë, fitimi është 1000 lira. Nëse furra punon gjashtëdhjetë ditë, i nxjerr paratë e saj. A e shet njeriu një makineri të tillë që i nxjerr paratë e saj për dy muaj dhe që jep një fitim kaq të madh? Apo ka ndonjë problem në këtë punë? A thua do na e shesë ne këtë dhe vetë do të blejë një furrë tjetër që ka teknologji më të re? Atëherë ne nuk mund të garojmë me atë. E pyeta:

“Përse po e shet këtë makineri? Sepse do të marrësh një më të mirë, apo jo?” M'u përgjigj:

“Jo, nuk kam për të blerë një makineri të re. Tashmë nuk do merrem me punën e copave. Ju jap fjalën për këtë.”

Nga njëra anë, një makinerie dhjetë mijë lirëshe i jep pesëdhjetë e pesë mijë lira për shkak të teknologjisë, por nga ana tjetër, dyshon në këtë, sepse një makineri që punon dhe sjell para, nuk e japin për pesëdhjetë e pesë mijë lira. Normalisht, një makineri dhjetë mijë lirëshe bie

në pesë mijë lira kur është e përdorur. Ndërsa ne do ta marrim rreth gjashtë herë më shumë, pra pesëdhjetë e pesë mijë lira. Sepse do të blejmë edhe teknologjinë e saj. Ia dhashë edhe kaparin, por nga brenda nuk i besoja. Dyshoja dhe thosha në vetvete:

“A e shet një burrë i mençur një pulë të tillë që prodhon florinj? Cila është e fshehta e kësaj pune? Dëshira për ta marrë m'u shtua edhe më shumë, sepse është një punë e mirë. Prandaj nuk mund të heq dorë. Për shkak të dyshimeve, pyeta babain tim:

“Baba, po marrim një makineri. Faktikisht ajo nuk bën as dhjetë mijë lira, por shitësi i saj kërkon pesëdhjetë e pesë mijë lira. Edhe unë mendoj ta marr.” Babai më tha:

“Bir, mjafton që më pyete. Ti e di këtë, unë nuk marr vesh nga ato makineri. Ti po më thua se ajo vlen dhjetë mijë lira, por që shitësi i saj kërkon pesëdhjetë e pesë mijë lira. Mua menjëherë më vjen të të them: “Mos bir! Si mund ta marrësh me një çmim të tillë?” Por nga ajo që me the, kuptoj se ti e ke një arsye që dëshiron ta marrësh. Unë të besoj ty, sepse ti nuk gabon lehtë. Të qoftë e hajrit. Nëse është në të mirën tënde, Zoti ta mundësoftë ta marrësh, por nëse nuk është në të mirën tënde, Zoti mos ta mundësoftë ta marrësh!” Domethënë, e mora edhe lutjen e babait.

Ky person më parë i kishte shitur një makineri plastike edhe një shokut tonë, Memik Shekerit... Ata e njihnin njëri-tjetrin, prandaj edhe e pyeta:

“Dua të blej një makineri nga filan person. Por po dyshoj. Sepse ai nuk duhet ta shesë këtë makineri në këtë formë.” Ai më tha:

“Jo, ti mos shiko atë! Ai kështu shet. Mos u shqetëso për makinerinë. Sepse ajo punon shumë mirë. Edhe kur na e shiti neve, të njëjtën gjë bëri.”

-Ashtu? A mund të më tregosh?”

“Neve na shiti një makineri. Ajo ishte një makineri e vjetër që bënte shapka plastike. Në fillim kur pati dalë bënte nëntëqind palë shapka në ditë. Një palë shapka shiteshin me tre lira. Ndërsa kilogrami i lëndës së parë ishte tre lira. Nga një kilogramë dilnin tri palë shapka. Domethënë, në fund të ditës fitonim të paktën një mijë lira. Pra, ajo prodhonte nëntëqind palë shapka. Nëse fitonim nga një lirë për një palë shapka, bëheshin nëntëqind lira.

Ai kërkonte njëqind mijë lira nga ne për makinerinë. Atë kohë asnjë nuk kishte makineri plastike. Ne as që e dinin se çfarë makinerie ishte. Shkuam në vendin ku

ndodhej makineria, na tregoi një palë shapka të sapoprodhuara. Ato ishin aq të nxehta saqë nuk mbaheshin në dorë. Pak më vonë veproi të njëjtën gjë, na e shtonte dëshirën për ta blerë, por makinerinë nuk na e tregonte para se ta shiste dhe na thoshte:

“Firmoseni marrëveshjen, jepni kaparin dhe pastaj jua tregoj.” Hezitua pak dhe menduam: “Kjo makineri i nxjerr paratë e saj për tre muaj. Ai na e jep ne për njëqind mijë lira. A e ka mendjen në vend ai apo është i çmendur? Po ashtu, edhe makinerinë nuk na e tregon. Mos vallë është ndonjë mashtrues? Së fundi vendosëm. Ne ishim tre shokë. Me të vërtetë na doli siç na pati thënë. Ne punuam natë e ditë. Në ditë prodhuam një mijë e pesëqind palë shapka. Për gjashtëdhjetë-shtatëdhjetë ditë i nxorëm paratë e makinerisë. Nëse do të bënte ndonjë mashtrim, do të na mashtronte ne. Prandaj, besojini.”

Edhe ne, pasi bëmë këto kërkime, e lamë mënjanë dyshimin dhe hezitimin. Kështu që e morëm makinerinë, e çuam te puna jonë dhe e vendosëm në funksion. Pas një kohe, prodhimin e shtuam nga dyqind në katërqind. Ndërkohë, e lamë shtëpinë në Gaziantep dhe erdhëm në Stamboll. Tregtia po ecte shumë mirë. Edhe ne ishim të kënaqur. Siç e patëm planifikuar, paratë e makinerisë i fituam për shtatëdhjetë e shtatë ditë. Asgjë e papritur nuk ndodhi. Edhe shitësi i makinerisë nuk i hyri më kësaj pune siç na pati dhënë edhe fjalën.

Si kanë thënë: “Nëse Zoti e ka bërë kështu, e sjell dora, e sjell era, e sjell rrëkeja... Nëse Zoti nuk e ka bërë kështu, e merr dora, e merr era, e merr rrëkeja...”

Mirë, por cili ishte shkaku që ky person shiste makineri që sillnin kaq fitim?

Kjo gjendje që neve na dukej e habitshme, buronte nga personaliteti i atij personi.

Ky person i cili respektohej nga të gjithë dhe që quhej Nexhati Karaasllan, ishte një njeri që i punonte koka shumë, ishte nga Merzifoni i Samsunit, i sjellshëm dhe i kulturuar. Ai ishte një njeri që i respektonte të gjithë, sakrifikues, jo i shtrenjtë në tregti dhe modest. Por besimin e kishte pak të dobët.

Së pari, nuk ishte i lidhur shumë me punën. Gjithmonë dilte në punë në orën njëmbëdhjetë. Ai administronte një klub në Jeshilkëj. Rreth orës dy ose tre, kthehej në shtëpi. Ngaqë nuk i jepte shumë rëndësi punës, prodhimi kishte ngelur në duart e punëtorëve.

Ai kishte shtëpi, makinë dhe biznes. Nuk bënte ndonjë harxhim të madh. Ishte një njeri që vazhdimisht hante

bukë, kos dhe hallvë, por që e gjithë jeta i kishte kaluar me borxhe. Ata që vinin nga Anadolli dhe dëshironin të hapnin ndonjë punë, i udhëzonte, u tregonte rrugën, ua shpjegonte se si duhej të vepronin, i inkurajonte dhe i këshillonte. Për këtë, jo që nuk merrte asnjë pagesë, por edhe shpenzonte vetë.

Ja pra, ky person që i punonte koka, jetonte me borxhe edhe pse fitonte para. E habitshme, apo jo? Shkaku i borxhit dhe harxhimit të tepërt, nuk ishte ai vetë. Ai kishte bashkëshorten dhe një vajzë. Sipas atyre që thuheshin, ato harxhonin tej mase. Paratë që fitonte ky, i harxhonin ato. Ai nuk interesohej për këtë dhe nuk ankohej. Gjithmonë kishte borxh. Për këtë arsye, kur shikonte ndonjë shumë të madhe parash, nuk rezistonte dot ngaqë dëshironte ta paguante borxhin. Po ashtu, në mendje kishte shumë punë të reja për të hapur. Shpresa për t'i hapur ato punë dhe për të arritur suksesin, nuk i shuhej asnjëherë.

Ai nuk kishte një natyrë që ta ndalonte shpenzimin e tepërt të familjes së tij. Me sa kuptohej, nuk mund të ndërhynte në mënyrë të fuqishme. Një njeri që ka më shumë shpenzime se sa fitime, është e pamundur që të pasurohet. Edhe pse ky person kishte zgjuarsin të madhe dhe aftësi të papara, për shkak të dobësisë në familje, po i shiste të gjitha makineritë, tezgat me të cilat punonte dhe po i jepte edhe punët që askush nuk i bënte aq lehtë.

Kur ne filluam të prodhonim mallin me makinerinë që patëm blerë, punëtorët e Derbyt ishin në grevë. Kur mbaroi greva, filluan të punonin përsëri. Derby ishte një firmë e madhe. Sikur ta vazhdonte aktivitetin e saj, do të zinte vend ndërmjet firmave më të mëdha. Por ajo e vazhdonte punën pa bërë investime të reja. Siç thashë, ishte një firmë shumë e madhe. Ne bënim vetëm njërin nga punët e shumta që ajo bënte. Edhe këtë e bënim sa çereku i saj. Për këtë arsye, në asnjë lloj mënyre nuk mund të hynim në rivalitet me të. Prandaj ne nuk thoshim: “Malli ynë është më i mirë...” Po ashtu, përpiqeshim dhe kërkonim që prodhimi ynë të ishte më i miri. Më së fundi e gjetëm. Si rezultat nxorëm një prodhim me cilësi më të lartë. Por prapëseprapë nuk thamë në treg se “malli ynë është më i mirë se i Derbyt”. Kur shisnim mallrat tona, ata që pandehnin se merrnin vesh mirë nga këpucët, thoshin:

“Ne përdorim Derby. Prandaj nuk përdorim gjëra që na duken të dyshimta!” Ne përsëri nuk bënim reklamë duke thënë: “Jo, malli ynë është më i mirë...” Thjeshtë e prezantonim. Pastaj nuk flisnim për mallin e të tjerëve. Përse? Sepse kishim frikë. Nëse Derby do ta merrte vesh

se ne prodhojmë mall më cilësor, mund të na shtypte. Në këtë mënyrë punuam shtatë vjet. Shitjet tona ditore sa vinin e shtoheshin. Sigurisht se të gjithë po dëgjonin për prodhimin tonë. Edhe nëse nuk bënim aspak reklamë, njerëzit i thoshin njëri-tjetrit. Pasi prodhimi dhe shitjet tona u shtuan, edhe Derby e dëgjoi. E provoi mallin dhe vuri re se prodhimi ynë ishte më cilësor... Për këtë arsye, vendosi të na shtypte.

Si e shtyp firma e fuqishme një firmë të pafuqishme në treg? Duke ulur çmimin. Derby i ngriti çmimet e të gjitha prodhimeve të saj, por uli çmimin e mallit që prodhoni edhe ne. Kaluan dy tre muaj. Përsëri kishte rritje çmimi në prodhimet e tjera të Derbyt, ndërsa te malli që prodhoni edhe ne kishte ulje.

Një vit e gjysmë vazhdoi kështu. Përgjatë kësaj kohe edhe ne nuk e ngritëm çmimin. Shpenzimet e prodhimit u ngritën. Tashmë prodhimin tonë e shisnim me çmimin që e prodhoni. Madje e shitëm me çmim edhe më të ulët se kostoja i prodhimit. Një ditë morëm takim nga drejtori i firmës Derby dhe shkua për ta takuar. Atij i thamë:

“Ky rivalitet nuk është as në të mirën tuaj dhe as në të mirën tonë. I keni ulur çmimet. As ne nuk fitojmë, por as ju nuk fitoni. Le të biem dakord për një çmim dhe të fitojmë të dy palët.” Ata na thanë: “Ne fitojmë ngaqë e bëjmë vetë prodhimin kimik. Nëse nuk fitoni, mos punoni.” Ne u thamë: “Meqë lëndën e parë e prodhoni lirë, na e shisni edhe ne, në mënyrë që edhe ne të hamë bukë.” “Në rregull.” – na thanë. Pastaj na shitën tre-pesë ton lëndë të parë. Ajo ishte shumë e dobët, për këtë arsye ua kthyem pas.

Kushdo që përpiqet për ta shtypur, shkatërruar dhe për t'i marrë bukën e gojës nga dora rivalit të tij, herët apo vonë do të shkatërrohet edhe vetë. Unë kam parë shumë raste të tilla në përvojën time. Domethënë, “Kushdo që i bën padrejtësi rivalit të tij apo ndonjë tjetri, do ta ketë jetën të shkurtër. Ai e sëmur rivalin e tij, por vetë vdes.”

Përfundimisht, pas një viti e gjysmë thamë: “Përse të merremi me këtë punë? Përse të bëjmë inat me ta? Le të bëjmë një punë tjetër. Ka edhe punë të tjera që dimë t'i bëjmë. Prandaj le të merremi me ato punë që dimë.” Atë kohë, edhe pse pak, bënim pjesë të poshtme të këpucëve. Pastaj filluam t'i bënim edhe më cilësore dhe të merreshim me atë punë. Punën e mëparshme e lamë. Vetëm pasi e lamë ne atë punë, Derby i ngriti çmimet e atij malli. Domethënë, e ngriti në çmimin real të tregut dhe vazhdoi të prodhonte.

Me kalimin e kohës, arritëm sukses në punën e prodhimit të pjesës së poshtme të këpucëve. Madje, u bëmë shpikësit e saj. Derby imitoi atë që bëmë ne, por nuk ia arritën qëllimit. Ne vazhdimisht ishim në komunikim

me prodhuesit e këpucëve.

Ngaqë specialiteti ynë ishte puna e këpucëve, korrëm shumë sukses në prodhimin e pjesës së poshtme të këpucëve. Ndërsa Derby nuk kishte një sektor të tillë. Për këtë arsye, nuk arriti të konkurronte dot me ne. Më vonë u tërhoq komplet nga tregu.

Nëse përpiqesh për ta bërë punën tënde në mënyrën më të mirë, edhe pse rivaliteti i pandershëm do të të vijë rreth e rrotull, përsëri do ta arrish qëllimin tënd. Ndërsa rivaliteti i padrejtë dhe përpjekjet për t'i shtypur të tjerët me politikën e çmimeve, nuk duhet t'i shkatërrojnë iniciatorët e

rinj dhe nuk duhet t'i tmerrojnë, përkundrazi, duhet të diskutojnë me ta dhe t'u japin rrugëzgjdhje të ndryshme. Edhe firmat e mëdha nuk duhet të frikësohen nga rivalët e rinj, por duhet të interesohen për të mësuar ndonjë gjë prej tyre. Allahu është Ai që e jep riskun. Rivaliteti është pasuri. Së fundi, qëllimi është respekti ndaj profesionit dhe shërbimi ndaj popullit. Ai njeri që e di se rivaliteti i vërtetë është në rrugën për t'u bërë njeri sa më i mirë dhe rob sa më i devotshëm, arrin të ketë sukses edhe në rivalitetin e kësaj bote. Në këtë mënyrë, nuk lëndon askënd dhe i bën të tjerët ta kenë lakmi personalitetin e tij.

Lum për atë që ia del mbanë kësaj!...





Si mund të dalë **Jusufi** **nga pusi**

A. Jasin Demirxhi

Të gjithë ne jemi Jusufë. Jemi Jusufë që kemi rënë në pusin e trupit. Nëse mund të dalim, do të shpëtojmë. Neve na duhet një litar, na duhet një dorë. Na duhet dikush që do na zgjasë dorën e tij, të na tërheqë dhe të na nxjerrë. Neve na duhet dikush që të na shpëtojë nga pusi. Por ja që ka aq shumë Jusufë që presin nëpër puse...

Kur i riu doli përpara të urtit, po mendonte për shprehjen: "Fatkeqësia është e lidhur me fjalën që del nga goja." – e cila përmendet në historinë e Jusufit, (a.s.). Por të urtin nuk e pyeti për këtë. Ai i bëri një pyetje tjetër me mimikën gazmore që kishte:

-Si mund të dalë Jusufi nga pusi?

I urti menjëherë e pa të riun duke i ulur syzet. Pasi e pa, buzëqeshi dhe e uli kokën:

-Sot qenke i lumtur...

"Falënderimi i takon Allahut." – tha i riu.

I urti e përsëriti të njëjtën pyetje:

-Po, si mund të dalë Jusufi nga pusi?

Sytë ia nguli të riut. Shikimi i tij sikur po e shponte atë.

Befasisht i riu ndjeu sikur koka iu gozhdua pas murit.

I urti vazhdonte të shikonte. Pastaj iu përgjigj pyetjes në mënyrë të rrufeshme:

-Siç ka rënë, do të dalë...

I riu nuk u habit. Sipas tij, kishte bërë një pyetje interesante. Edhe përgjigja që do të merrte nuk do të ishte më pak interesante sigurisht. Me kë po bënte rivalitet? Por edhe vetë ishte i përgatitur:

-Domethënë, nga vendi që ka rënë pa vullnetin e tij, do të nxirret nga të tjerët. Këtë duhet të kuptoj?

I urti bëri edhe këtë manovrim:

-A këtë dëshiroje të kuptoje?

I riu ndaloi për momentin dhe veten e ndjeu sikur i kishte mbaruar municionet. Pastaj belbëzoi lehtësisht:

-Me thënë të drejtën, nuk ishte kjo ajo që po kërkoja.

I urti u ngrit në këmbë dhe i tha:

-Prit, po ta them unë atë që kërkon.

Kur po ngrihej, i pati hapur sytë sikur donte të kuptonte reagimin e të riut. I riu, pak edhe me nxitim, e tha atë që kërkonte të mësonte nga kjo çështje, sepse nuk dëshironte të zbulohet:

-Në të vërtetë, ajo që kërkoj është kjo: Përse Jusufi u sprovua me këtë sprovë?

-Nëse je Jusuf, duhet të jesh gati për sprovë.

-Po nëse nuk jam Jusuf?

-Çdo njeri është nga pak Jusuf.

-Të gjithë ata që kemi rreth e rrotull janë pak vëllezërit tanë. Janë vëllezër që na kanë zili, ashtu? Atëherë ka një Jakup që shqetësohet për ne. Atëherë cili është pusi dhe cili është Egjipti?

I urti pa sikur donte t'ia hidhte menjëherë të riut ndriçimin që iu shtua në sytë e tij, por kjo ishte një çast... Vetëm një çast... Zemra nuk e lejoi që ky ndriçim i tij të notonte në ujëra të panjohur. Për këtë arsye, dalëngadalë i uli sytë.

"A të gjithë janë Jusufë? Nëse të gjithë janë Jusufë, atëherë, kush janë vëllezërit e Jusufit?"

A mund të ishte kjo përgjigjja: "Të gjithë janë nga pak Jusufë."

A me të vërtetë janë të gjithë nga pak Jusufë? Në librin e një miku të Zotit pati lexuar se zemra jonë është Jusufi, shpirti ynë është Jakubi dhe disa cilësi të karakterit tonë janë vëllezërit lakmitarë. Nëse shikohet nga ky këndvështrim, të gjithë mund të bëhen Jusufë, por ai nuk e zgjidhte dot marrëdhënien që e jashtëmja ka me të brendshmen dhe që e brendshmeja ka me të jashtmen. Por nga ai libër pati mësuar edhe këtë: "Përgjigjet e pothuajse të gjitha pyetjeve që kanë lidhje me këto tema dhe shumica e detajeve që i përkasin rrugës shpirtërore, gjenden në suren Jusuf, e cila tregohet si historia më e bukur në Kuranin Fisnik.

I urti e ngriti kokën dhe e pa të riun:

-A të fillojmë nga pusi apo nga Egjipti?

I riu u hodh pa e pritur përgjigjen:

-Pa rënë në pus, nuk mund të bëhesh sundues i Egjiptit, apo jo?

I urti buzëqeshi dhe tha me mirësjellje:

-Si pusi, si Egjipti nuk kanë asnjë ndryshim. Nëse shpëton nga njëri, nuk mund të shpëtosh nga tjetri. Ata janë të njëjtë, por nëse bie te njëri, lartësohesh te tjetri. Kështu duket nga jashtë. Sipas mistikës, vendi në të cilin bie, është vendi në të cilin lartësohesh, ndërsa vendi në të cilin lartësohesh, është vendi në të cilin bie. Pusi fsheh në vete Egjiptin, ndërsa Egjipti fsheh në vete pusin. Kjo nuk është shumë e rëndësishme. E rëndësishme është...

E ngriti kokën dhe e pa të riun. Kështu vepronte kur donte të thoshte diçka të rëndësishme. E ndërpriste fjalën dhe ia ngulte sytë sikur donte t'i thoshte ki kujdes.

Ndërkohë që i urti po e ulte shikimin, filloi të fliste

qartazi:

-Çdo njeri është pak Jusuf. Të gjithë jemi Jusufë. Jemi Jusufë që kemi rënë në pusin e trupit tonë. Nëse arrijmë të dalim, do të shpëtojmë. Ne kemi nevojë për një litar. Kemi nevojë për dikë që të na zgjasë dorën. Të na zgjasë dorën, të na tërheqë dhe të na nxjerrë. Ne kemi nevojë për dikë që të na shpëtojë nga pusi. Por ja që ka aq shumë Jusufë nëpër puse që po presin... Çdo vend është i mbushur me Jusufë. Çdo vend është i mbushur me puse... Në cilindo pus që të shikosh, do të gjesh një Jusuf...

Në fjalët e tij kishte pak dhimbje, pak brengosje dhe pak dobësi... Sikur donte të bënte diçka, por nuk arrinte dot dhe kjo i shkaktonte dhimbje. Ai e pa një çast të riun sikur po ia lexonte ato që i shkonin në mendje. Sikur po i thoshte: "Hajt fol, thuaj diçka!"

I riu nuk foli. Çfarë të thoshte në fakt? Shikimin e uli në tokë i shqetësuar. Sikur po thoshte: "Nuk kam asgjë për të thënë..."

Kjo ishte ajo që priste i urti:

-Tani duhet të më pyesësh këtë!..

I riu e ngriti kokën me kureshtje. I urti foli duke e lëkundur gishtin tregues:

-Cili Jusuf mund të dalë nga pusi? Ose kështu: Cili Jusuf duhet të dalë nga pusi? Nëse ti ke dalë nga pusi, cilin Jusuf do të shpëtoje? Cili Jusuf e meriton të dalë, të nxirret, të kapet për dore dhe të shpëtohet nga pusi? Cili Jusuf e meriton këtë?

I riu u ngrit në këmbë dhe u përgatit për t'u larguar. Në momentin që po dilte, u kthye dhe deshi të jepte selam. I urti përsëri e kishte ngritur gishtin tregues dhe ishte përgatitur për të thënë diçka:

-Të qoftë rruga e mbarë! Ki kujdes! Nëse je në pus, nuk ka ndonjë problem të thuash çfarë të duash, por nëse nuk je në pus, mati fjalët dhe pastaj fol!.. E di këtë, apo jo? Fatkeqësia është e lidhur me fjalën që del nga goja.

I riu e aprovoi duke tundur kokën. Ndërkohë që po shkonte drejt shtëpisë, në kokë akoma i jehonte ajo pyetje: "Cili Jusuf duhet të dalë nga pusi?"

Atë ditë shkroi këtë shënim në ditarin e tij:

"Nëpër puse ka shumë Jusufë. Atëherë, cilin Jusuf duhet të shpëtojmë? Sigurisht se atë që pret për t'u shpëtuar. Atë që britma e tij jehon në të gjitha anët me shpresë që të vijë dikush për ta shpëtuar, ngaqë e kupton se gjendet në pus... Po të tjerët? Ai që nuk e kupton se është në pus, nuk shqetësohet për të shpëtuar. Për atë që nuk dëshiron të shpëtojë, nuk ka pus. Ndërsa për atë që dëshiron të shpëtojë, edhe sundimi i Egjiptit është një pus."

Turpi është i bukur

Turpi është një perde e hollë, por edhe aq e fortë, sa që na ndihmon të mos biem në gropat e mëkatit. Turpi, nëse mësohet sipas rregullave që ka vendosur Allahu Teala dhe gdhendet një herë në karakter, është një cilësi e bukur që nuk e lë njeriun aq lehtë, edhe nëse i kërkohet diçka e tillë. Burimi i turpit është besimi. Njerëzit që kanë turp janë të shëndetshëm shpirtërisht dhe të qetë në ndërgjegje. Te njeriu që ka turp, nuk gjenden gjurmët e ligësive, si dredhia, mashtrimi, falsifikimi, vjedhja, urrejtja dhe shpifja. Nga ana tjetër, kur njeriu e shqyen perden e turpit, nuk ka më frikë nga llogaria e atyre që ka bërë.

Kuptimi leksikor i fjalës turp është: Ndjenjë e fortë turbullimi e hutimi, që na lind kur bëjmë diçka të pahijshme a të pandershme, kur gabojmë, kur nuk ia dalim mbanë një pune, kur na fyen ose kur na vë në lojë dikush etj.; druajtje e madhe përpara dikujt, ndjenjë që na pengon t'i dalim përpara dikujt, t'i flasim etj.; frikë se mos dalim keq ose se mos bëhemi qesharakë para të tjerëve. Ndjenja e turpit, e cila del në pah si rezultat i moralit dhe edukatës, është prej ndjenjave më të qarta të moralit. Kënallëzade Ali Çelebiu, i cili është prej autorëve më kryesorë të botës Osmane të shekullit të gjashtëmbëdhjetë, e përkufizon kështu turpin në kryeveprën e tij me titull "Ahlak-ë Alai".

"Turp do të thotë mbulesë, druajtje, namus etj. Turpi është ndjeshmëri dhe vuajtje e zemrës kur ndodhin ngjarje në kundërshtim me moralin." Njeriu që është i privuar nga morali dhe turpi, mund të hyjë në çdo lloj pune të shëmtuar. Zhvillimi i shoqërisë nga aspekti i urtësisë ka të bëjë shumë me përhapjen dinamike të ndjenjës së turpit. I Dërguari i Allahut (a.s.), i cili e bën të qartë se turpi është prej besimit, ka treguar se turpi është një faktor që i frenon ligësitë dhe se paturpësia i zvarrit njerëzit në rrugë të devijuara duke u shprehur: "Nëse nuk ke turp, bëj çfarë të duash!"

Edhe Aliu thotë: "Populli nuk mund të shohë ndonjë gabim nga ai që vesh petkun e turpit." I Dërguari i Allahut (a.s.), për të cilin transmetohet se mbartte një ndjenjë të lartë turpi dhe se turpërohej më shumë se një vajzë e re, e cila qëndron në shtëpinë e saj me edukatë, i ka dhënë një vlerë të veçantë Osmanit për shkak se posedonte të njëjtin virtyt. Sipas Gazzaliut, i cili ka bërë analiza psikologjike dhe etike mbi çështjen e moralit, kur fëmija ndjen turp dhe i lë disa veprime, do të thotë se të ai ka filluar të shkëlqejë drita e mendjes. Pasi Gazzaliu shpreh rëndësinë e interesimit për edukimin e fëmijës duke filluar nga kjo pikë, sugjeron që ky edukim të fillojë me edukatën e ushqimit dhe të sofrës.

A HUMB GJË NJERIU NGA NDJENJA E TURPIT?

Ndjenja e turpit konsiderohet e tillë, nëse e ndalon njeriun nga ligësitë dhe e nxit për t'u bërë i moralshëm e për t'u sjellë me edukatë. Një ndjenjë turpi që skaji i saj arrin të paaftësia dhe frika, është një gjendje patologjike për sa i përket myslimanit. Nëse ndodh diçka e tillë, atëherë, myslimani menjëherë duhet të përpiqet për të dalë një çast e më parë nga kjo gjendje dhe nuk duhet ta konsiderojë frikën sikur të ishte një ndjenjë turpi. Nga ana tjetër, ata që marrin iniciativën për ta shfaqur paturpësinë si karakteristikën më të rëndësishme të kohëve moderne duke e treguar turpin si shkakun e mospërfundimit, nuk po bëjnë gjë tjetër përveçse po përpiqen ta shqyejnë edhe këtë perde të fundit të njerëzimit.

Por të gjithë e dinë se Jusufi (a.s.), i cili – me ndihmën e Zotit (xh.sh.), nuk anoi nga dëshira e gruas më të bukur të Egjiptit, edhe pse ishte pas dyerve të mbyllura nga ndjenja e turpit që kishte, u bë Pejgamberi dhe Sunduesi i Egjiptit. Jusufi (a.s.), ia doli mbanë për të hyrë në grupin e atyre që e refuzojnë propozimin e ulët të një gruaje të bukur e me pozitë të lartë duke thënë: "Unë kam frikë nga Allahu."

Ky grup është njëri prej shtatë grupeve që do qëndrojnë nën hijen e Arshit të Allahut Teala në Ditën e Gjykimit. I Dërguari i Allahut (a.s.), i cili turpërohej më shumë se një vajzë e re, vazhdon të përmendet me salavate e selame nga miliarda gjuhë dhe zemra në të gjithë botën.

ALLAHU E MERITON MË SHUMË PËR T'U PASUR TURP

Njeriu e ka përjetuar ndjenjën e turpit për herë të parë, kur Ademiti dhe Havasë, të cilët hëngrën nga fruti i ndaluar në xhenet, iu zbuluan vendet e turpshme. Mënjëherë u përpoqën për t'i mbuluar ato. ***"Dhe i mashtroi me dinakërinë e tij. Pasi e shijuan frutin, atyre iu zbuluan vendet e turpshme dhe nisën të mbulohen me gjethet e Xhenetit dhe Zoti i tyre i thirri: "A nuk jua kisha ndaluar atë pemë? A nuk ju pata thënë se djalli është vërtet armiku juaj i hapët?"*** (Araf, 22) Ndjenja e turpit është prej natyrshmërisë së njeriut, domethënë, prej kodit të të qenit njeri.

Ndërsa një njeri që mund ta bëjë kur është i vetëm atë që nuk e bën kur është bashkë me njerëzit për shkak se i vjen turp prej tyre, është një njeri që nuk ka turp nga Allahu dhe vetja e tij. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: ***"Ai i krijoi qiejt dhe Tokën për gjashtë ditë, pastaj u ngrit mbi Fron. Ai e di se çfarë hyn në Tokë dhe çfarë del prej saj, çfarë zbrit prej qiellit dhe çfarë ngjitet drejt tij. Ai është me ju kudo që të gjendeni; Ai sheh gjithçka që bëni."*** (Hadid, 4) Ky ajet fisnik na tregon qartazi se në çdo moment jemi nën vëzhgimin dhe në audiencën hyjnore. ***"Largohuni nga gjynahet e hapëta dhe të fshehta, sepse, ata që kanë bërë gjynahe, patjetër që do të ndëshkohen për atë që kanë vepruar."*** (En'am, 120) Andaj, Allahu Teala, i cili di çdo gjë të hapur dhe të fshehtë, e meriton më shumë për t'u pasur turp.

NDJENJA E TURPIT NUK E VËSHTIRËSON JETËN

Shumë çështje në lidhje me adhurimin apo me jetën tonë familjare i mësojmë nga hadithet e transmetuara nga gratë sahabe me në krye bashkëshortet e të Dërguarit të Allahut (a.s.). Gratë sahabe i kanë bërë shumë pyetje të Dërguarit të Allahut (a.s.), nganjëherë vetë dhe nganjëherë duke bërë ndërmjetëse nënat e besimtarëve. Edhe Pejgamberi u ka dhënë përgjigje mjaft të qarta pyetjeve të tyre. Një ditë vajza e Ebu Bekrit dhe në të njëjtën kohë motra e madhe e Aishes, Esma e pyeti të Dërguarin e Allahut (a.s.), se si mund të merrte gusull. Edhe Pejgamberi i bëri përkufizimin e gusullit. Aishja, e cila gjendej aty në ato momente, u gëzua ngaqë motra e saj erdhi dhe i bëri pyetje të Dërguarit të Allahut (a.s.), dhe shprehu këtë të vërtetë: "Sa gra të mira janë gratë Ensare! Turpi nuk i pengon ato për të mësuar fenë e tyre."

KURTHI ËSHTË NË INTERNET

"Sitet e rrjeteve sociale si Facebook-u dhe Twitter-i që mundësojnë ndarjen e të gjitha detajeve të jetës së njerëzve me të gjithë botën, e kanë shkatërruar ndjenjën e turpit." Kjo fjali përmbledh rezultatin që ka arritur profesori amerikan i psikologjisë Rowland Milleri, i cili ka bërë studime mbi ndjenjën e turpit përgjatë tridhjetë viteve. Profesori Miller, i cili punon në Universitetin Sam Houston State të Teksasit, në studimin e tij që e ka publikuar në vitin 2010, shprehet se në vitet e fundit ndjenja e turpit sa vjen e humbet më shumë sidomos ndërmjet të rinjve dhe se shkaku më i madh i kësaj është teknologjia. Sipas Millerit, tashmë na është bërë aq shumë shprehi ndarja e mendimeve tona në Twitter dhe Facebook, sa që dita ditës po bëhemi më pak të ndjeshëm dhe u japim më pak rëndësi atyre që mendojnë njerëzit.

Vetvetja mund të jemi edhe duke pasur turp!

Karakterit jetik i brezit të sotëm thekson të shprehurit e vetes, bërjen e zgjedhjes ndërmjet shumë alternativave dhe rehatinë. Në të kaluarën, jeta sociale ishte një shprehje e ndjenjës së turpit kolektiv. Ndjenja e detyrës dhe përgjegjësisë në emër të shoqërisë dhe familjes gjithmonë mbahej mbi nevojat dhe dëshirat individuale. Ndërsa tani na mësojnë se duhet të ndjekim ëndrrat tona për ta arritur lumturinë. Librat që shiten më shumë thonë se zgjedhja më e mirë për njeriun është që të "mendojë për veten e tij". Këshilla që dikur bëhej në formën: "Bëhu i kulturuar!", tashmë është shndërruar në formën: "Bëhu vetvetja!" Tashmë njerëzit po e bëjnë jetën sipas mendimeve dhe standardeve që i kanë vendosur vetë.

Sociologët e zgjedhur kanë hedhur një titull: "Shkatërrimi i rregullave dhe lindja e individit." Tashmë askush nuk u jep rëndësi rregullave morale dhe nuk do që të duket sikur ka moral fetar. Me mentalitetin e gabuar që prindërit e kanë marrë nga televizori, i inkurajojnë fëmijët e tyre, të cilët i kanë bërë kurban me një ambicie të madhe, për t'i shkelur rregullat duke mos marrë parasysh asnjë vlerë. Studentët të cilët e kanë bërë si çamçakëz në gojë të tyre lirinë dhe të drejtën e të shprehurit, nuk duan të bëjnë diçka që e bëjnë të gjithë apo që shoqëria e pranon. Kjo ndodh si rezultat i mendimit se është më mirë "të jesh i ndryshëm" në emër të kujtdo qoftë apo për çfarëdo qoftë.

Tashmë po përjetojmë kohën për të cilën i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë: ***"Do të vijë një kohë që mbrojtja e besimit do të jetë si mbajtja e thëngjillit në dorë."*** Të kesh turp në kohën e sotme, në të cilën po bëhen përpjekje për t'i përhapur në maksimum të gjitha llojet e marrëdhënieve të paligjshme burra-gra me anë të komunikimit kolektiv dhe mjeteve informuese, është më e rëndësishme se asnjëherë.



Ramazani

MUAJI I NDRYSHIMIT

Allahu (xh.sh.), na e bëri të mundur ta mbërrijmë muajin e Ramazanit, prandaj mos ta harrojmë këtë mirësi të madhe që na bëri Zoti. Ta dimë se ky muaj është një shans për ne, një mundësi e re, një ofertë nga ana e Allahut (xh.sh.), që të na falen gjynahet dhe të fitojmë sa më shumë sevape.

Ramazani është një garë që bën njeriu me veten e tij, për të treguar se sa i fortë dhe sa durimtar mund të jetë ai. A mund t'i largohet vesit, i cili siç ka pasur një fillim, ashtu mund të ketë edhe një fund? Padyshim që po.

1. Qëllimi kryesor që duhet të arrijmë në ramazan është falja e gjynaheve. Allahu (xh.sh.), në Kuran thotë:

Ata që nuk pendohen, janë vërtet keqbërës (zulmçarë).¹

Njëherë Profeti (a.s.), teksa po ngjitej në minberin e tij, tha tri herë: "Amin, amin, amin". Pasi mbaroi ligjëratën e tij dhe zbriti, shokët e tij e pyetën: "Pse the 3 herë amin, o profet i Zotit?" Profeti (a.s.), u përgjigj: "Më erdhi Xhebraili (a.s.) dhe më tha: "Ai njeri, i cili e ka arritur muajin e Ramazanit, nuk i janë falur gjynahet dhe ka përfunduar në zjarr, ai e ka merituar zjarrin. Unë thashë Amin". Pejgamberi (a.s.), ka thënë: "Ai që agjëron Ramazanin me besim dhe shpresë për shpërblim (nga Allahu), i falen gjynahet që ka bërë..."² Ibn Haxheri,

duke komentuar fjalën "me besim" thotë: "domethënë, duke i besuar premtimit të Zotit për shpërblim, kurse "me shpresë" domethënë duke kërkuar shpërblimin e jo për ndonjë qëllim tjetër, siç është syfaqësia, ose diçka tjetër".³

2. Arritja e devotshmërisë. Allahu i Lartësuar thotë:

"O ju që besuat, agjërimi ju është bërë obligim, sikurse ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm."⁴ Devotshmëri do të thotë të veprosh atë me të cilën Allahu është i kënaqur dhe të largohesh prej asaj që Ai e ka ndaluar. Talh ibn Habib nga selefet ka thënë: "Kur të ndodhin fitnet, sprovat mbrohuni me devotshmëri." E çfarë është devotshmëria: "Ta adhurosh Allahun duke shpresuar shpërblimin nga Ai, dhe të largohesh nga gjynahet duke pasur frikë Atë".

3. Premtimi që i kemi dhënë Zotit që, nëse unë e arrij ramazanin e ardhshëm do t'i kryj ato gjëra që nuk i kam kryer në ramazanin e kaluar.

4. Veprat e mira në ramazan. Një farz që kryhet në Ramazan shpërblehet sa 70 farze që kryhen jashtë Ramazanit: "E kush e kryen një farz në të, ka shpërblimin sikur të ketë kryer 70 farze jashtë tij".⁵

3. Fet'hul-Bari.

4. Bekare, 183.

5. Ibn Khuzejme, Bejhekiu.

1. Huxhurat, 11.

2. Buhari, Muslim.



DISA NGA PUNËT QË MYSLIMANI DUHET TË BËJË NË RAMAZAN

FALJA E NAMAZIT TË TARAVIVE

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Atij që falet me imamin derisa ta përfundojë namazin, i shkruhet sikur të jetë falur tërë natën."*⁶ Imam Neveviu, rahimehullah, thotë: "Qëllimi i fjalës "namaz" në këtë hadith është namazi i teravisë". Muhamed b. Utjeimini thotë: "Besimtari nuk duhet të largohet nga namazi derisa ta përfundojë imami namazin e teravisë, si dhe vitrin, që ta arrijë vlerën apo shpërblimin e namazit të natës."

LEXIMI I KURANIT

Ibn Mesudi (r.a.), transmeton se Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Kush e lexon Kurandin, për çdo shkronjë ka nga dhjetë sevape. Nuk them se elif lam mim është një shkronjë, por elif është një shkronjë, lam është një shkronjë dhe mim është një shkronjë."*⁷ Imam Maliku gjatë muajit të Ramazanit nuk angazhohej me diçka tjetër, vetëm me leximin e Kurani dhe e ndërpriste mësimin e njerëzve në xhami dhe dhënie të fetvave, duke

thënë se ky është muaji i Kuranit. Imam Shafiu, Allahu e mëshiroftë, gjatë muajit të Ramazanit është transmetuar se ka bërë 60 hatme Kurani, pra një hatme gjatë ditës e një gjatë natës!

DHËNIA IFTAR NË AGJËRUESI

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Ai që ushqen një agjërues, do ta ketë shpërblimin sikur ai, pa iu pakësuar asgjë nga shpërblimi i agjëruesit."*⁸

SHTIMI I SADAKASË DHE LËMOSHËS

*"I Dërguari i Allahut, ishte njeriu më bujar e i shtoej edhe më shumë bujaria në muajin e Ramazanit kur takohej me Xhibrilin (a.s.), i cili ia mësonte Kurandin."*⁹

SHTIMI I LUTJEVE:

Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Me të vërtetë, për çdo mysliman në çdo ditë dhe natë në Ramazan ka një lutje të pranuar."*¹⁰ Pejgamberi (a.s.), ka thënë: *"Tri lutje janë të pranuar: lutja e agjëruesit, lutja e atij që i është bërë padrejtësi dhe lutja e udhëtarit."*¹¹

6. Ebu Davudi, Tirmidhiu.

7. Tirmidhiu.

8. Ahmedi.

9. Buhari, Muslim.

10. Shënon Bezari dhe e saktësoi Albani.

11. Bejhekiu.



ZEMRA NË NJË ÇIP

Të vëzhgosh qelizat e muskujve të zemrës së njeriut normalisht nënkupton të hapësh gjoksin e dikujt, por jo më. Tani ato mund të vëzhgohen dhe të studiohen jashtë zemrës me një mikroskop dhe shkencëtarët në Universitetin e Kalifornisë, Berkeley të cilët po punojnë me bio inxhinierë, kanë zhvilluar për herë të parë një sistem që lejon qelizat e zemrës së njeriut të funksionojnë jashtë trupit.

‘Është demonstrimi i parë i një zemre të vërtetë njerëzore që bazohet në një sistem që imiton fiziologjinë sa më shumë që të jetë e mundur’, thotë post doktoranti dhe kërkuesi Anurag Mathur.

Shkencëtarët kaliforniane e quajnë pajisjen zemra në një cip. Sistemi përbëhet nga shtresa qelizore që vijnë nga qeliza prekursorë të të rriturve, të cilat mund të konvertohen në shumë lloje qelizash të tjera. Këto qeliza vendosen në një rrasë të vogël silikon. Për të mbajtur këto qeliza funksionale, kanale mikro fluidale më të hollë se fija e flokut të njeriut, ushqejnë qelizat dhe gjithashtu ofrojnë një mënyrë për të dërguar drogën

drejt tyre për tu testuar.

‘Këto janë enë gjaku imituese, të ngjashme me enët e vërteta të gjakut. Fluidi për të cilin ne jemi të interesuar vjen mospërmas kësaj qelize dhe më pas e lan atë me drogën. Ne i japim kafeinë, zemra në një cip rreh dhe rrit ritmin e rrahjeve të saj. Ne i japim adrenalinë dhe ajo e rrit ritmin e rrahjeve të saj’, thotë Profesori i Bioinxhinierisë dhe Shkencës Materiale Kevin Healy.

Shkencëtarët besojnë se përmes imitimit të fiziologjisë njerëzore, pajisja mund të ofrojë një mjet të ri dhe të fuqishëm për zhvillimin e drogërave. Aktualisht, kompani farmaceutike shpenzojnë biliona për të testuar drogëra të reja në modele kafshësh të cilët më shpesh dështojnë në parashikimin nëse drogëra të reja janë toksike ndaj njerëzve. Cipi i zemrës mund të revolucionarizojë testimin e drogërave duke ofruar një mjet që mund të modifikohet për të modeluar sëmundjet njerëzore duke përdorur qeliza njerëzore për të testuar drogëra të reja. Kërkimi është ende në fillimin e tij, por Healy thotë se potenciali i tij është i pamasë.

SHKENCËTARËT KRIJOJNË MATERIALIN MË TË ERRËT NDONJËHERË



Nga të gjitha objektet e errëta në univers, vetëm vrmat e zeza janë aq të zeza sa as një rreze drite nuk mund reflektohet nga ato. Mirëpo shkencëtarët kanë krijuar një material që është po aq i zi. Pritet që ky material të ketë një përdorim të gjerë teknologjik.

Një nga arsyt që teleskopët astronomikë ndërtohen në lartësi të mëdha në male dhe larg zonave të banuara, është për të shmangur dritën. Imazhe të galaksive që

ndodhen miliona vite drite larg, janë aq të zbehta sa që edhe reflektimi brenda pareteve të zeza brenda teleskopit optik mund të zvogëlojë cilësinë e tyre.

“Nëse futet dritë ndërhyrëse brenda teleskopit, përshtetull dritë nga objektet që nuk janë objekt i studimit, atëherë cilësia e imazhit nuk do të jetë aq e lartë.”

Ben Jensen është shef i teknologjisë i firmës britanike Surrey Nanosystems, e cila pretendon që materiali i quajtur Vantablack thith 99.96 përqind të rrezatimit elektromagnetik, duke përfshirë gjithë dritën e perceptueshme nga syri. Vetëm vrmat e zeza thithin 100 përqind të kësaj drite.

Vantablack përbëhet nga nanotuba, struktura tepër të imëta të krijuara nga organizimi i rregullt i atomeve të karbonit të pastërt, që shpesh cilësohet si materiali i shekullit 21.

Rrezet e dritës që godasin materialin Vantablack humbin në labirintin e nanotubave që janë të renditura në mënyrë vertikale. Si rezultat drita nuk shihet, por

shihet hapësira rreth nanutubave.

“Pra nese e mendon si një fushë të gjatë, atëherë grimcat e dritës që futen në këtë hapësirë, përplasen përgjatë kësaj fushe të gjatë. Ato thithen nga materiali, dhe shumë pak nga ato reflektohen jashtë.”

Inxhinjerët kanë arritur ta lidhin materialin e ri me lëndë të tjera, si për shembull tabakë alumini, gjë që ofron mundësinë për ta përdorur për veshjen e pare-

teve të instrumentëve optikë në satelitë dhe pajisje të tjera shkencore.

Mirëpo Vantablack mund të përdoret edhe në teknologjinë ushtarake të zbulimit, si për shembull në avionë ushtarakë, si këta avionë në Panairin Ajror Farborough në Britani—duke i bërë këta avionë edhe më të vështirë për t'u kapur nga valët elektromagnetike të radarëve.

MËNDAFSHI ARTIFICIAL

Mëndafshi i merimangës është një nga materialet më të forta që njeriu ka njohur ndonjëherë.

Një fije vetëm 3 centimetra e trashë do të ishte e aftë të ndalonte një tren me shpejtësi.

Por, pavarësisht përpjekjeve të mëdha nga shkencëtarët për të rikrijuar këtë material, që në fakt merimangat kanë qenë duke e prodhuar për mijëra vjet, aftësia për të prodhuar mëndafsh në laborator ka treguar që është vetëm një iluzion.

Kjo deri tani, sepse kërkuesit nga Universiteti i Bayreuth në Bavari, Gjermani thonë se ata kanë krijuar një mëndafsh artificial merimange aq të fortë sa i vërteti me ndihmën e baktereve të gjetura në stomakun e njerëzve dhe kafshëve.


Profesor Thomas Scheibel është duke drejtuar ekipin. ‘Karakteristika e veçantë e fibrave të merimangave është fortësia e tyre e madhe’ thotë ai. ‘Kështu që është një kombinim i fortësisë dhe elasticitetit, çka do të thotë se një fibër e më-

ndafshit të merimangës mund të marrë më shumë energji përpara se të çahet, në krahasim me çdo fibër tjetër, të bërë nga njeriu ose natyrale.’

Teksa mëndafshi artificial nuk është aq i fortë sa mëndafshi natyral i merimangës, i cili është edhe më elastik. Fortësia e tij, një matje e forcës dhe elasticitetit, krahasohet me mëndafshin real. Prototipet aktuale të fibrës janë të butë në prekje dhe ato ndriçojnë si një mëndafsh i vërtetë. Ato janë të bardhë të shndritshëm dhe mund të lyen me teknika të zakonshme të përdorura në industrinë tekstile. Për shkak të biopërshtatshmërisë së tij, mëndafshi i përdorur në proces mund të ketë përdorime të ndryshme të shumta.

Më tej akoma, ekipi po punon në kombinimin e qelizave të minjve me mëndafshin artificial të merimangës për të krijuar qeliza me jetë që mund të zhvillojnë muskuj kardiake, lëkure ose edhe qeliza nervore.





PASTRONI VESHKAT ME KËTO PIJE

Veshkat janë të vendosura në zgavrën abdominale. Ka dy veshka, njëra ndodhet në anën e majtë dhe tjetra në të djathtën. Sipas mjekësisë veshka rezervon energjinë e jetës që nga lindja, energji kjo thelbësore për të gjitha aktivitetet e jetës. Stomaku dhe shpretka furnizojnë energjinë e jetës nga konsumimi i ushqimeve, prandaj ata vendosin energjinë e jetës së paslindjes. Shumë specialistë të mjekësisë janë të mendimit se energjia e jetës rezervuar në veshkë përcakton moshën tuaj fizike. Për shembull, disa persona duken më të rinj, për shkak të energjisë së plotë të jetës në veshkën e tyre, disa të tjerë duken më të vjetër, për shkak të mungesës së kësaj energjie në veshkë. Në fakt, energjia e jetës e rezervuar në veshkë nxit qarkullimin e energjisë brenda organeve të tjera, duke krijuar një ambient të mirë për punën e tyre. Në librat klasike të mjekësisë veshka përshkruhet si rrënja e pemës, organet e tjera si degët dhe gjethet e pemës. Përveç kësaj, veshka lidhet ngusht me lindjen e fëmijëve. Nëse çifti nuk ka energji të plotë në veshkë, është shumë e vështirë për mbetjen shtatzënë dhe lindjen e një fëmije të shëndetshëm. Prandaj, nëse çiftet e reja dëshirojnë të lindin një fëmijë të shëndetshëm, duhet t'i kushtojnë vëmendje shëndetit të veshkave të tyre.

SHENJAT E PËRKEQËSIMIT TË SHËNDETIT TË VESHKËS

1. Ulja e dëgjimit: Dëgjimi lidhet ngusht me energjinë

e rezervuar në veshkë. Për shumicën e të moshuarve, dëgjimi i tyre bie për shkak të mungesës së energjisë në veshka. Por, nëse një i ri ka probleme me dëgjimin, atëherë duhet t'i kushtohet vëmendje shëndetit të veshkave të tij.

2. Thinjat dhe rënia e flokëve: Zbardhja dhe rënia e flokëve janë fenomene të zakonshme tek të moshuarit, meqenëse energjia e jetës në veshkat e tyre konsumohet me procesin e moshimit. Por, nëse i kushtohet vëmendje e veçantë shëndetit të veshkës, të moshuarit mund t'i lehtësojnë këto fenomene.

3. Reagimet e ngadalta dhe ulja e nivelit të inteligjencës: Ndodh që tek disa persona me kalimin e moshës për shkak të konsumimit të energjisë në veshkë, ka ngadalësim të reagimit dhe rënie të nivelit të inteligjencës. Po ashtu edhe tek nënat e reja. Sipas mjekësisë gjatë muajit të parë pas lindjes së fëmijës, lehona duhet të shmangë lodhjen e tepërt dhe të konsumojë ushqimet me vlera të larta për rinovimin e energjisë së jetës së tyre në veshkë.

DISA SHKAQË PËR DOBËSINË E PARAKOHSHE TË VESHKAVE

1. Puna e pandërprerë: jo vetëm puna fizike, por edhe ajo mendore e vazhdueshme dëmton shëndetin e veshkave. Prandaj, sugjerojmë që të gjeni kohën e pushimit gjatë punës. Megjithatë puna është shumë e rëndësishme, por shëndeti i veshkës është edhe më

rëndësishëm. Në fakt, një pushim 1-5 minutash në mes të orëve është shumë i nevojshëm dhe i mjaftueshëm.

2. Lohetja e tepërt emocionale: Ngacmimet e mëdha dëmtojnë patjetër shëndetin e veshkës. Duhet të theksojmë që gëzimi apo pikëllimi i tepërt ndikon edhe shëndetin e veshkave. Më parë kemi përmendur se ruajtja e një gjendjeje të qëndrueshme shpirtërore është një nga mënyrat më të mira për një shëndet të shkëlqyer.

3. Konsumi i tepërt i kafeinës, alkoolit dhe duhanit: Kafja është një pije shumë e preferuar sot në botë, nuk ju sugjerojmë që të hiqni plotësisht dorë nga ajo, por ju këshillojmë që të kontrolloni sasinë e konsumit të saj.

Brenda një ditë, konsumi i një filxhani kafeje është i mjaftueshëm. Por konsumi i tepërt i këtyre mund të shkaktojë dëmtime për veshkat.

4. Gripi: Sipas mjekësisë ftohtësia është elementi më i keq i jashtëm që dëmton veshkat. Prandaj, ju sugjerojmë që gjatë stinës së dimrit të visheni mirë.

Për të ruajtur shëndetin e veshkave duhet të konsumoni ushqime me ngjyrë të errët si fasulet e zeza, orizi i zi, algat e detit, gështenjat etj. Këto ushqime duhet të konsumohen në dimër dhe vjeshtë.

5. Futja e këmbëve me ujë të ngrohtë para gjumit: Sipas mjekësisë këmbët janë pjesa më e dobët që mund të sulmohen nga ftohtësia. Gjatë natës, temperaturat janë më të ulëta. Prandaj, futja e këmbëve në ujë të ngrohtë për 10 minuta para gjumit mund të bëjë që të keni këmbë të ngrohta. Kjo është një metodë shumë e efektshme për shëndetin e veshkave.

6. Meditimi: Frymëmarrja e thellë në fakt është një metodë e efektshme për të hequr lodhjen. Shumë njerëz me ngarkesa të mëdha marrin frymë shpejt, gjë që lodh mushkërinë dhe veshkat. Sipas mjekësisë procesi i frymëmarrjes mundësohet jo vetëm nga mushkëria. Veshka gjithashtu luan rol të rëndësishëm për thithjen e ajrit. Nëse veshka është e dobët, do të keni vështirësi për thithjen e ajrit. Prandaj, stërvitja e frymëmarrjes së thellë mund të nxitë qarkullimin e oksigjenit brenda trupit, duke siguruar aktivitete të shëndetshme të veshkave. Një stërvitje e vjetër e mjekësisë mbi frymëmarrjen kërkon që gjatë frymëmarrjes të imagjinoni që të gjitha materialet e mira të botës po hyjnë tek ju; gjatë frymënxjerrjes imagjinoni që të gjitha të këqijat po dalin nga trupi juaj. Provojeni këtë metodë në natyrë dhe do të ndiheni shkëlqyeshëm.

PIJE KUNDËR GURËVE NË VESHKA

Gurët në veshka përmbajnë kalcium. Ekzistojnë shumë shkaqe për formimin e tyre, por më i madhi është

ushqimi që shkakton sekretimin e kalciumit në urinë. Përveç kësaj gurët në veshka mund të shkaktohen edhe nga ushqimet me shumë proteina, të cilat shkaktojnë krijimin e acidit urinar. Për të reduktuar rrezikun e gurëve në veshka duhet të evitoni me çdo kusht fast food-ët, ushqimet me shumë kripë dhe ushqime të pasura në kalcium. Duhet të konsumoni më shumë lëngje për të ulur shanset e formimit të gurëve. Ja si të shpëtoni nga gurët në veshka me një mënyrë 100% natyrale:

Miksoni 4 limona në 2 litra ujë dhe pini shpesh.

Limoni është shumë i pasur në citrate, të cilat ndihmojnë në luftën kundër gurëve në veshka. Studiuesit thonë se mund t'i shtoni pak mjaltë kësaj përzierjeje.

2. MREKULLIA PËR PASTRIMIN E VESHKAVE

Nëse keni ndonjë problem me veshkat, traktin urinar apo fshikëzën e urinës ju sjellim sot një pije që do t'ju zgjidhë problemin. Veshkat janë organ jetik në trupin tonë. Ato filtrojnë 200 litra gjak në ditë dhe nuk lejojnë që toksinat të futen në trupin tonë. Armiqtë më të mëdhenj të veshkave janë proteinat shtazore, pijet me gaz, produktet OMGJ, ëmbëltuesit artificialë, kafeina dhe cigaret.

Për të pastruar veshkat duhet të konsumoni ujë në sasi të lartë.

Për të bërë një pije që largon problemet me veshkat ju duhen:

- 1 Kivi
- 1 Banane
- lëngu i gjysmë limonit
- ½ gote arra - ½ luge majdanos
- 1 gotë ujë

Mënyra e përgatitjes:

Të gjithë përbërësit e mësipërm hidhini në blender dhe miksojini. Limonin duhet ta shtrydhni përpara se ta hidhni në blender.

Konsumoni këtë pije çdo mëngjes esëll.

